

VETËVLERËSIMI I LEHTËSIMIT TË TREGTISË SIPAS MARRËVESHJES SË OBT-SË

SHTATOR 2023



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministartstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship
and Trade



DOGANA - CUSTOMS - CARINA

VETËVLERËSIMI I LEHTËSIMIT TË TREGTISË SIPAS MARRËVESHJES SË OBT-SË

Ky dokument është përgatitur nga Komiteti Nacional për Lehtësimin e Tregtisë, me mbështetje nga Programi i USAID për Qeverisjen Ekonomike në Kosovë. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	7
1.1 PUBLIKIMI	11
1.2 INFORMACIONI I DISPONUESHËM NË INTERNET	15
1.3 PIKAT E KËRKIMIT TË INFORMACIONIT	18
1.4 NJOFTIMI/NOTIFIKIMI.....	21
2.1 MUNDËSI PËR KOMENT, INFORMACIONET PARA HYRJES NE FUQI, DHE KOMENTIMI....	24
2.2 KONSULTIMET	27
3.1 VENDIMET PARAPRAKE.....	29
4.1 E DREJTA PËR APELIM OSE RISHQYRTIM	33
5.1 NOTIFIKIMET/NJOFTIMET PËR KONTROLLE OSE INSPEKTIVE TË ZGJERUARA	36
5.2 NDALIMI	40
5.3 PROCEDURAT E TESTIMIT	42
6.1 DISIPLINAT E PËRGJITHSHME MBI TARIFA DHE NGARKESA TË VENDOSURA MBI APO NË LIDHJE ME IMPORTIMIN DHE EKSPORTIMIN.....	45
6.2 DISIPLINAT SPECIFIKE MBI TARIFAT DHE NGARKESAT PËR PROCESIMIN DOGANOR TË VENDOSURA MBI APO NË LIDHJE ME IMPORTIMIN DHE EKSPORTIMIN	50
6.3 DISIPLINAT PENALIZUESE.....	52
7.1 PROCESIMI PARA-MBËRRITJES.....	55
7.2 PAGESAT ELEKTRONIKE	57
7.3 NDARJA E LIRIMIT NGA PËRCAKTIMI FINAL DHE PAGESA E DETYRIMEVE DOGANORE, TAKSAVE, TARIFAVE DHE NGARKESAVE	59
7.4 MENAXHIMI I BAZUAR NË RISK.....	61
7.5 AUDITIMI PAS ZHDOGANIMIT	64
7.6 VENDOSJA DHE PUBLIKIMI I KOHËS MESATARE TË LËSHIMIT DHE ZHDOGANIMIT	66
7.7 MASAT PËR LEHTËSIMIN E TREGTISË PËR OPERATORËT E AUTORIZUAR	68
7.8 DËRGESAT E SHPEJTA.....	71
7.9 MALLRAT QË PRISHEN	74
8. BASHKËPUNIMI I AGJENCIVE KUFITARE.....	76
9. LËVIZJA E MALLRAVE NËN KONTROLL DOGANOR TË DESTINUARA PËR IMPORT	79
10.1 FORMALITETET DHE KËRKESAT PËR DOKUMENTACION	81

10.2 PRANUESHMËRIA E KOPJEVE	84
10.3 PËRDORIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE	86
10.4 DRITARJA E VETME.....	88
10.5 INSPEKTIMI PARA-ARRITJES	91
10.6. PËRDORIMI I AGJENTËVE DOGANOR.....	93
10.7 PROCEDURAT E PËRBASHKËTA KUFITARE DHE KËRKESAT UNIFORME PËR DOKUMENTE.....	95
10.8 MALLRAT E REFUZUARA	97
10.9 PRANIMI/IMPORTI I PËRKOHSHËM I MALLRAVE/ PROCESIMI I BRENDSSHËM DHE I JASHTËM	99
11.1-3 TAKSAT, RREGULLORET DHE FORMALITETET E TRANZITIT	101
11.4 FORCIMI I MOS-DISKRIMINIMIT (Paragrafi 4).....	103
11.5-10 PROCEDURAT DHE KONTROLLET E TRANZITIT (Paragrafët 5-10)	104
11.11-15 GARANCITË (PARAGRAFËT 11.11-11.15).....	106
11.16-17 BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI MBI TRANZITIN (PARAGRAFI 16-17)	108
12. BASHKËPUNIMI DOGANOR	110
SHTOJCA I: KONTRIBUESIT	116

SHKURTESAT

AKPPM	Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
AP5	Protokolli i 5-të për Lehtësimin e Tregtisë në kuadër të CEFTA-s
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
ASYCUDA	Automated System for Customs Data
ATA	Admission Temporaire/Temporary Admission
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AUVK	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BI	Business Intelligence
BTSF	Better Training for Safer Food
CEFTA	Central European Free Trade Agreement
CLEN	Customs Laboratories European Network
CMS	Customs Management Solutions
COGNOS	Program softuerik për sistemin e raportimit në Doganën e Kosovës
DL	Departamenti Ligjor
DT	Departamenti i Tregtisë
DVK	Dritarja e Vetme Kombëtare
EUR I	Certifikata e Origjinës
EXBS	Export Control and Related Border Security
GATT	General Agreement on Tariffs and Trade
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
GSP	Generalized System of Preferences
ICITAP	International Criminal Investigative Training Assistance Program
IFC	International Finance Corporation
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
KDA	Kodi Doganor i Akcizave
KEGA	Kosovo Economic Governance Activity
KKEI	Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime
KKZHE	Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik
KNLT	Komiteti Nacional për Lehtësimin e Tregtisë
MAP	Ministria e Administratës Publike
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MLT	Marrëveshja për Lehtësimin e Tregtisë
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
NCTS	New Computerised Transit System
OBD	Organizata Botërore e Doganave
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
AEO	Operatorët Ekonomik të Autorizuar
OJQ	Organizatë Joqeveritare
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
QILT	Qendra Informative për Lehtësimin e Tregtisë
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit
RAPEX	Rapid Exchange of Information System
RASFF	Rapid Alert System on Food and Feed
REX	Registered Exporters System
RKS	Republika e Kosovës
SAR	Spektori i Analizës së Riskut
SEED	Systematic Exchange of Electronic Data
SRM	Spektori për Risk dhe Monitorim
TAIEX	Technical Assistance and Information Exchange Instrument
TARIK	Kodi Tarifor i Kosovës
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TIR	Transports Internationaux Routiers
TKMK	Trupi Koordinues për Mbikëqyrjen e Tregut
TRACES NT	Trade Control and Expert System – New Technology
UA	Udhëzim Administrativ
USAID	United States Agency for International Development
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik

PËRMBLEDHJE

Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) për Lehtësimin e Tregtisë luan rrol kyç në promovimin e procedurave eficiente dhe transparente për eksport, import, dhe tranzit, uljen e shpenzimeve të përgjithshme të transaksioneve, si dhe rritjen e konkurrueshmërisë në tregtinë ndërkombëtare. Për të vlerësuar përafrimin me këto praktika eficiente dhe transparente në kontekst të lehtësimit të tregtisë, shtetet e ndryshme përdorin metodologjinë e Vetëvlerësimit të Lehtësimit të Tregtisë (Vetëvlerësimi), të zhvilluar nga vet OBT-ja. Kjo metodologji gjerësisht e përdorur e vetëvlerësimit, ofron mundësi për një dialog të brendshëm me qëllim të vlerësimit, përcaktimit të prioriteteve, dhe trajtimit të temave që lidhen me ambientin e përgjithshëm ekonomik i cili është i domosdoshëm për rritjen e tregtisë së brendshme dhe asaj të jashtme.

Duke pasur parasysh rëndësinë e vlerësimit të progresit me reformat në fushën e lehtësimit të tregtisë në Kosovë, Komiteti Nacional për Lehtësimin e Tregtisë (KNLT) në vitin 2021 inicioi procesin e Vetëvlerësimit sipas metodologjisë së OBT-së. Për më tepër, edhe pse Kosova nuk është pjesë e OBT-së, Protokollin Shtesë 5 i CEFTA-s (AP5) mbi lehtësimin e tregtisë bazohet në dispozitat e kësaj Marrëveshje dhe rrjedhimisht aktivitetet që burojnë nga ky protokoll zbatohen nga institucionet e Kosovës përfshirë këtu edhe vlerësimin e kohëpaskohshëm të reformave në kuadër të lehtësimit të tregtisë. Synim i AP5 është thjeshtësimi i inspektimeve, reduktimi i formaliteteve të import-eksportit, shkëmbimi elektronik i të dhënave, njohja reciproke e testeve laboratorike dhe programit të operatorëve ekonomikë të autorizuar, si dhe zbatimi efektiv i kontrollit të riskut.

Me mbështetjen e Programit të USAID-it për Qeverisje Ekonomike në Kosovë, Vetëvlerësimi është zhvilluar në një seri punëtorish dhe një numër të madh takimesh individuale për t'i mbledhur dhe analizuar informatat në lidhje me lehtësimin e tregtisë. Të përfshira në këtë proces kanë qenë të gjitha institucionet që janë pjesë e KNLT-së, duke përfshirë: Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Doganën e Kosovës, Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AUVK), Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), Policinë e Kosovës, Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe përfaqësues të sektorit privat.

Metodologjia e OBT-së për realizimin e Vetëvlerësimit e ndan procesin në disa faza specifike. Së pari kërkon ekzaminimin e gjendjes aktuale me reformat për lehtësimin e tregtisë. Kjo fazë analizon gjendjen në disa rrafshë: atë të politikave dhe të legjislacionit, pastaj të procedurave, kornizës institucionale, si dhe të burimeve njerëzore dhe teknike. Bazuar në këtë fazë të analizës, faza e radhës kërkon identifikimin e fyteve të ngushta apo pengesave në realizimin e reformave dhe rrjedhimisht bën të mundur edhe përcaktimin e hapave të radhës, apo rekomandimeve për politikë-bërësit, që po ashtu përbën edhe fazën e fundit. Përtej këtyre tri fazave, metodologjia kërkon që të identifikohen bartësit institucional të reformave, prioriteti i këtyre reformave në nivel nacional, dhe mbështetja e jashtme e nevojshme për realizimin e reformave (nga donatorët).

Që nga Vetëvlerësimi i fundit i realizuar në vitin 2014, gjetjet tregojnë që Kosova ka bërë avancime të konsiderueshme në disa fusha të lehtësimit të tregtisë, përfshirë këtu:

- rritjen e transparencës dhe qasjes në informacione;
- thjeshtësimin dhe standardizimin e procedurave në eksport, import, dhe tranzit;
- ngritjen e bashkëpunimit në mes të agjencive kufitare brenda vendit dhe jashtë; dhe

- ngritjen e kapaciteteve njerëzore, teknike dhe institucionale.

Natyrisht, në secilin nga këto dimensione progres të veçantë kanë shënuar institucionet të cilat janë të lidhura drejtpërdrejtë me fushën e lehtësimit të tregtisë, veçanërisht Dogana e Kosovës dhe AUVK.

Sidoqoftë, në fusha të caktuara progresi është i limituar. Në përgjithësi, ngecje të theksuara vërehen në institucionet të cilat nuk e kanë fushë primare të veprimtarisë së tyre lehtësimin e tregtisë. Në këto institucione ka mungesa të theksuara të kapaciteteve njerëzore, teknike dhe institucionale për të komunikuar me publikun, siguruar transparencë, shkëmbyer informata, reduktuar kontrollet, ulur kostot e transaksioneve dhe lehtësuar proceset e eksportit dhe importit të mallrave.

Në përgjithësi, në shumë fusha të lehtësimit të tregtisë nevoja për të intervenuar është imediate. Në pjesën dërmuese lehtësirat tregtare janë të mbuluara me legjislacion dhe politika përkatëse. Kodi i ri Doganor dhe i Akcizës i cili është në procedure të aprovimit, do të krijojë edhe më shumë hapësira në fushën e lehtësimit të tregtisë (p.sh., në procedurat e notifikimit/njoftimit, ndalimit, testimit, penalizimeve, aplikimit të standardeve ndërkombëtare, mallrave nën kontroll doganor, etj.).

Edhe përkundër faktit që legjislacioni bazë është në fuqi, në shumë raste procedurat standarde operative ende nuk janë krijuar në një pjesë të konsiderueshme të institucioneve (veçanërisht në rastin e komunikimit me palët e treta, informatat në dispozicion të publikut, dokumentacioni i kërkuar, përdorimi i kopjeve, e kështu me radhë). Për më tepër, në ato institucione që ekzistojnë procedurat, të njëjtat nuk janë të harmonizuara në aspektin ndërinstitucional (procedurat ndryshojnë nga institucioni në institucion).

Në rrafshin e kornizës institucionale, në institucionet përkatëse mungojnë mekanizmat institucional të krijuar për të mbuluar fushë-veprimtarinë e caktuar. Institucionet bazë që mbulojnë lehtësimin e tregtisë – Dogana e Kosovës dhe AUVK – në pjesën më të madhe kanë njësi të veçanta që mbulojnë fushat specifike të lehtësimit të tregtisë. Në rastet kur nuk i kanë, atëherë janë zyrtarët specifik që kanë përgjegjësi mbi këto fusha. Por në anën tjetër, një pjesë e institucioneve të përfshira në tregti nuk kanë fare mekanizma institucional të veçantë në organogramin e tyre apo edhe zyrtarë për të mbuluar fushat përkatëse. Kjo situatë rezulton kryesisht nga kapacitetet e ulëta administrative në këto institucione, ose edhe një pjesë të këtyre funksioneve realizohen nga institucioni bazë nën ombrellën e të cilit operojnë këto institucione (p.sh., AKPPM që operon në kuadrin e Ministrisë së Shëndetësisë). Në këtë kontekst, një çështje tjetër me shumë rëndësi është koordinimi i përgjithshëm jo-efikas ndërinstitucional.

Një problem me peshë që është identifikuar gjatë procesit të vetëvlerësimit është niveli i kufizuar i shkathtësive të personelit, dhe në raste të caktuara edhe mungesa e personelit të mjaftueshëm për të mbuluar fushat e caktuara. Ngritje të kapaciteteve njerëzore është kërkuar në fushat si: komunikimi me publikun dhe transparenca, publikimi i informacioneve, notifikimet, ndalimi, penaltitë, vlerësimi i bazuar në risk, mallrat që prishen, e kështu me radhë.

Në raste të caktuara janë identifikuar fyte të ngushta edhe sa i përket infrastrukturës fizike dhe asaj digjitale. Në rastin e infrastrukturës fizike, pikë-kalimet kufitare kanë nevojë për avancim të mëtejshëm. Për më tepër, në терминаlet ekzistuese janë identifikuar kapacitete të kufizuara sa u përket mallrave që prishen. Në anën tjetër, institucionet përgjegjëse kanë filluar të aplikojnë në mënyrë intensive teknologjinë e informacionit, e veçanërisht Dogana e Kosovës e ka të sofistikuar sistemin e saj elektronik ASYCUDA World. Për më tepër, Dogana e Kosovës iu ka dhënë qasje në këtë sistem të gjithë mekanizmave që lidhen me lehtësimin e tregtisë. Edhe AUVK ka ndërtuar sistemin e vet

elektronik (Sistemi Elektronik AUVK), e po ashtu edhe AKPPM (sistemi BARNATARI). Edhe pse këto sisteme janë të lidhura pjesërisht në kuadër të Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK), prapë ka një mungesë të theksuar të komunikimit dhe shkëmbimit të informatave në mes të këtyre institucioneve, apo ndërveprueshmërisë së sistemeve.

Fusha të caktuara të lehtësimit të tregtisë nuk kanë avancuar fare, sikur është krijimi i pikave të kontaktit dhe dritarja e vetme. Në rastin e parë, procesi i krijimit dhe funksionalizimit të Qendrës Informative për Lehtësimin e Tregtisë (QILT), e cila parashihet të luaj rol në pikës së kontaktit në mes të institucioneve përgjegjëse dhe palëve të tjera, ka ngecur në terësi për shkak të mos-ratifikimit të AP5. Ndërsa, krijimi i dritares së vetme ka mbetur në fazat krejt fillestare. Deri më tani ky proces ka rezultuar në krijimin e grupeve punuese dhe përgatitjes së udhërrëfyesit. Tani mbetet me Qeverinë e Kosovës të merr vendimin për fazën e implementimit të projektit të dritares së vetme, proces ky i cili ka ngecur për shkak të kërkesave komplekse teknike, legislative dhe financiare.

Tutje, me mos-ratifikimin e AP5 të CEFTA-s Kosova nuk mund të përfitoj nga njohja reciproke e autorizimeve për Operatorë Ekonomik të Autorizuar (AEO). Mosnjohja e ndërsjellë e autorizimeve për AEO të lëshuara nga autoritetet përkatëse e redukton në masë të madhe peshën e kësaj reforme për lehtësimin e tregtisë. Në këtë kontekst, e vetmja mundësi për njohje reciproke të autorizimeve për AEO mbetet negociimi bilateral për njohje të ndërsjellë të këtyre autorizimeve.

Disa ngecje në reformat për lehtësimin e tregtisë janë të lidhura me proceset politike. Autoritetet përgjegjëse të përfshira në Vetëvlerësim kanë apostrofuar rëndësinë e përfshirjes së Kosovës në mekanizmat e ndryshëm dhe sisteme të cilat mbulojnë procesin e tranzitit, si NCTS, TIR, ATA Karnet, etj. Anëtarësimi në këto protokolle ndërkombëtare të tranzitit është vështirë i realizueshëm në afat të shkurtër për shkak të probleme politike.

Për fund, Vetëvlerësimi identifikon se ka mungesë të angazhimit të mjaftueshëm nga donatorët në fushën e lehtësimit të tregtisë. Rritja e pranisë dhe mbështetjes së donatorëve në këtë fushë do të kontribuonte në përpjekjet e institucioneve të Kosovës për të përmirësuar praktikën e lehtësimit të tregtisë dhe për të zbatuar reformat e nevojshme në mënyrë efektive.

Në kontekst të këtyre gjetjeve, Vetëvlerësimi ofron një pasqyrë të detajuar të progresit të Kosovës në zbatimin e Marrëveshjes së OBT-së për Lehtësimin e Tregtisë dhe mund të shërbejë si një mjet i vlefshëm për politikëbërësit, palët e interesuara (veçanërisht sektorin privat) dhe donatorët për të kuptuar saktë gjendjen me reformat për lehtësimin e tregtisë në Kosovës dhe për të mbështetur përpjekjet e saj të vazhdueshme për të përmirësuar proceset dhe procedurat që lidhen me tregti, për të rritur transparencën dhe për të nxitur rritjen ekonomike përmes rritjes së tregtisë ndërkombëtare.

Qeveria e Kosovës në koordinim me donatorët mbështetës të reformave në këtë fushë duhet të bëjë një plan të operacionalizimit dhe implementimit të 60 rekomandimeve të cilat kanë rezultuar nga procesi i Vetëvlerësimit me qëllim të avancimit të mëtejshëm të reformave në fushën e lehtësimit të tregtisë. Operacionalizimi nënkupton që për secilin kapitull të marrëveshjes të përcaktohen saktë qëllimet, indikatorët matës, afatet kohore të implementimit, kostot, institucionet përgjegjëse, dhe rezultatet e pritshme. Për më tepër, ky proces duhet të identifikoj mekanizmin koordinues të këtyre reformave dhe të ndajë reformat në fusha të veçanta veprimi. Në vijim janë disa propozime mbi operacionalizimin e planit:

1. KNLNT duhet të shërbejë si trupë koordinuese për implementim të rekomandimeve të dala nga procesi i Vetëvlerësimit. Meqenëse fusha e lehtësimit të tregtisë është ndërinstitucionale,

implementimi i këtyre rekomandimeve duhet të bëhet nën ombrellën e KNLT-së. Që ky mekanizëm të rritë efikasitetin e vet si në rrafshin e koordinimit institucional dhe në atë të politikave duhet t'i rriten kapacitetet, veçanërisht ato njerëzore.

2. Një pjesë e rëndësishme e masave që duhet ndërmarrë janë ndërinstitutionale, apo prekin të gjithë institucionet që lidhen jo vetëm me lehtësimin e tregtisë. Në masa të tilla duhet përfshirë:

- Rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe zhvillimin e kapaciteteve ekzistuese njerëzore;
- Avancimin e sistemeve elektronike të shkëmbimit të të dhënave dhe rritjen e ndërveprueshmërisë së tyre;
- Rritjen e koordinimit ndërinstitutional.

3. Janë katër fusha specifike të cilat mbulojnë gati në tërësi rekomandimet e dala nga Vetëvlerësimi. Për secilën fushë duhet të përcaktohet institucioni/personi përgjegjës si bartës i procesit. Fushat specifike të reformave të lidhura me lehtësimin e tregtisë mbulojnë:

- Rritjen e transparencës dhe qasjes në informata për publikun, me theks të veçantë tek sektori privat;
- Thjeshtësimin e mëtejme të formaliteteve, dokumentacionit të kërkuar, tarifave e ngarkesave të tjera në eksport dhe import. Qëllimi i këtyre masave duhet të jetë implementimi i tyre në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;
- Avancimin e mëtejme të procedurave për thjeshtëzimin dhe lirin më të shpejtë të mallrave në procesin e zhdoganimit;
- Rritjen e bashkëpunimit ndërinstitutional me qëllim të rritjes së efektivitetit të kontroleve kufitare.

Tabela e Vetëvlerësimit në vijim, e përgatitur sipas metodologjisë së përcaktuar nga OBT, përmban tekstin e nenit përkatës nga marrëveshja e OBT-së për lehtësimin e tregtisë dhe përmban vlerësimin e përafrimit të Kosovës me këto kërkesa përmes shqyrtimit të gjendjes ekzistuese, identifikimit të fytyrës të ngushta dhe pengesave në realizimin e reformave, si dhe përcaktimin e hapave të radhës dhe rekomandimeve konkrete.

I.1 PUBLIKIMI

Teksti i marrëveshjes

I.1 Çdo Anëtar do të publikojë menjëherë informacionin e mëposhtëm në mënyrë jo diskriminuese dhe në mënyrë lehtësisht të qasshme, për t'u mundësuar qeverive, tregtarëve dhe palëve të tjera të interesuara të njihen me:

- (a) procedurat për importimin, eksportimin dhe tranzitin (përfshirë portin, aeroportin dhe procedura të tjera në pikat hyrëse), dhe formularët dhe dokumentet e kërkuara;
- (b) normat e aplikuara të detyrimeve dhe taksave të çdo lloji, të vendosura mbi ose në lidhje me importimin ose eksportimin;
- (c) tarifatat dhe ngarkesat e vendosura nga ose për agjencitë qeveritare, mbi ose në lidhje me importimin, eksportimin ose tranzitin;
- (d) rregullat për klasifikimin ose vlerësimin e produkteve për qëllime doganore;
- (e) ligjet, rregulloret dhe vendimet administrative të zbatimit të përgjithshëm në lidhje me rregullat e origjinës;
- (f) kufizimet ose ndalimet e importit, eksportit ose tranzitit;
- (g) dispozitat e ndëshkimit për shkeljet e formaliteteve të importit, eksportit ose tranzitit;
- (h) procedurat për ankimim ose rishikim;
- (i) marrëveshjet ose pjesët e tyre me çdo vend ose shtet në lidhje me importimin, eksportimin ose tranzitin; dhe
- (j) procedurat në lidhje me administrimin e kuotave tarifore.

I.2 Asgjë në këto dispozita nuk do të interpretohet se kërkon publikimin ose ofrimin e informacioneve përveç në gjuhën e Anëtarit siç thuhet në paragrafin 2.2.

Gjendja ekzistuese

A. Politika/korniza ligjore:

Pjesa dërmuese e informatave publikohen dhe përditësohen rregullisht në formë elektronike dhe fizike, dhe atë në shumicën e rasteve në të tri gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

Në faqet zyrtare të internetit të autoriteteve kompetente janë publikuar të dhëna dhe informacione lidhur me procedurat e importit, eksportit dhe tranzitit, si dhe informata shtesë nga fushëveprimi i atyre autoriteteve.

Në Doganën e Kosovës, normat e aplikuara të tatimeve indirekte në zbatim të procedurave doganore që aplikohen në import, eksport dhe tranzit, janë të inkuorpuara në TARIK (https://dogana.rks-gov.net/tarik/index_alb.html), si dhe në faqet e internetit të autoriteteve kompetente (<https://auvk.rks-gov.net/kontrolli-kufitar/informatori-per-import-te-artikujve-per-kontroll-kufitar-ne-republiken-e-kosoves>).

Po ashtu, rregullat për klasifikim të produkteve për qëllime doganore dhe të AUVK janë të miratuara dhe të publikuara në faqet e internetit të

autoriteteve kompetente (p.sh.. për AUVK shih: <https://auvk.rks-gov.net/kontrolli-kufitar/lista-e-mallrave-qe-i-nenshtrohen-kontrollit-veterinar-dhe-fitosanitar/>)

Të gjitha të dhënat dhe informacionet e lidhura me licencat, autorizimet, certifikatat që ndërlidhen me aplikimin e procedurave doganore, përfshirë edhe ankesat në vendime (ose në deklarata doganore), palëve të interesit i ofrohen përmes portalit e-Administrata.

Kosova ka Gazetën Zyrtare (<https://gzk.rks-gov.net>) ku publikohen me kohë legjislacioni primar dhe sekondar si dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Megjithatë, mënyra e publikimit në Gazetën Zyrtare nuk siguron një proces të lehtë të qasjes edhe në legjislacionin sekondar (psh. mungojnë vendimet e qeverisë që burojnë nga ligji bazë si Vendimi për Normat e Tatimit të Akcizës).

AKPPM-ja publikon në faqen e saj të internetit listën bazike të produkteve dhe pajisjeve medicinale të cilat posedojnë certifikatë dhe autorizim të marketingut, d.m.th.. kanë të drejtë për qarkullim në tregun e RKS-së. Ndërsa platforma elektronike BARNATARI i përmban të gjitha informacionet mbi procedurat për import dhe eksport të produkteve dhe pajisjeve medicinale. Mirëpo, kjo platformë është e kufizuar vetëm për palët (bizneset) të cilat aplikojnë për marrjen e licencës për import dhe eksport të produkteve dhe pajisjeve medicinale (<https://barnatari.rks-gov.net/Home/Login.aspx?ReturnUrl=/Home/default.aspx>). Me marrjen e licencës palët vazhdojnë me procedurat doganore dhe procedurat e tjera.

B: Procedurat

Janë miratuar aktet dhe procedurat për publikim të informacionit në përputhje me UA (Ministria e Administratës Publike) nr. 01/2015 për faqet e internetit të institucioneve publike, ku përcaktohen standardet për formën, përmbajtjen minimale, pamjen vizuale, dhe karakteristikat e tjera që duhet të kenë të gjitha faqet e internetit të institucioneve publike. Është vendosur kuadri institucional për publikim të informacionit në formë elektronike.

Brenda çdo autoriteti kompetent për zbatimin e detyrimeve për publikimin e informacionit tregtar, janë caktuar persona dhe struktura përgjegjëse për këtë qëllim të cilët u përgjigjen pyetjeve të arsyeshme në lidhje me procedurat doganore, lehtësirat, etj.

Janë avancuar kapacitetet administrative dhe të TI-së.

Në vazhdim, brenda MINT, po punohet për tregtinë e jashtme, ku do publikohet informacioni mbi procedurat e importit, eksportit dhe tranzitit dhe ankimimit, ndalesat dhe kufizimet etj.) e cila siguron publikimin e centralizuar të informacionit të parashikuar në paragrafin I.1 të nenit I të Marrëveshjes për Lehtësimin e Tregtisë në faqen e internetit të institucioneve. Kjo faqe interneti do të jetë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

	Është miratuar Ligji nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave si dhe Rregullorja 06/2015 për regjistrin qendror të Llojeve të Lejeve dhe Licencave (https://lejelicenca.rks-gov.net) i cili parasheh rishikimin e përhershëm të lejeve, licencave, dhe ngarkesave të tjera me qëllim të zvogëlimit të barrës administrative. Në AKPPM, normat e aplikuara të detyrimeve dhe taksave për produkte dhe pajisje medicinale janë të specifikuara në UA nr. 04/2017 për Tarifat e Shërbimeve të Ofruara në AKPPM, dhe është publike në faqen e internetit të AKPPM-së.
	C. Korniza institucionale
	Disa nga institucionet publike i kanë njësitë e tyre të informimit publik që i publikojnë informacionet mbi procedurat për eksport, import, tranzit dhe çështjet e tjera të lidhura me to, si dhe mbi legjislacionin përkatës dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në raste të tjera, institucionet nuk kanë as njësi të veçantë të informimit, e as persona që e mbulojnë këtë fushë (p.sh.. AKPPM). Në raste të caktuara, përveç njësite përkatëse të informimit, edhe dikasteret përkatëse i ndihmojnë njësitë përkatëse të informimit duke publikuar dhe përditësuar informatat rreth çështjeve në sferën e tyre të përgjegjësisë (p.sh.. Dogana e Kosovës).
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Niveli i personelit/stafit të rekrutuar në Doganën e Kosovës dhe AUVK në përgjithësi i plotëson kriteret bazë për transmetimin e informacionit zyrtar për publikun. Si do që të jetë, është nevojë urgjente për të shtuar dhe për të përgatitur stafin për të komunikuar informatat në mënyrë të thjeshtë publikut dhe për të shfrytëzuar mundësitë që krijojnë teknologjitë e reja të komunikimit në masë.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Gjatë ofrimit të informacionit për publikun në masë të konsiderueshme përdoret teknologjia bashkëkohore e komunikimit dhe informacionit (p.sh. faqet e internetit, portalet, TV, mediat sociale). Përveç që ka ngecje në përditësimin e informatave për publikun.
	- Në raste të caktuara, mungesa e publikimit të akteve nënligjore dhe vendimeve të nxjerra në nivel të Ministrive apo agjencive përkatëse në Gazetën Zyrtare të cilat do të ishin të rëndësishme për informim të palëve të interesit lidhur me masat e politikës tregtare (p.sh. mungesa e informatave për çështjet specifike, si aplikimi i sanksioneve nga Ministria e Punëve të Jashtme). - Gati në tërësi mungon koordinimi në mes të institucioneve përgjegjëse për publikimin e informatave për publikun si dhe aplikimi i standardeve të ndryshme në publikimin e informatave për publikun. - Mungesa e personelit adekuat (të trajnuar dhe me shkathësi adekuate) për publikimin e informatave në formë të qasshme për

	publikun dhe shfrytëzimin e teknologjive të fundit për komunikim në masë.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	1. Të përgatitet një analizë e gjendjes aktuale mbi nivelin e transparencës së institucioneve përgjegjëse kufitare, përfshirë këtu krijimin e një regjistri të të dhënave dhe informacioneve në dispozicion të publikut dhe nivelin e shfrytëzimit të tyre nga publiku. Kjo analizë gjithashtu duhet të ofrojë një pasqyrë të gjendjes të sistemeve ekzistuese teknike për mbledhjen, ruajtjen, shkëmbimin dhe publikimin e informacioneve dhe të dhënave për publikun. 2. Të publikohen të gjitha aktet përkatëse nënligjore dhe të përditësohen në baza të rregullta sikur që e parasheh legjislacioni në fuqi (p.sh. Neni 5 i Ligjit nr. 06/l-081 për qasje në dokumente publike: Rregullore (QRK) nr. 27/2018 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun: Udhëzimi Administrativ (MAP) nr. 01/2015 për faqet e internetit të Institucioneve Publike; Ligji nr. 03/l-190 për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.) 3. Të standardizohen informatat që publikohen nga autoritetet kompetente. 4. Të ngritën kapacitetet njerëzore për komunikim më të saktë me publikun, veçanërisht të ngritën kapacitet për shfrytëzimin e teknologjive të reja për komunikim me publikun.
Institucionet përgjegjëse	ZKM (udhëheqëse), MINT, MPJD, Dogana e Kosovës, AUVK, ATK, ASHI, AKPPM, institucionet e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk është raportuar.

1.2 INFORMACIONI I DISPONUESHËM NË INTERNET

Teksti i marrëveshjes	2.1 Çdo Anëtar do të vë në dispozicion dhe do të përditësojë në masën e mundshme dhe sipas rastit, nëpërmjet internetit, sa vijon: (a) një përshkrim të procedurave për importimin, eksportimin dhe tranzitin, duke përfshirë procedurat për ankim ose rishikim, që informon qeveritë, tregtarët dhe palët e tjera të interesuara për hapat praktikë të nevojshëm për importimin, eksportimin dhe tranzitin; (b) formularët dhe dokumentet e kërkuara për importimin në, eksportimin nga ose tranzitin përmes territorit të atij Anëtar; (c) informatat e kontaktit për pikat e kërimit të informacionit. 2.2 kurdoherë që është e mundur, përshkrimi i përmendur në nën-paragrafin 2.1 (a) do të bëhet gjithashtu i disponueshëm në një nga gjuhët zyrtare të OBT-së. 2.3 Anëtarët inkurajohen të vënë në dispozicion informacione të mëtejshme përmes internetit në lidhje me tregtinë, duke përfshirë legjislacionin përkatës në lidhje me tregtinë dhe artikuj të tjerë të përmendur në paragrafin 1.1
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Pjesa më e madhe e informatave të nevojshme në fushën e tregtisë ndërkombëtare publikohen dhe janë lehtësisht të qasshme në faqet e internetit të autoriteteve kompetente, duke përfshirë përshkrimin e procedurave për import, eksport dhe tranzit, apelim ose rishikim, formularë dhe dokumentacione të nevojshëm. Për më tepër, autoritetet kompetente përgatisin edhe udhëzues dhe informatorë për të bërë më të qasshme procedurat për tregti, si dhe çështjet e lidhura me tregtinë ndërkombëtare. Gjithashtu, informatat mbi legjislacionin që lidhen me tregtinë si dhe ato për marrëveshjet tregtare publikohen në faqet e internetit të autoriteteve kompetente. B: Procedurat Në përgjithësi, autoritetet përgjegjëse kufitare i kanë të miratuara procedurat e nevojshme për publikimin e informacioneve në nivel qendror si dhe për secilin institucionet kompetente (të rregulluara me akte të brendshme). Dogana e Kosovës ka miratuar procedurat dhe caktuar pikat e kontaktit. Përmbajtja e faqes së internetit të Doganës së Kosovës përditësohet rregullisht për të publikuar në mënyrë pro aktive informacionin e mëposhtëm: ▪ Ligjet, rregulloret dhe dokumentet tjera që rregullojnë procedurat doganore;

	▪ Informacion mbi procedurat e importit, eksportit dhe tranzitit, etj., si dhe formularët dhe dokumentet e kërkuara; ▪ Normat e aplikuara të detyrimeve dhe taksave të vendosura në lidhje me importimin ose eksportimin; ▪ Të dhënat mbi shkëmbimet tregtare (Open data);
	C. Korniza institucionale
	Është krijuar korniza institucionale për publikimin dhe përditësimin e informacioneve në formë elektronike. P.sh.. Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit, zyrat për informim në të gjitha institucioneve përgjegjëse, dhe sektorët për këshilla dhe procedura (ky i fundit në Doganën e Kosovës). Të gjithë këta mekanizma bëjnë publikimin dhe përditësimin e të dhënave në internet, shpesh të ndihmuar edhe nga personeli që mbulon dikasteret përkatëse.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Janë avancuar kapacitetet administrative dhe burimet njerëzore për përgatitjen, publikimin dhe përditësimin e informatave në internet.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Janë marrë veprime konkrete për avancimin e faqeve të internetit, dhe tani të njëjtat ofrojnë të dhëna dhe informacione të bollshme për publikun. Në vitin 2022, AUVK dhe Dogana e Kosovës i kanë përditësuar faqet e tyre të internetit me qëllim që t'i bëjnë më të qasshme për palët e treta. AKPPM-ja e ka faqen e saj aktive të internetit (https://akppm.rks-gov.net), në të cilën publikohen informata bazë mbi agjencinë, legjislacionin, procedurat për pajisje me licenca të importit dhe eksportit, e kështu me radhë.
	F. Pajisjet & infrastruktura
	Kapacitetet e specializuara për TIK janë rritur substancialisht. Qeveria ka ndërmarrë masa për stimulimin shtesë të personelit të TIK në nivel vendi.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	▪ Vonesat edhe më tutje janë evidente në përditësimin e faqeve të internetit me legjislacion të ri dhe atë legjislacion mbështetës, veçanërisht në institucione të caktuara. ▪ Mos kompletimi i akteve nënligjore brenda ministrive të linjës dhe agjencive që identifikojnë se çfarë informacioni duhet të publikohet në internet dhe çfarë procedurash duhet ndjekur. ▪ Mungesa e koordinimit ndërmjet ministrive të linjës për informatat që duhet publikuar dhe formatin e tyre. ▪ Përkundër avancimeve, stafi aktual ka njohuri relativisht të kufizuara sa i përket informacioneve që duhen të bëhen të disponueshme në internet dhe aplikimit të teknologjive të reja të komunikimit.

Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	5. Të avancohen pajisjet e TIK (softuer dhe harduer) në përputhje me kërkesat dhe standardet e BE-së për publikimin e të dhënave dhe informatave për publikun. 6. Të rritet numri i personelit administrativ në institucione të caktuara që merren me publikimin e informacioneve dhe të dhënave për publikun. 7. Të identifikohen nevojat për trajnim të personelit si dhe të identifikohen grupet e synuara në varësi të fushave që kërkojnë ndërgjegjësim të publikut.
Institucionet përgjegjëse	ZKM (udhëheqëse), MINT, MPJD, Dogana e Kosovës, AUVK, ASHI, AKPPM, institucionet e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht ☒ KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë ☒ MESE I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet.

I.3 PIKAT E KËRKIMIT TË INFORMACIONIT

Teksti i marrëveshjes	3.1 Çdo Anëtar, bazuar në burimet që i ka në dispozicion, do të krijojë ose mbajë një ose më shumë pika të kërkimit të informacionit për t'iu përgjigjur pyetjeve të arsyeshme të qeverive, tregtarëve dhe palëve të tjera të interesuara për çështjet e mbuluara nga paragrafi 1.1 dhe për të siguruar formularët dhe dokumentet e kërkuara të përmendura në nën-paragrafin 1.1. (a). 3.2 Anëtarët e një unioni doganor, ose të përfshirë në integrimin rajonal, mund të krijojnë ose mbajnë pika të përbashkëta të kërkimit të informacionit në nivel rajonal për të përmbushur kërkesat e paragrafit 3.1 për procedurat e përbashkëta. 3.3 Anëtarët inkurajohen të mos kërkojnë pagesë tarifore për ofrimin e përgjigjeve në informacionet e kërkuara dhe sigurimin e formularëve dhe të dokumenteve të kërkuara. Nëse ka, Anëtarët do të përcaktojnë nivelin e tarifave apo të ngarkesave duke u bazuar në koston e përafërt të shërbimeve të ofruara. 3.4 Pikat e kërkimit të informacionit do t'iu përgjigjen informacioneve të kërkuara dhe do të ofrojnë formularët dhe dokumentet brenda një periudhe të arsyeshme kohore të caktuar nga secili Anëtar, e cila mund të ndryshojë në varësi të natyrës ose kompleksitetit të kërkesës.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Ende nuk janë themeluar pikat e kërkimit të informacioneve në institucionet përgjegjëse kufitare. Mirëpo, Dogana e Kosovës në faqen e saj zyrtare i ka të publikuara sqarimet bazike lidhur me procedurat doganore, doracakë, udhëzues, si dhe dispozitat ligjore që i trajtojnë këto procedura. Për sqarime të hollësishme, Dogana e Kosovës është në shërbim të publikut dhe të bizneseve duke i trajtuar kërkesat e tyre të adresuara përmes postës elektronike ose kontakteve direkte. Të gjitha informatat që ofrohen janë pa pagesë. Në anën tjetër, Departamenti i Tregtisë në kuadër të MINT realizon takime ad-hoc varësisht nga kërkesat e bizneseve të ndryshme me ç'rast i adresojnë dhe informohen për çështje të lidhura me fushën e tregtisë së mallrave. Gjithashtu, përmes takimeve të KNLT-së adresohen çështje të ndryshme të bizneseve në lidhje me barrierat tregtare me të cilat ballafaqohen si në tregun rajonal ashtu edhe në tregun e brendshëm. Nuk kërkohet të paguhet asnjë tarifë apo pagesë tjetër për t'iu përgjigjur kërkesave për informacione. B: Procedurat

	Draft rregullorja për QILT (Qendra Informative për Lehtësimin e Tregtisë) është shkruar në 2018 mirëpo ka mbetur e pa finalizuar si rezultat i mos-ratifikimit të AP5 CEFTA nga ana e Republikës së Kosovës. Aktualisht mungon një qendër e vetme informative ku komuniteti i biznesit mund të kërkojë informacion.
	C. Korniza institucionale
	Asnjë institucion nuk i ka të krijuara pikat e kërkimit të informacionit dhe komunikimin me palët e treta e bëjnë përmes formave të tjera të prezantuara në pikat e mëparshme. Krijimi i QILT, mekanizëm ky që do të kryej funksionin e pikës së kërkimit të informacionit, është i paraparë për vitin 2024 bazuar në Programin për Reforma Ekonomike, ndërsa në vitin 2025 duhet të fillojë së funksionuari.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Për themelimin dhe funksionimin e pikave të kërkimit të informacionit numri i personelit është i kufizuar dhe me shkathësi të limituara. Funksionimi i QILT kërkon emërimin e një personi përgjegjës për çdo Ministri dhe Agjenci, në lidhje me ofrimin e informacioneve të nevojshme për lehtësira tregtare.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Infrastruktura e TIK në Doganën e Kosovës dhe AUVK është në nivel të kënaqshëm për t'i funksionalizuar këto pika.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	▪ Mungesa e pjesshme legjislacionit adekuat që parasheh themelimin e dhe funksionalizimin e plotë të QILT-it. ▪ Mungesa e personelit të mjaftueshëm dhe të përgatitur në mënyrë të duhur funksionalizimin e QILT. ▪ Në disa institucione, mungesa e pajisjeve të TIK për integrimin në QILT. ▪ Mungesa e procedurave standarde të operimit për funksionalizimin e efikas të QILT.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	<i>(Për realizimin e rekomandimeve në vijim, parakusht kryesorë është ratifikimi i AP5 në Kuvendin e Republikës së Kosovës)</i> 8. Finalizimi i ekzaminimit të gjendjes aktuale si dhe finalizimit të rekomandimeve për themelimin dhe funksionalizimin e QILT-it. 9. Kompletimi i kuadrit ligjor aty ku mungon. 10. Përgatitja e procedurave standarde të operimit në nivelin qendror të cilat i përcaktojnë detyrat dhe veprimtarinë e QILT-it (standartet për trajtimin e kërkesave, kohën e trajtimit, formularët standard, mënyra dhe mjetet e komunikimit dhe përgatitja dhe përmbledhja e pyetjeve dhe përgjigjeve standarde.

	II. Të ofrohet një program i specializuar për trajnim të stafit/personelit për ofrimin e informatave të nevojshme për publikun.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK, AKPPM, MINT, dhe institucionet e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht Kryesisht Pjesërisht ☒ ASPAK Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë ☒ MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk është raportuar.

I.4 NJOFTIMI/NOTIFIKIMI

Vërejtje: Kjo pikë e mbulon komunikimin e Qeverisë së vendit anëtar të OBT-së me Komitetin e OBT-së për Lehtësimin e Tregtisë. Pasi që Kosova nuk është anëtare e OBT-së, diskutimi e mbulon funksionimin e KNLT-së në nivel vendi dhe në nivel të CEFTA-s, apo me Komitetin e CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë

Teksti i marrëveshjes	4.1 Secili Anëtar do të njoftojë Komitetin për Lehtësimin e Tregtisë, të krijuar sipas paragrafit 1.1 të Nenit 23 (i referuar në këtë Marrëveshje si "Komiteti") i: (a) vendi(et) zyrtar/e ku janë publikuar çështjet në nën-paragrafët 1.1 (a) deri (j); (b) URL-të e faqeve të internetit të përmendura në paragrafin 2.1; dhe (c) informacionet kontaktuese të pikave të kërkimit të informacionit të përmendura në paragrafin 3.1.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Komiteti Nacional për Lehtësimin e Tregtisë (KNLT) është themeluar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në vitin 2016, ndërsa është riformatuar me vendimin e Ministres së MINT nr. 01/03 të datës 06.02.2023. Themelimi i këtij Komiteti në nivel nacional, të cilin tanimë e kanë themeluar të gjitha vendet anëtare të CEFTA-s, buron nga Protokollu 5 i CEFTA-s (AP5), i cili është konceptuar bazuar në marrëveshjen për lehtësimin e tregtisë në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT). Komiteti ka si synim që përmes koordinimit të akterëve të përfshirë në lehtësimin e tregtisë të përmirësojë ambientin e të bërit biznes në Kosovë, gjegjësisht përmirësimin e mëtejshëm të procedurave dhe të rregullave për import dhe eksport, me çka do të mundësojë lehtësimin e tregtisë në mes të Kosovës dhe vendeve të tjera, me theks të veçantë vendeve fqinje. Anëtarë të KNLT-së janë përfaqësuesit e institucioneve relevante, anëtarët e Agjencive kufitare si dhe përfaqësuesit e komunitetit të biznesit. Komiteti për lehtësimin e tregtisë në kuadër të CEFTA-s është themeluar në vitin 2015 ku u vendos të rregullohen strukturat e CEFTA-s, me synimin për t'i përgjigjur prioritetëve të CEFTA-s dhe për të forcuar kapacitetin monitorues të strukturave të CEFTA-s për zbatimin e Marrëveshjes CEFTA 2006, si dhe raportimin e tyre për rezultatet e zbatimit në Komitetin e Përbashkët të CEFTA-s. Në këtë rast, Komiteti i Lehtësimit të Tregtisë e ka të definuar mandatin e tij. Detyra e Komitetit të Lehtësimit të Tregtisë është të zhvillojë dhe të zgjerojë bashkëpunimin ndërmjet Palëve të CEFTA-s, veçanërisht për t'i adresuar çështjet që kanë të bëjnë me lehtësimin e tregtisë rajonale në CEFTA, me synimin për të reduktuar kostot e shkaktuara nga procedurat joefikase të të gjitha llojeve të zhdoganimit, duke e balancuar lehtësimin e tregtisë me rritje të kërkesave për masat e sigurisë në zinxhirin e furnizimit ndërkombëtar dhe rajonal.

	MINT i udhëheq procedurat e njoftimit me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale. Në këtë kontekst, përkundër faktit që Kosova nuk e ratifikuar Protokolin AP5 të CEFTA-s, përmes pikës së kontaktit në CEFTA si dhe përfaqësuesve të saj në komitete dhe nën-komiteteve implementon provizionet që burojnë nga AP5, përfshirë këtu edhe nenin 6 të këtij Protokolli që mbulon Notifikimet/Noftimet mbi Kontrollat e Zgjeruara dhe Inspektimet.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Në kuadër të DT-së në MINT, një staf i përhershëm është i caktuar si pikë kontakti me Sekretariatit e CEFTA-s. Në kuadër të autoriteteve kompetente ka numër të mjaftueshëm personeli të disponueshëm për t'i kryer funksionet e njoftimit. Në vazhdimësi janë duke u ofruar trajnime për personelin përkatës të cilët do të sigurojnë asistencë teknike, plotësimin dhe përditësimin e përmbajtjes së portalit (faqe e internetit, rrjete sociale, etj.)
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Koordinim jo i mjaftueshëm ndërinstitutional për zbatim të procedurave të notifikimit në nivel rajonal ashtu edhe në atë nacional
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	12. KNLT, në koordinim me institucionet e tjera përgjegjëse, do të bëjë përpjekje për të rritur komunikimin ndërinstitutional dhe për të fuqizuar procesin e notifikimit veçanërisht me Komitetin e CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë, në kontekst të: ▪ Vendi(t) zyrtar/e ku janë publikuar artikujt nga masa (I); ▪ URL-të e faqeve të internetit që i përshkruajnë procedurat për importimin, eksportimin dhe tranzitin, duke i përfshirë procedurat për shqyrtimin e apelit, duke i informuar qeveritë, tregtarët dhe palët e interesuara për hapat praktik të nevojshëm për formën e importimit, eksportimit dhe tranzitin; ▪ Me krijimin e tyre, informacionet mbi pikat e kërkimit të informacionit të përmendura në pikën 3.I “Vendimet Paraprake”.
Institucionet përgjegjëse	MINT (udhëheqëse); Dogana e Kosovës (udhëheqëse), dhe institucionet e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht Kryesisht PJESËRISHT Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESËM

	I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	IFC, USAID

2.1 MUNDËSI PËR KOMENT, INFORMACIONET PARA HYRJES NE FUQI, DHE KOMENTIMI

Teksti i marrëveshjes	I.1 Çdo Anëtar, për aq sa është praktike dhe në përputhje me legjislacionin vendor dhe sistemin ligjor, do t'u ofrojë mundësi dhe një periudhë të përshtatshme kohore tregtarëve dhe palëve të tjera të interesuara për të komentuar mbi prezantimin ose ndryshimin e propozuar të ligjeve dhe të rregulloreve të zbatimit të përgjithshëm lidhur me lëvizjen, lirin dhe zhdoganimin e mallrave, duke përfshirë mallrat në tranzit. I.2 Çdo Anëtar, për aq sa është praktike dhe në përputhje me legjislacionin vendor dhe sistemin ligjor, do të sigurojë që ligjet dhe rregulloret e reja ose të ndryshuara të zbatimit të përgjithshëm që lidhen me lëvizjen, lirin dhe zhdoganimin e mallrave, duke përfshirë mallrat në tranzit, publikohen, ose informacionet për to vihen në dispozicion të publikut, sa më shpejt që të jetë e mundur para hyrjes në fuqi, për t'u mundësuar tregtarëve dhe palëve tjera të interesuara njohjen me to. (I.3) Ndryshimet në normat e detyrimeve ose të tarifave, masat që kanë një efekt lehtësues, masat efikasiteti i të cilave do të dëmtohej si rezultat i pajtueshmërisë me paragrafët I.1 ose I.2, masat e zbatuara në rrethana urgjente ose ndryshimet e vogla në ligjin vendas dhe në sistemin ligjor janë të gjitha të përjashtuara nga paragrafët I.1 dhe I.2.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Bazuar në Rregulloren për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik nr. 05/2016 (aprovuar nga QRK në vitin 2016), ZKM obligohet të krijojë dhe të mirëmbajë platformën në internet (https://konsultimet.rks-gov.net) të cilën e shfrytëzojnë të gjitha organet publike për t'i identifikuar hisedarët për zhvillimin e konsultimeve me publikun. Qëllimi i kësaj platforme është të ndihmojë Ministrinë dhe agjencitë brenda institucioneve të Republikës së Kosovës për të lehtësuar procesin e konsultimeve publike, me përfshirjen e autoriteteve publike dhe të sektorit privat. Në përgjithësi, në miratimin e akteve ligjore ndiqen hapat si në vijim: Akti ligjor dhe aktet e tjera nënligjore të cilat nxirren nga Ministria përkatëse, fillimisht hyjnë në program legjislativ, pastaj formohet grupi punues për hartimin e tij. Pas finalizimit të aktit, akti dërgohet në konsultim paraprak, pastaj në konsultim publik. Pas konsultimit publik përgatitet raporti me komentet e pranuar nga konsultimi. Pas publikimit të raportit, drafti final i aktit dërgohet në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për vlerësim të ndikimit buxhetor, si dhe në Departamentin për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave për konformitetin e aktit me <i>acquis</i> të BE-s dhe në Zyrën Ligjore të ZKM-së. Pas kthimit të përgjigjeve nga këto institucione, Departamenti Ligjor/Drejtori i DL-së e përcjell projektligjin me të gjitha shkresat përcjellëse te Sekretari dhe Kabineti i Ministrisë përkatëse. Pas marrjes së pëlqimit nga Sekretari dhe Kabineti,

	projektligji dërgohet në ZKM për aprovim. Pas aprovimit të Qeverisë, projektligji dërgohet në Kuvend për miratim. Pas dekretimit nga Presidentja, ligji shpallet në Gazetën Zyrtare: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=55136
	B: Procedurat
	I gjithë kuadri ligjor që e përcakton konsultimin publik si procedurë të detyrueshme është i miratuar dhe funksional. Rregulloret përfshijnë: Rregullorja për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik nr. 05/2016, Rregullorja nr. 13/2013 për Shërbimet Juridike Qeveritare, si dhe Rregullorja nr. 09/2011 për Rregullat e Punës së Qeverisë.
	C. Korniza institucionale
	Ministritë e linjës udhëheqin me procesin nëse ligji përfshin fushën e tyre përkatëse të përgjegjësisë. Janë Departamentet Ligjore të Ministrive përkatëse ato të cilat e bartin barrën kryesore të procesit të konsultimeve me publikun.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Stafi përgjegjës brenda ministrive të linjës e udhëheq procesin. Në raste të caktuara, shkathtësitë e personelit që janë të ngarkuar me procesin e konsultimeve me palët e treta janë të kufizuara.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Mungesa e inuteve nga palët e treta për të ofruar komente mbi legjislacionin që është në proces të konsultimeve.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	13. Analiza e gjendjes ekzistuese në procesin e konsultimeve të legjislacionit përkatës me qëllim të gjetjes së defekteve në procesin e komunikimit dhe mosdhënies së inuteve nga palët e treta. 14. Të forcohen mekanizmat e qarkullimit të informacioneve për konsultime (institucione – sektor privat) dhe të promovohen (fushata vetëdijësuese përmes mediave, platformave të tjera) dhe të ofrohen stimuj për dhënie të komenteve nga palët e interesit dhe përfshirje në vendimarrje.
Institucionet përgjegjëse	ZKM (udhëheqëse), MINT, Dogana e Kosovës, AUVK, dhe institucionet e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë

	I MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet.

2.2 KONSULTIMET

Teksti i marrëveshjes	Çdo Anëtar, sipas rastit, do të sigurojë konsultime të rregullta në mes të agjencive kufitare dhe tregtarëve ose palëve të tjera të interesit brenda territorit të tij/saj.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Konsultimi publik është i rregulluar në nivelin qendror, dhe është obligativ për të gjitha institucionet përgjegjëse. Legjislacioni në fuqi – neni 32 të Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011 dhe Rregullorja (QRK) nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik si dhe Rregullorja nr. 13/2013 për Shërbimet Juridike Qeveritare – i obligon të gjitha autoritet kompetente të kenë konsultime me palët e treta. Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime (KKEI) i themeluar në 2020 (Vendimi Qeverisë së Republikës së Kosovës 05/24 i datës 14.08.2020), i cili ka zëvendësuar Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të themeluar në 2015) është një mekanizëm tjetër që shërben për konsultime publike në mes të Qeverisë dhe institucioneve përgjegjëse me sektorin privat dhe aktorët e tjerë në ekonomi. Komiteti Nacional për Lehtësimin e Tregtisë shërben edhe si mekanizëm konsultativ në mes të agjencive kufitare dhe sektorit privat. Për detajet e tjera në lidhje me funksionet dhe punën e KNLT-në shih pikën 1.4 Njoftimi/Notifikimi. B: Procedurat Legjislacioni i apostrofuat më lartë (shih “ Politika/korniza ligjore”) parasheh qartë procedurat e konsultimit publik, përfshirë edhe afatet kohore për konsultime si dhe palët me të cilat realizohen konsultimet. C. Korniza institucionale Institucioni propozues (psh. Ministria apo agjensioni përkatës) ka përgjegjësinë të konsultohet me të gjitha autoritetet përkatëse. Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime është themeluar me vendim të Kryeministrit të Republikës së Kosovës 05/24 i datës 14.08.2020, në kuadër të së cilit funksionon Sekretariati i Këshillit si mekanizëm mbështetës i punëve të KKEI. DT së bashku me Doganën e Kosovës është bashkëkryesuese e KNLT-së. DT luan rolin e Sekretarisë së KNLT-së. D. Burimet njerëzore/trajnimi Stafi brenda kornizës ekzistuese institucionale është jo i mjaftueshëm si dhe mesatarisht i trajnuar për të ofruar konsultime me publikun.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Kapacitete të limituara njerëzore dhe teknike për realizimin e konsultimeve publike me palët e treta.

Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	15. Krijimi i një plani për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe teknike për realizimin e konsultimeve me palët e treta, veçanërisht me sektorin privat.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK dhe institucionet e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESËM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

3.1 VENDIMET PARAPRAKE

Teksti i marrëveshjes

1. Çdo Anëtar do të lëshojë vendim paraprak në një mënyrë të arsyeshme dhe të kufizuar në kohë për aplikuesin që ka paraqitur një kërkesë me shkrim që e përmban të gjithë informacionin e nevojshëm. Nëse një Anëtar refuzon të nxjerrë një vendim paraprak, ai do të njoftojë menjëherë aplikuesin me shkrim, duke i përcaktuar faktet përkatëse dhe bazën mbi të cilën është marrë vendimi.
2. Një Anëtar mund të refuzojë të lëshojë një vendim paraprak për aplikuesin kur pyetja e ngritur në aplikim:
 - (a) është tashmë në pritje në çështjen e aplikuesit përpara ndonjë agjencie qeveritare, gjykate apeli ose gjykate tjetër; ose
 - (b) është vendosur tashmë nga ndonjë gjykatë apeli ose gjykatë tjetër.
3. Vendimi paraprak do të jetë i vlefshëm për një periudhë të arsyeshme kohore pas nxjerrjes së tij, përveç nëse ligji, faktet ose rrethanat që e mbështesin atë vendim kanë ndryshuar.
4. Kur Anëtari e anulon, modifikon ose zhvleftëson vendimin paraprak, ai duhet t'i japë një njoftim me shkrim aplikuesit duke i paraqitur faktet përkatëse dhe bazën për vendimin e tij. Kur një Anëtar i revokon, modifikon ose zhvleftëson vendimet paraprake me efekt prapaveprues, ai mund ta bëjë këtë vetëm kur vendimi fillestar është bazuar në informacione jo të plota, të pasakta, të rreme ose mashtruese.
5. Një vendim paraprak i lëshuar nga një Anëtar do të jetë i detyrueshëm për atë Anëtar në lidhje me aplikuesin që e ka kërkuar atë. Anëtari mund të parashohë që vendimi paraprak është i detyrueshëm për aplikuesin.
6. Çdo Anëtar do të publikojë, të paktën:
 - (a) kërkesat për aplikimin për një vendim paraprak, duke përfshirë informacionin që do të sigurohet dhe formatin;
 - (b) periudhën kohore në të cilën do të nxjerrë një vendim paraprak; dhe
 - (c) kohëzgjatjen për të cilën vendimi paraprak është i vlefshëm.
7. Çdo Anëtar do të sigurojë, përmes kërkesës me shkrim të një aplikuesi, një rishikim të vendimit paraprak ose vendimit për të revokuar, modifikuar ose zhvlerësuar vendimin paraprak.
8. Çdo Anëtar do të përpiqet të bëjë të disponueshëm publikisht çdo informacion mbi vendimet paraprake të cilat i konsideron me interes të rëndësishëm për palët e tjera të interesuara, duke marrë parasysh nevojën për të mbrojtur informacionin konfidencial komercial.
9. Përkufizimet dhe shtrirja:
 - (a) Vendimi paraprak është një vendim me shkrim i lëshuar nga një Anëtar për aplikuesin përpara importimit të një malli të mbuluar nga kërkesa, ku përcaktohet trajtimi që Anëtari do t'i bëjë mallit në kohën e importimit në lidhje me:

	(i) klasifikimin tarifor të mallit; dhe (ii) origjinën e mallit. (b) Përveç vendimeve paraprake të përcaktuara në nën-paragrafin (a), Anëtarët inkurajohen të japin vendime paraprake për: (i) metodën ose kriteret e duhura dhe zbatimin e tyre, që do të përdoren për përcaktimin e vlerës doganore sipas një grupi të caktuar faktesh; (ii) zbatueshmërinë e kërkesave të Anëtarit për lirim ose përjashtim nga detyrimet doganore; (iii) zbatimin e kërkesave të Anëtarit për kuota, duke i përfshirë këtu kuotat tarifore; dhe (iv) cilëndo çështje shtesë për të cilën një Anëtar e konsideron të përshtatshme nxjerrjen e një vendimi paraprak. (c) Aplikuesi është një eksportues, importues ose çdo person me një shkak të justifikuar ose një përfaqësues i tyre. (d) Një Anëtar mund të kërkojë që aplikuesi të ketë përfaqësim ligjor ose regjistrim në territorin e tij. Për atë që është e mundur, kërkesat e tilla nuk do t'i kufizojnë kategoritë e personave të kualifikuar për të aplikuar për vendime paraprake, duke i marrë parasysh veçanërisht nevojat specifike të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Këto kërkesa duhet të jenë të qarta dhe transparente dhe të mos përbëjnë një mjet për diskriminim arbitrar ose të pajustificueshëm.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Baza ligjore për aplikimin e informacionit detyrues për klasifikimin e mallrave sipas tarifës doganore dhe të origjinës është rregulluar me nenin 17-18 të Kodit doganor dhe akcizave (ligji nr.03/L-109) dhe nenin 8 deri 13 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për dispozitat zbatuese të këtij ligji. Kërkesa/formulari për informacionin detyrues tarifor dhe të origjinës mund të merret pranë Doganës së Kosovës sipas UA 2009/11, Aneksi 3, dhe të parashtrahet nëpërmjet Zyrës Administrative të Doganës së Kosovës. Afati kohor mbi njoftimin për informacionin e detyrueshëm të origjinës, duhet të njoftohet brenda afatit kohor prej 150 ditësh nga dita kur është pranuar kërkesa. Dokumentet të cilat kërkohen t'i bashkëngjiten formularit duhet të paraqiten në origjinal. Në rast të refuzimit të kërkesës për informacionin detyrues të origjinës, Dogana e Kosovës lëshon aktvendim mbi refuzimin e kërkesës brenda 30 ditësh nga pranimi i kërkesës. Formulari për aplikuesit që përfitojnë nga skema e Sistemit Gjeneral të Preferencave për Zvicër dhe Norvegji mund të merret nëpërmjet faqes së

	internetit të Doganës së Kosovës dhe të parashtrohet pranë Doganës së Kosovës. Dogana e Kosovës kërkesat e pranuar për GSP i regjistron në sistemin online REX Authorisation/EU. Legjislacioni doganor dhe legjislacioni tjetër në nivel vendi e mbron informacionin konfidencial (Ligji nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar).
	B: Procedurat
	Kuadri ligjor lidhur me procedurat, kushtet dhe afatet për dhënien e informatës detyruese tarifore dhe të origjinës është përcaktuar me nenin 9-10 të UA 11/2009 dhe është publikuar në faqen e internetit tëDK-së.
	C. Korniza institucionale
	Në kuadër të Drejtorisë së Doganës së Kosovës, si strukturë e ngarkuar për përpunimin e kërkesave për lëshimin e informacionit të detyrueshëm, analizës dhe vendosjes për tarifën e mallrave, urdhërimin e analizave laboratorike, gjegjësisht procesin e lëshimit të informacionit detyrues është Drejtoria e Akcizës, Tarifës, Origjinës, Laboratorit dhe Procedurave. Në kuadër të Doganës së Kosovës janë konsoliduar njësi administrative të cilat e sigurojnë informacionin e detyrueshëm që aplikuesi mund ta kërkojë.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Në Doganën e Kosovës ekzistojnë resurse të kënaqshme, të cilat sigurojnë administrimin e procedurës për informacionin detyrues që aplikuesi mund ta kërkojë. Personeli pranë zyrave doganore është i trajnuar për zbatimin praktik të informacionit detyrues me rastin e zhdoganimit të mallrave. Për personelin e ngarkuar me këto përgjegjësi vazhdimisht ofrohen trajnime përkatëse. Laboratori Doganor është rritur me dy kimistë laboratorik (stafi në total 4). Stafi i Laboratorit Doganor i tëri është me përgatitje profesionale superiore dhe me përvojë të gjatë në fushën e njohjes së mallrave, testimit dhe klasifikimit të tyre, me njohuri të thella në fushën e akreditimit ku shumica prej tyre janë ekspertë teknik të akreditimit, standardizimit, instrumenteve analizuese, metodave të testimit, etj. Stafi ka trajnime periodike profesionale që janë të aprovuara nga CLEN.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Dogana e Kosovës ka në funksion një sistem elektronik të avancuar të quajtur “LESS” për administrimin e procedurës për lëshimin e vendimeve për informacion detyrues që aplikuesi mund ta kërkojë nga Dogana e Kosovës. Dogana e Kosovës ka funksionalizuar Laboratorin Doganor i cili është themeluar me qëllim të përmbushjes së kriterëve integruese evropiane të

	doganave. Ky Laborator është anëtar i Rrjetit Evropian të Laboratorëve Doganor (CLEN-Customs Laboratory European Network). Laboratori i Doganës është i akredituar me standardin SK EN ISO IEC 17025:2018 “Kërkesat e përgjithshme për laboratorët testues dhe kalibruar”. Të gjitha pajisjet e Laboratorit Doganor përkrahin metoda të standardizuara dhe janë 100% funksionale. Laboratori për çdo vit është duke u furnizuar me pajisje të ndryshme analizuese dhe janë bërë planifikime edhe për vitet e ardhshme për shtim të pajisjeve.
	G. Çështje të tjera që duhet theksuar
	Institucionet përgjegjëse kanë dhënë vendime meritore duke e pasur mundësinë për të bashkëpunuar edhe me institucione të tjera profesionale të fushës përkatëse.
Pengesat (ofroni arsytet për mospërputhje)	Blerja e pajisjeve shtesë për analizimin e mallrave të ndryshëm, në procedura të importit, eksportit dhe tranzitit si dhe zbatimin e procedurave mbi vendimet paraprake.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	16. Avancimi i mëtejshëm i kapaciteteve laboratorike me qëllim të avancimit të procedurave të importit, eksportit dhe tranzitit si dhe zbatimi i procedurave mbi vendimet paraprake. 17. Zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve njerëzore për përcaktimin e tarifave.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (veçanërisht, Laboratori i Doganës së Kosovës, udhëheqëse), MINT, dhe institucionet e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht ☒ KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë ☒ I MESËM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

4.1 E DREJTA PËR APELIM OSE RISHQYRTIM

Teksti i marrëveshjes	1. Çdo Anëtar do të sigurojë që secili person, të cilit Dogana i jep një vendim administrativ, ka të drejtë, brenda territorit të tij, për: (a) një ankim administrativ ose shqyrtim nga një autoritet administrativ më i lartë ose i pavarur nga zyrtari ose zyra që e ka dhënë vendimin; dhe/ose (b) një ankim gjyqësor ose rishikim të vendimit. 2. Legjislacioni i një Anëtari mund të kërkojë që një ankim ose rishikim administrativ të fillohet përpara një ankimi ose rishikimi gjyqësor. 3. Çdo Anëtar do të sigurojë që procedurat e tij për ankim ose rishikim të kryhen në mënyrë jo-diskriminuese. 4. Çdo Anëtar do të sigurojë që, në rastin kur vendimi për ankim ose rishikim sipas nën-paragrafit 1(a) nuk është dhënë as: (a) brenda periudhave të caktuara siç specifikohet në ligjet ose rregulloret e tij; ose (b) pa vonesë të panevojshme, kërkuar ka të drejtën e ankimit të mëtejshëm ose shqyrtimit të mëtejshëm nga autoriteti administrativ ose autoriteti gjyqësor ose ndonjë mjet juridik tjetër tek autoriteti gjyqësor. 5. Çdo Anëtar do të sigurojë që personit të përmendur në paragrafin 1 t'i jepen arsyet për vendimin administrativ, në mënyrë që t'i mundësohet këtij personi që t'u drejtohet procedurave për ankim ose rishikim kur është e nevojshme. 6. Çdo Anëtar inkurajohet ti zbatojë dispozitat e këtij neni për një vendim administrativ të lëshuar nga një agjenci përkatëse kufitare, përveç doganave.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Ndaj vendimeve administrative të lëshuara nga dogana lidhur me zbatimin e legjislacionit doganor, çdo person ka të drejtën e ushtrimit të kërkesës për rishqyrtim. Kërkesa për rishqyrtim ushtrohet pranë Doganës në Sektorin për Rishqyrtimin e Vendimeve, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit (Kodi Doganor dhe i Akcizës së Kosovës, neni 13, paragrafi 3, lidhur me nenin 291). Kërkesat për rishqyrtim të vendimeve trajtohen brenda afateve kohore. Kodi Doganor dhe i Akcizës (Kodi Nr. 03/L-109), neni 291, i përcakton procedurat ankimore dhe të drejtën e ushtrimit të kërkesës për rishqyrtimin e vendimit të sjellë nga Dogana. Çdo person e ka të drejtën e ushtrimit të kërkesës për rishqyrtimin e vendimit të sjellë nga Dogana e i cili ka të bëjë me aplikim e legjislacionit doganor, i cili ka të bëjë me atë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

	Ankimimet në Dogana janë të lidhura në pjesën më të madhe me vlerësimin e mallrave. Si rrjedhojë, për qëllime të zbatimit praktik të legjislacionit doganor që e rregullon vlerësimin e mallit për çështje doganore, siç është paraparë me Kodin Doganor dhe të Akcizave (03-L/109) dhe me Udhëzimin Administrativ I I/2009 për zbatimin e këtij kodi, Dogana e Kosovës e ka hartuar doracakun për përcaktim të drejtë të vlerës doganore. Sqarimet e ofruara në këtë udhëzues bazuar në praktikën e mira që zbatohen nga vendet e BE-së, përpos që do t'i qartësojnë edhe më tej veprimet për vlerësim të drejtë doganor, do të krijojnë edhe një klimë të sigurt për bizneset për trajtim uniform dhe të drejtë, që indirekt do të ndikojë edhe në uljen e kërkesave për rishqyrtim. Vendimet e shkallës së parë në Dogana mund të apelojnë pranë Gjykatës Komerciale.
	B: Procedurat
	Procedurat për ankimim janë të përkufizuara në nenin 291 të KDA. Procedurat për ankimim të vendimeve të autoriteteve përkatëse shqyrtohen sipas ligjit përkatës si dhe Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
	C. Korniza institucionale
	Në kuadër të Doganave ekziston Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve, si organ i veçantë. MINT dhe AUVK nuk kanë një mekanizëm institucional të veçantë për shqyrtimin e ankesave, dhe bëhen në baza ad-hoc.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Niveli i burimeve njerëzore është i kënaqshëm. Trajtime brenda kësaj fushe janë ofruar në baza të rregullta nga Instituti Kosovar për Administratë Publike (IKAP).
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Ekziston regjistri elektronik për evidenca në kuadër të Doganave, i cili i regjistron edhe ankesat në kopje fizike si dhe në formë elektronike.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	- Edhe përkundër krijimit të Gjykatës Komerciale, vonesat janë të theksuara në shkallën e dytë të ankimit. - Mbështetje edhe në ngritjen e kapaciteteve për shqyrtimin e ankesave.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	18. Zhvilloni një strategji për të trajtuar dhe zvogëluar numrin e rasteve të mëparshme. 19. Ofroni trajtime për përpunimin e lëndëve në mënyrë efikase dhe zvogëlimin e diferencave të mbetura.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK, MINT

Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

5.1 NOTIFIKIMET/NJOFTIMET PËR KONTROLLE OSE INSPEKTIVE TË ZGJERUARA

Teksti i marrëveshjes	Kur një Anëtar e miraton ose mban një sistem të lëshimit të njoftimeve ose udhëzimeve për autoritetet përkatëse të tij për rritjen e nivelit të kontrolleve ose inspektive në kufi në lidhje me produktet ushqimore, pijet ose ushqimin e kafshëve të cilat mbulohen përmes një njoftimi ose udhëzimi për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose jetën ose shëndetin e bimëve brenda territorit të saj, disiplinat e mëposhtme do të zbatohen për mënyrën e lëshimit, përfundimit ose pezullimit të tyre: (a) Anëtari, sipas rastit, mund të lëshojë njoftimin ose udhëzimin bazuar në vlerësimin e riskut; (b) Anëtari mund të lëshojë njoftimin ose udhëzimin që të zbatohet në mënyrë uniforme vetëm në ato pika hyrjeje ku zbatohen kushtet sanitare dhe fito-sanitare mbi të cilat bazohet njoftimi ose udhëzimi; (c) Anëtari do të përfundojë ose pezullojë menjëherë njoftimin ose udhëzimin kur rrethanat që e kanë shkaktuar atë nuk ekzistojnë më, ose nëse rrethanat e ndryshuara mund të trajtohen në një mënyrë më pak kufizuese për tregtinë; dhe (d) Kur Anëtari vendosë të përfundojë ose pezullojë njoftimin ose udhëzimin, sipas rastit, ai do të publikojë menjëherë njoftimin për përfundimin ose pezullimin e tij në një mënyrë jo-diskriminuese dhe lehtësisht të qasshme, ose do të informojë Anëtarin eksportues ose importuesin.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Korniza ligjore dhe e politikave e cila i mbulon çështjet e notifikimit dhe kontrolleve të zgjeruara është si në vijim: ▪ KDA në fuqi dhe projekt Kodi Doganor i ri i cili i ka kaluar të gjitha procedurat dhe pret miratimin e Kuvendit ▪ Ligji Nr. 08/L-120 për Ushqim ▪ Ligji Nr. 04/L-216 për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit ▪ Strategjia për MIK dhe Plani i Veprimit 2019-2023. ▪ Ligji Nr. 04/L-078 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve ▪ Ligji Nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit ▪ Ligji Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut ▪ Ligji Nr. 05/L-051 për Treguesit Gjeografik dhe për Emërtimet e Originës ▪ Ligji Nr. 06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe Për procedurën e ndërveprimit të organeve shtetërore në kufi, në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare për Menaxhim Kufitar, çështjet e

	njoftimit për forcimin e kontrollit dhe funksionimin e pikave të kalimit kufitar ofrohen në kohë reale. Për raste kur kemi të bëjmë me mbrojtjen e shëndetit apo të jetës së njerëzve, kafshëve apo bimëve, lëshohet vendim, njoftim apo udhëzues për veprim. Në varësi prej rastit apo veprimeve që kërkohen, profilet e riskut vendosen në sistem që e bëjnë më të lehtë menaxhimin apo mbikëqyrjen e kontroleve të fokusuara. Për trajtimin e këtyre rasteve veprohet përmes koordinimit ndërinstytucional, bazuar në parimet e Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK). Publikimi i akteve të përmendura më lartë bëhet në kohë reale. Legjislacioni doganor dhe legjislacioni tjetër në nivel vendi (Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror), lejon që informacioni i kërkuar për qëllime të kontrollit të importit të ndahet ndërmjet agjencive kufitare. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-216 për Bashkëpunim ndërmjet Autoriteteve të përfshira në MIK parashihet shkëmbimi i informatave ndërmjet autoriteteve kufitare.
	B: Procedurat
	Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-216 janë përpiluar Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për implementimin e legjislacionit. Vendimet e Ministrit të MINT për masat mbrojtëse tregtare bazohen në Ligjin Nr. 06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe. Ministria përkatëse e njofton Qendrën Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (QKMK) për vendimet që i merr, ndërsa QKMK nëpërmes pikave të kontakteve i njofton autoritetet kompetente në kufi për implementimin e masës. Bazuar në PSO të MIK, procedurat janë të përshkruara dhe janë në zbatim që nga viti 2013 për të gjitha pikat. Të njëjtat janë lehtë të qasshme si dhe janë jo-diskriminuese.
	C. Korniza institucionale
	MINT është institucioni përgjegjës dhe e menaxhon sistemin RAPEX KOSOVA i cili shërben për njoftimin e publikut me produktet e pasigurta në treg, në bazë të Ligjit Nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit dhe Rregullores (MTI) - Nr. 08/2013 për mënyrën e themelimit dhe të funksionimit të sistemit për shkëmbimin e shpejtë të informacioneve për produktet e rrezikshme. Trupi Koordinues për Mbikëqyrjen e Tregut (TKMT) si trup koordinues, është themeluar me vendim të Qeverisë së Kosovës, numër 08/82, datë 30.03.2016. Trupi Koordinues përbëhet nga autoritetet inspektuese dhe Dogana e Kosovës, për koordinim të aktiviteteve në fushën e mbikëqyrjes të tregut. Me vendimin e ri të qeverisë, numër 06/85, datë 22.01.2019,

	Trupi Koordinues përbëhet nga autoritetet e listuara në adresën në vijim: https://tkmt.rks-gov.net/sq/coordinating-body. Njoftimet nga Rapid Alert System on Food and Feed (RASFF) inkorporohen në kontrollet zyrtare të autoritetit kompetent. https://food.ec.europa.eu/safety/rasff_en. Autoriteti i përcaktuar për administrimin e RASFF është AUVK. AUVK ka angazhuar zyrtarin i cili merret me këto njoftime (shpërndarje të alertit dhe informata kthyes).
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Stafi ka nevojë të rritet në numër. Trajnimet janë mbajtur në vazhdimësi, por nevojat për trajnime shtesë janë të mëdha. Ekziston plani vjetor për trajnime i cili mbështetet nga donatorët. Në kuadër të autoriteteve Kufitare, bazuar në Strategjinë e MIK-ut, ekziston plani i përbashkët i trajnimeve. Stafi i inspektoratit të tregut në kuadër të MINT është i trajnuar për njoftimet e produkteve të pa sigurta dhe shkëmbim të informacioneve ndërmjet institucioneve relevante për mbikëqyrje të tregut.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Komunikimi bëhet përmes sistemit RAPEX. Po ashtu, Dogana e Kosovës, përmes ASYCUDA World dhe AUVK përmes sistemit të tyre elektronik janë të ndërlidhura në mënyrë elektronike dhe komunikojnë në kohë reale. Inspektorati i Tregut ka lidhje direkte me sistemin ASYCUDA World.
	F. Pajisjet & infrastruktura
	Përkrahje për pajisje dhe përmirësim të infrastrukturës ka pasur nga donatorë të ndryshëm, sic janë EXBS në kuadër të QKMK-së për ndërlidhje të programeve elektronike në mes të autoriteteve por nevojat për përkrahje janë të vazhdueshme.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Mungon implementimi i Single Window (Dritarja e vetme) që do të mundësonte komunikimin dhe shkëmbimin e informatave në mes të autoriteteve kompetente në nivel kombëtar dhe finalizimin e procedurave eksport/import.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	20. Shih veprimet e propozuara mbi “Dritaren e Vetme” (10.4).
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK, AKPPM dhe institucionet e tjera relevante
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT

	Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESËM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	TAIEX dhe BTSF, GIZ, dhe BE, EXBS

5.2 NDALIMI

Teksti i marrëveshjes	Një Anëtar do të informojë menjëherë transportuesin ose importuesin në rast të ndalimit të mallrave të deklaruar për import, për inspektim nga dogana ose ndonjë autoritet tjetër kompetent.
Gjendja ekzistuese	B: Procedurat
	Ndalimi për inspektim nga dogana zbatohet përmes sistemit të automatizuar të përzgjedhjes, në sistemin elektronik ASYCUDA World World, i cili mundëson ushtrimin e një modeli të caktuar kontrolli bazuar në nivelin e përcaktuar të riskut.
	Niveli i kontrollit zbatohet varësisht nga kanali i përzgjedhjes: kuq, verdhë, kaltër dhe gjelbër.
	Deklaruesi menjëherë me rastin e deklarimit të lëndës për zhdoganim, në mënyrë automatike përmes sistemit njoftohet se në cilin kanal është përzgjedhur deklarata dhe varësisht nga kanali kupton edhe llojin e inspektimit (fizik, të dokumenteve, inspektim pas zhdoganimit).
	Në rastin e AUVK, sistemi elektronik i AUVK e informon operatorin (personin përgjegjës i cili e ka paraqitur lëndën – deklaruesi – në sistem) për vendimin e ndalesës. Sistemi është i automatizuar dhe e njofton personin përgjegjës në kohë reale.
	Sistemi elektronik AUVK komunikon me ASYCUDA World.
	C. Korniza institucionale
	Dogana e Kosovës dhe trupat e saj bëjnë implementimin e ndalesave bazuar në profilet e rrezikut të cilat përcaktohen në bazë të analizës së Sektorit për Risk dhe Monitorim, Dogana e Kosovës.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Numri i personelit nuk është i mjaftueshëm. Trajnimet janë mbajtur në vazhdimësi por nevojat për trajnime janë të vazhdueshme. Ekziston plani vjetor për trajnime në këtë fushë.
	Trajnimi i inspektorëve të AUVK është në vazhdimësi, duke u bazuar kryesisht në mbështetje nga donatorët. Mirëpo, duhet të rritet numri i inspektorëve kufitar, dhe AUVK momentalisht është në proces të rekrutimit të zyrtarëve të rinj.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Ndalimi për inspektim nga dogana zbatohet përmes sistemit të automatizuar të përzgjedhjes, në sistemin elektronik ASYCUDA World. Pala në procedurë njoftohet menjëherë se mallrat e deklaruar në fazën e importit do të kontrollohen. Trajtimi apo përdorimi i lejuar doganor afatin kohor maksimal e ka 20 ditë. Kurse tek mallrat e ndaluara përkohësisht, afati standard deri në trajtimin përfundimtar është 30 ditë, në disa raste mund të vazhdohet deri në 60 ditë. Projekt Kodi Doganor që është në

	shqyrtim parasheh ndryshime sa i përket afateve kohore, duke i zgjatur afatet kohore.
	F. Pajisjet & infrastruktura
	Përkrahje për pajisje dhe përmirësim të infrastrukturës ka pasur nga donatorë të ndryshëm, siç janë EXBS në kuadër të QKMK-së. Mbështetja është ofruar për të avancuar ndërlidhjen në mes të programeve elektronike të autoriteteve kompetente. Mirëpo nevojat për përkrahje janë të vazhdueshme.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Mungesa e një platforme të vetme elektronike të komunikimit ku do të ishin të përfshira të gjitha autoritetet me qëllim të realizimit të ndalimit.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	21. Shih veprimet e propozuara mbi “Dritaren e Vetme” (10.4).
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK, institucionet e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	TAIEX dhe BTSF, GIZ, dhe BE, KE, EXBS

5.3 PROCEDURAT E TESTIMIT

Teksti i marrëveshjes	3.1 Një Anëtar mundet, sipas kërkesës, të japë një mundësi për një test të dytë në rast se rezultati i parë i testit të një mostre të marrë pas mbërritjes së mallrave të deklaruar për import prodhon gjetje të kundërta. 3.2 Një Anëtar ose duhet të publikojë, në mënyrë jo diskriminuese dhe lehtësisht të qasshme, emrin dhe adresën e çdo laboratorit ku mund të kryhet testi ose t'ia japë këtë informacion importuesit kur t'i jepet mundësia sipas paragrafit 3.1. 3.3 Një Anëtar do të marrë në konsideratë rezultatin e testit të dytë, nëse ka, të kryer sipas paragrafit 3.1, për lirim dhe zhdoganimin e mallrave dhe, nëse është e përshtatshme, mund të pranojë rezultatet e një testi të tillë.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Legislacioni që e mbulon fushën e testimeve është si në vijim: ▪ Ligji Nr. 08/L-120 Për Ushqim https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61467 ▪ Rregullore (Qkr) – Nr. 43/2013 për Caktimin e Niveleve Maksimale për Kontaminues të Caktuar në Produkte Ushqimore për Njerëz dhe Substanca të Padëshirueshme në Ushqim për Kafshë https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10348 ▪ UA 25/2016 për Marrjen e Mostrave, Dokumentacionit, të Mallit dhe Trajtimin e Tyre në Procedurë Doganore. https://dogana.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/08/UA-25.2016-per-marrjen-e-mostrave-dokumentacionit-te-mallit-dhe-trajtimin-e-tyre-ne-proceduren-doganore-.pdf AUVK ua jep mundësinë palëve për të ofruar testin paralel për produktet e tyre. Të gjitha shpenzimet mbulohen nga pala deklaruese ose personi përgjegjës. AUVK i merr 3 mostra. Në bazë të planit vjetor të kontrolleve zyrtare bëhen testime në laboratorë të autorizuar dhe të kontraktuar nga AUVK (të akredituar në nivel kombëtar – DAK). Në rast të mospërputhjeve, mostrat paralele dërgohen në laboratorë të akredituar ndërkombëtarisht. Për mallra të caktuara (mallra jo bujqësore) organet e vlerësimit të konformitetit caktohen për testim duke mbledhur kampionë (3 mostra: një për testim; e dyta për t'ia dorëzuar importuesit dhe e treta për super analizën, "e vulosur") në kufi. Ligji për Inspektimin i lejon 3 ditë për ankesa. Shpeshësia e marrjes së mostrave në AUVK përcaktohet bazuar në planin e kontrolleve zyrtare. Hartimi i planeve të kontrolleve zyrtare bëhet nga drejtoritë përkatëse: Drejtoria e Shëndetit Publik, Drejtoria e Shëndetit dhe Kontrollit të Kafshëve dhe Departamenti i Politikave dhe

	Prodhimtarisë Bimore. Zbatimin e planit e bën drejtoria e inspektoratit në AUVK. Nga Dogana e Kosovës pranohet super analiza apo analiza e dytë, dhe rezultatet e dala nga kjo analizë pranojnë si të mirëqena. Palët në procedurë janë të informuara se ku duhet të bëhet analiza e dytë. Pasi mallrat janë të natyrave të ndryshme, edhe rreth kësaj pike autoritetet përgjegjëse bashkëpunojnë në bazë të parimit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit
	B: Procedurat
	Procedurat në rastin kur rezultatet e testit të dytë ndryshojnë nuk janë të saktësuar. Procedurat përkatëse do të kompletohen me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Doganor dhe përmes akteve nënligjore do të përshkruhen këto procedura.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Dogana e Kosovës ka shtuar stafin në sektorin për inspektim pas zhdoganimit në gjithsej shtatë zyrtarë, si dhe janë krijuar task forca të veçanta për kontrolle të dyta. Aktualisht ka staf të mjaftueshëm dhe profesional për testimet konfirmuese.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Mungon ndërlidhja e laboratorëve me inspektoratin e AUVK.
	F. Pajisjet & infrastruktura
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje) Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet) Institucionet përgjegjëse Niveli i zbatueshmërisë	Stafi i inspektoratit të AUVK është i pajisur me material për marrje të mostrave në baza të rregullta, duke përfshirë këtu materialet dhe mjetet e nevojshme të punës për marrje të mostrave. Dogana e Kosovës, nga katër metoda testuese sa kishte në fillim të vitit 2022, tani i ka të zhvilluara rreth 27 metoda testuese.
	Mungesa e ndërlidhjes elektronike dhe të komunikimit në mes të laboratorëve dhe inspektorëve në institucionet përgjegjëse
	22. Të fuqizohet ndërlidhja elektronike e sistemeve të laboratorëve me inspektoratin në institucionet përkatëse
	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK, dhe institucionet e tjera përgjegjëse
	Plotësisht
	KRYESISHT

	Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESËM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	TAIEX dhe BTSF, GIZ, dhe BE, EXBS

6.1 DISIPLINAT E PËRGJITHSHME MBI TARIFA DHE NGARKESA TË VENDOSURA MBI APO NË LIDHJE ME IMPORTIMIN DHE EKSPORTIMIN

Teksti i marrëveshjes	1.1 Dispozitat e paragrafit I do të zbatohen për të gjitha tarifatat dhe ngarkesat, përveç detyrimeve të importit dhe eksportit dhe detyrimeve të tjera nga taksat, brenda fushëveprimit të nenit III të GATT 1994, të vendosura nga Anëtarët, mbi ose në lidhje me importimin ose eksportimin e mallrave. 1.2 Informacioni mbi tarifatat dhe ngarkesat do të publikohet në përputhje me nenin I. Ky informacion do të përfshijë tarifatat dhe ngarkesat që do të aplikohen, arsyen e tarifave dhe ngarkesave të tilla, autoritetin përgjegjës, dhe kur dhe si do të bëhet pagesa. 1.3 Në mes të publikimit të tarifave dhe ngarkesave të reja ose të ndryshuara dhe hyrjes në fuqi të tyre, do të caktohet një periudhë e përshtatshme kohore, me përjashtim të rrethanave urgjente. Tarifa dhe ngarkesa të tilla nuk do të aplikohen derisa të publikohet informacioni mbi to. 1.4 Çdo Anëtar do të rishikojë periodikisht tarifatat dhe ngarkesat me synimin për të reduktuar, aty ku është e mundur, numrin dhe llojllojshmërinë e tyre.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Struktura e taksave dhe ngarkesave që aplikohen nga institucionet: <i>Qeveria e Kosovës:</i> Qeveria e ka aprovuar Programin për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative 2022 - 2027. Qëllimet kryesore të Qeverisë, të shprehura në Program janë: Zvogëlimi i barrës administrative për qytetarët, bizneset dhe administratën; parandalimi i barrës administrative të panevojshme gjatë zhvillimit, zbatimit dhe rishikimit të politikave publike. Prioritet i Programit është thjeshtimi i informatave të obligueshme të nivelit qendror, duke u bazuar në ngjarje reale, ku përfshihen lejet, licencat, regjistrimet, certifikimet, pëlqimet, vërtetimet, autorizimet, njohjet, etj., Po ashtu, prioritet i veçantë për Qeverinë është digjitalizimi i shërbimeve të thjeshtuara, ndonëse shpeshherë digjitalizimi e motivon thjeshtimin. MTI, në vitin 2018, në bashkëpunim me IFC/Bankën Botërore, e ka përfunduar punën për identifikimin, analizën dhe rekomandimet për ndryshime eventuale të listës së lejeve, licencave, tarifave dhe pagesave lidhur me procedurat e eksportit, importit dhe transitit të mallrave (shih https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1.79 dhe https://lejelicenca.rks-gov.net/) <i>Dogana e Kosovës:</i> Dogana e Kosovës nuk aplikon asnjë taksë apo ngarkesë në import dhe eksport të mallrave, përveç tarifave doganore dhe tatimeve me të cilat ngarkohen importet. <i>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës:</i>

AUVK aplikon ngarkesa dhe tarifa për kontrollet zyrtare. Të gjitha tarifat dhe ngarkesat që aplikohen nga AUVK janë të publikuara në faqen e internetit të AUVK (Rregullorja 17/2012 për Caktimin e Lartësisë së Pagesës për Kontrolle Zyrtare, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8383>)

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë:

MINT aplikon tarifa dhe pagesa lidhur me procedurat e eksportit dhe importit për dhënien e licencave (p.sh.. duhani, nafta, mallrat strategjike)

Në faqen e internetit të MINT janë publikuar të gjitha lejet, licencat dhe tarifat si dhe pagesat lidhur me procedurat e eksportit, importit dhe tranzitit të mallrave (<https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1,79>)

MINT në vitin 2022 ka ndryshuar Ligjin për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme. Sipas këtij ligji Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës i lëshon 15 leje, duke e zvogëluar numrin nga 20 në 15. Po ashtu, me ligjin e ri ka ndryshuar kohëzgjatja e lejes nga 2 vite në 6. Po ashtu, në vitin 2022 me Udhëzimin Administrativ nr. 04/2022 për përcaktimin e tarifave për leje të subjekteve për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme, për të gjitha llojet e Lejeve. Tarifa është zbritur nga 5 mijë euro në 50 euro. Ndërsa, me UA (MINT) Nr.15/2022 për përcaktimin e procedurës për marrjen e lejes për subjektet që ushtrojnë veprimtari në sektorin e naftës dhe karburanteve të ripërtërishme, janë zvogëluar kriteret tek të gjitha llojet e licencave.

Gjithashtu, në vitin 2021, është ndryshuar Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për subjektet që merren me tregtimin e duhanit. Ky udhëzim e ka reduktuar taksën administrative me rastin e marrjes së licencës nga 20 mijë euro në 55 euro.

Aktualisht, Departamenti i Tregtisë i lëshon 7 licenca (duke e zvogëluar numrin e licencave nga 8 në 7 sipas legjislacionit në fuqi).

Departamenti për Kontrollimin e Tregtisë me Mallra Strategjike, në vitin 2019 Ministria e ka eliminuar taksën për Certifikatën për Regjistrim në Regjistër në vlerë prej 5 eurosh.

Po ashtu, në vitin 2019, Ministria me vendim e ka zvogëluar taksën për aplikim dhe dhënie të emërimit të trupave për vlerësim të konformitetit nga 150 euro sa ishte më parë në 100 euro.

Në faqen e internetit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë janë publikuar të gjitha lejet, licencat dhe tarifat si dhe pagesat lidhur me procedurat e eksportit, importit dhe tranzitit të mallrave.

<https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1,79>

Ministria e Pylltarisë, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:

MPBZHR aplikon tarifa dhe ngarkesa për dhënien e licencave të importit për material fidanor, bimë dekorative, plehra, etj. Bazuar në Ligjin Nr.2004/21 për Veterinarinë, dhe rregullore përcjellëset,

	MBPZHR e përcakton nivelin e pagesës për shërbime në procesin e importit/eksportit të këtyre mallrave, karantinimin e kafshëve, apo inspektimin e kafshëve. Listat e shërbimeve, përfshirë edhe çmimet përkatëse për këto shërbime, janë të përfshira në anekset e secilit UA të aprovuar nga MBPZHR. Arsytet e vendosjes së nivelit përkatës të pagesës për shërbime janë të prezantuara në UA. UA-të janë të publikuara në faqen e internetit të MBPZHR (https://www.mbpzhr-ks.net/sq/udhezimet-administrative). Në momentin që UA hyn në fuqi, edhe tarifat hyjnë gjithashtu në fuqi, megjithatë, palët e ndryshme mund të jenë të informuara më herët për ndryshimin e tarifave përmes diskutimeve publike të UA, publikimi në platformën https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20012&OpenPage=0&ClosedPage=0. MPBZHR, në koordinim me AUVK dhe institucionet e tjera relevante, ka bërë lehtësime të caktuara në procedurën e dhënies së lejeve dhe licencave, megjithatë kontrollet nga shërbimi veterinar dhe fito-sanitar janë çështje të sigurisë së ushqimit dhe shëndetit publik dhe janë të domosdoshme. <i>Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale:</i> AKPPM aplikon licenca dhe tarifa për importin e produkteve dhe pajisjeve medicinale. Rregullorja e cila e përcakton nivelin e ngarkesave financiare është UA nr. 04/2017 për Tarifat e Shërbimeve të Ofruara në AKPPM e cila është aprovuar në vitin 2017. Momentalisht, AKPPM së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë janë duke e bërë përditësimin e kësaj rregulloreje. Përditësimi standard bëhet kohë pas kohe, varësisht nga lëvizjet në treg, ndryshimet në strategjinë e Ministrisë, dhe kërkesat specifike që vijnë nga bizneset.
	B: Procedurat
	Rishikimi i periodik i aplikimit të tarifave dhe pagesave bazohet në: ▪ Rregulloren Nr. 17/2012 për Caktimin e Lartësisë së pagesës për Kontrolle Zyrtare (https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8383) ▪ Programin për Parandalimin e Barrës Administrative 2022-2027 dhe Planin e Veprimit 2022-2027. ▪ Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave ▪ Të gjitha tarifat dhe ngarkesat e tjera për shërbimet e ofruara nga ana e AKPPM-së janë të prezantuara në UA nr. 04/2017 për Tarifat e Shërbimeve të Ofruara në AKPPM.
	C. Korniza institucionale
	Në Programin për Parandalimin e Barrës Administrative 2022-2027 dhe Planin e Veprimit 2022-2024, me qëllim të zbatimit apo lehtësimit të zbatimit të

	parimeve, Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) mund të bëjë dhe analiza dhe plane të veçanta, si dhe mund t'u kërkojë institucioneve përgatitjen e koncept dokumenteve dhe propozimin e masave dhe veprimeve konkrete nëpër dokumente strategjike. Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë brenda MPBZHR-së është përgjegjës për rishikimin periodik të taksave dhe ngarkesave për eksport dhe import të produkteve me origjinë bimore dhe shtazore, megjithatë ky mekanizëm nuk e ka të caktuar ende një njësi ose person që do të merrej në mënyrë specifike me këto çështje. Për plotësim-ndryshimin e UA krijohet një komision specifik nga Ministria e Shëndetësisë në përbërje të të cilit janë të gjitha palët e interesit (institucionet, OJQ-të, dhe përfaqësuesit e sektorit privat në fushën e farmacisë). Në përcaktimin e nivelit të tarifave dhe ngarkesave brenda AKPPM-së inpute merren edhe nga njësitë/departamentet e ndryshme brenda Agjencisë sipas fushës së përgjegjësi që kanë.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi Stafi është relativisht në gjendje të mirë kur bëhet fjalë për menaxhimin dhe mbledhjen e tarifave dhe ngarkesave. MPBZHR (Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë) nuk ka staf të mjaftueshëm dhe as të kualifikuar dhe të trajnuar për të përcjellë, vlerësuar ose propozuar politika sa i përket taksave, pagesave për shërbime ose ndonjë ngarkese tjetër sa i përket procedurave të importit dhe eksportit. Menaxhmenti i MPBZHR-së duhet t'i japë më shumë rëndësi politikave për lehtësim të tregtisë në mënyrë që t'u ndihmohet prodhuesve bujqësor dhe industrisë së prodhimit të ushqimit që të rrisin ndikimin e investimeve të tjera (p.sh, granteve dhe subvencioneve). Në AKPPM, krijimi i komisionit specifik për plotësim-ndryshimin e UA-së përfshin përfaqësues institucionesh dhe pjesëmarrës të tjerë me ekspertizë në këtë fushë specifike.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit Në kuadër të Programit për Parandalimin e Barrës Administrative 2022-2027 dhe Planin e Veprimit 2022-2024 si fazë e fundit parashihet digjitalizimi i procedurave – përfshirë edhe ngarkesat financiare – nëpërmjet platformës e-Kosova do të aplikohet parimi i 'një dritareje të vetme', ku do të publikohen të gjitha shërbimet e digjitalizuara, ndërsa të gjitha platformat tjera elektronike nëpërmjet të cilave ofrohen shërbime, do të jenë të ndërlidhura me e-Kosova. Pas përfundimit të Katalogut të Shërbimeve, ZKM ka filluar të skanojë dhe analizojë ato shërbime të cilat mund të digjitalizohen dhe për të cilat nuk ka nevojë për nënshkrim elektronik. Në këtë drejtim MINT është përzgjedhur për skanim dhe analizim, si një prej institucioneve potenciale dhe prioritare për digjitalizim të shërbimeve në 2023 dhe 2024. Në këtë aspekt, MINT ka bërë vlerësimin se cilat mund të jenë ato shërbime që lëshohen në kuadër të MINT.

Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Edhe pse legjislacioni në fuqi e parasheh rishikimin e barrës administrative në baza të rregullta, edhe më tutje ka ngecje në këtë proces, veçanërisht në rishikimin e rregullt të kësaj barre në nivel qendror dhe në rishikimin gjithëpërfshirës (në të gjitha institucionet: qendrore, lokale dhe në agjencitë e pavarura).
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	23. Të bëhet rishikimi vjetor në mënyrë periodike për identifikimin e të gjitha taksave dhe ngarkesave të tjera në import dhe eksport (të bazuara në ligj apo edhe ato të cilat aplikohen në praktikë), të krahasohen me kërkesat e BE-së, dhe të jepen rekomandimet për eliminimin e mëtejshme të tyre aty ku është e mundur. 24. Vendosja e taksave dhe ngarkesave të reja në të ardhmen të bazohet në legjislacionin në fuqi dhe të ndiqen parimet më të mira ndërkombëtare si dhe standardet e BE-së. 25. Të kryhen trajnime në organet kompetente me qëllim të analizimit të kontrollit dhe teknikave për thjeshtësimin, konsolidimin dhe zvogëlimin e numrit të llojit të taksave dhe të ngarkesave të tjera bazuar në kërkesat dhe standardet e BE-së. 26. Nga KNLT t'i ofrohen propozime konkrete Qeverisë për thjeshtësimin dhe reduktimin e taksave dhe ngarkesave në eksport dhe import dhe barrës tjetër administrative. 27. Të përshpejtohet digjitalizimi i procedurave, i taksave dhe ngarkesave financiare në procesin e marrjes së lejeve, licencave, dhe kërkesave të tjera specifike në import dhe eksport.
Institucionet përgjegjëse	ZKM (udhëheqëse), MINT, Dogana e Kosovës, AUVK, AKPPM, dhe institucionet e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I LARTË I mesëm I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	IFC, USAID

6.2 DISIPLINAT SPECIFIKE MBI TARIFAT DHE NGARKESAT PËR PROCESIMIN DOGANOR TË VENDOSURA MBI APO NË LIDHJE ME IMPORTIMIN DHE EKSPORTIMIN

Teksti i marrëveshjes	Tarifat dhe ngarkesat për përpunimin doganor: (i) do të kufizohen në shumën me koston e përafërt të shërbimeve të kryera në ose në lidhje me operacionin specifik të importit ose eksportit në fjalë; dhe (ii) nuk kërkohet të lidhen me një operacion specifik importi ose eksportime kusht që ato të vendosen për shërbime që janë të lidhura ngushtë me procesimin doganor të mallrave.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Dogana e Kosovës nuk aplikon asnjë tarifë apo ngarkesë tjetër për shërbimet të cilat i ofrojnë për palët e treta. B: Procedurat Pasi që Dogana e Kosovës nuk aplikon tarifa apo ngarkesa për shërbimet e saj atëherë nuk janë formuluar procedura specifike. C. Korniza institucionale Pasi që Dogana e Kosovës nuk aplikon tarifa apo ngarkesa për shërbimet e saj atëherë nuk janë krijuar mekanizma specifik institucional. D. Burimet njerëzore/trajnimi Pasi që Dogana e Kosovës nuk aplikon tarifa apo ngarkesa për shërbimet e saj atëherë nuk ka të dedikuar as staf specifik që do ta mbulonte këtë fushë.
Pengesat (ofroni arsytet për mospërputhje)	Shih 6.1
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	Shih 6.1
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës
Niveli i zbatueshmërisë	PLOTËSISHT Kryesisht Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet

Niveli i prioritetit	I lartë I mesëm I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet.

6.3 DISIPLINAT PENALIZUESE

Teksti i marrëveshjes	3.1 Për qëllim të paragrafit 3, termi "penalizim" do të thotë ato masa të vendosura nga administrata doganore e një Anëtar për shkelje të ligjeve, rregulloreve ose kërkesave procedurale doganore të Anëtarit. 3.2 Çdo Anëtar do të sigurojë që dënimet për shkeljen e ligjit doganor, rregullores ose kërkesës procedurale të vendosen vetëm ndaj person(ave) përgjegjës për shkeljen sipas ligjeve të tij. 3.3 Dënimi i shqiptuar do të varet nga faktet dhe rrethanat e rastit dhe do të jetë në përputhje me shkallën dhe ashpërsinë e shkeljes. 3.4 Çdo Anëtar duhet të sigurojë që të aplikojë përherë masat për të shmangur: (a) konfliktet e interesit në vlerësimin dhe mbledhjen e gjobave dhe detyrimeve; dhe (b) krijimin e stimuljeve për vlerësimin ose mbledhjen e dënimeve që nuk janë në përputhje me paragrafin 3.3. 3.5 Çdo Anëtar do të sigurojë që kur vendoset një dënim për shkelje të ligjeve doganore, rregulloreve ose kërkesave procedurale, një shpjegim me shkrim i jepet person(ave) ndaj të cilëve është shqiptuar dënimi duke e specifikuar natyrën e shkeljes dhe ligjin në fuqi, rregulloren ose procedurën sipas së cilës është përcaktuar shuma ose shtrirja e dënimit për shkeljen e bërë. 3.6 Kur një person i zbulon vullnetarisht administratës doganore të një Anëtar rrethanat e shkeljes së ligjit doganor, rregullores ose kërkesës procedurale përpara zbulimit të shkeljes nga administrata doganore, Anëtar i inkurajohet që, sipas rastit, ta konsiderojë këtë fakt si një faktor të mundshëm lehtësues kur vendos një dënim për atë person. 3.7 Dispozitat e këtij paragrafi do të zbatohen për dënimet në qarkullimin tranzit të cekur në paragrafin 3.1.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Sipas dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (Nr.03/L-109, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 dhe Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, vendimin lidhur me përgjegjësinë kundërvajtëse doganore personi përgjegjës e jep me shkrim duke e përshkruar shkeljen, bazën ligjore, afatin dhe pagesën e gjobës. Ndaj këtyre vendimeve personat përgjegjës kanë të drejtë të ankohen në pajtim me nenin 291 të Kodit Doganor në Sektorin për Rishqyrtimin e Vendimeve ▪ Personat përgjegjës që kryejnë një kundërvajtje administrative doganore kundër dispozitave të KDA-së do të marrin një gjobë si dënim parësor. ▪ Dënimet parashikohen në bazë të shkeljeve dhe në përpjesëtim me shkallën e shkeljes.

	Nuk vendoset gjobë nëse marrësi ose përfaqësuesi ligjor ka dërguar një njoftim me shkrim në doganë për një gabim të bërë gjatë importit (para se deklarata të validohet). Ndryshe, nëse vepra i tejkalon suazat e përcaktuara ligjore për kundërvajtje, vepra konsiderohet si vepër penale. Deri në një nivel të caktuar monetar, kundërvajtja konsiderohet si “kundërvajtje doganore” dhe dënimi është në diskrecionin e doganierëve duke i respektuar Udhëzimet Administrative dhe legjislacionin në fuqi lidhur me kundërvajtjet doganore.
	B: Procedurat
	Të gjitha procedurat dhe politikat janë sipas praktikave më të mira të OBD-së. Procedurat administrative, kundërvajtëse, penalitetet, procedura e deklarimit të mallrave, ato të thjeshtëzuara, rishqyrtimit të vendimeve, që të gjitha janë në harmoni me standardet e parapara në Konventën e rishikuar të Kyoto-s që ofron një set gjithëpërfshirës të procedurave doganore për të thjeshtësuar dhe lehtësuar tregtinë e ligjshme ndërkombëtare.
	C. Korniza institucionale
	Njësitë administrative që e mbulojnë këtë fushë janë të themeluara dhe funksionale (Sektori i Kundërvajtjeve, Rishqyrtimit të Vendimeve, Sektori i Procedurave, etj.).
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Njësia ka staf adekuat dhe të trajnuar. Stafi është i trajnuar për veprime specifike për zbatimin e drejtë të legjislacionit në fushën e kundërvajtjeve.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Në vijim të kërkesave të Konventës së rishikuar të Kyoto-së janë rishikuar dhe harmonizuar sanksionet dhe penalitetet për shkeljet në fushën e veprimtarisë doganore (p.sh shmangiet nga detyrimet mbi 5,000 euro cilësohen si vepër penale).
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	28. Është krijuar një sistem ligjor për zbatimin e kësaj mase dhe kjo do të avancohet me hyrjen në fuqi të Kodit Doganor dhe të Akcizës (KDA). 29. Rishikimi i kështillës ligjore nga gjykata për shumën e taksës në vlerën mbi 5000 euro e cila cilësohet si vepër penale.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet

Niveli i prioritetit	I lartë I MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet.

7.1 PROCESIMI PARA-MBËRRITJES

Teksti i marrëveshjes	I.1 Çdo Anëtar do të miratojë ose aplikojë procedura që e lejojnë dorëzimin e dokumentacionit të importit dhe të informacioneve të tjera të kërkuara, duke i përfshirë manifestet, me qëllim që të fillojë përpunimi para-mbërritjes i mallrave, me qëllim të përsheptimit të lëshimit të mallrave pas mbërritjes. I.2 Çdo Anëtar, sipas rastit, do të sigurojë depozitimin paraprak të dokumenteve në format elektronik për përpunimin para-mbërritjes së këtyre dokumenteve.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore:
	Është kompletuar legjislacioni doganor i cili mundëson deklarin e mallrave në para arritje (UA MFPT - nr. 02/2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e UA nr. 11/2009 për Implementimin e Kodit nr. 03/I-109 Doganor dhe i Akcizave, i plotësuar dhe ndryshuar me UA nr. 05/2010, UA nr. 06/2013 dhe me UA nr. 05/2014). KDA bën të mundur deklarinet – edhe në formë elektronike – në para arritje në sistem, duke i mundësuar Doganës së Kosovës që të analizojë ato shënime dhe të përcaktojë nëse paraqesin ndonjë nivel të riskut në arritje të mallit.
	B: Procedurat
	Të dhënat para mbërritjes integrohen në sistemin SEED dhe së shpejti deklarimi i mallrave do të bëhet edhe në ASYCUDA World para se mallrat të mbërrijë në kufi. Udhëzimi Administrativ MFPT- nr. 02/2022. Dogana e Kosovës ka qasje dhe i krahason të dhënat me gjendjen fizike të dokumenteve të paraqitura, me dalje nga një shtet i BE-së.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Personeli i ngarkuar me këtë proces është mirë i përgatitur dhe mirë i trajnuar.
Pengesat (ofroni arsytet për mospërputhje)	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Sistemi elektronik SEED bën të mundur pranimin në mënyrë elektronike të të dhënave paraprake dhe të dokumenteve për procesin e zhdoganimit të mallrave.
	▪ Mos standardizimi i procedurave të deklarimit të mallrave në para-arritje edhe me ASYCUDA World. ▪ Mungesa e ndërveprimit sa u përket procedurave të para-arritjes me agjencitë e tjera ligj-zbatuese. ▪ Mungesa e informimit të plotë të palëve të treta (tregtarëve) për mundësinë e deklarimit para mbërritjes nuk është e kënaqshme.

Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	30. Të zhvillohen trajnime të përbashkëta me institucionet përgjegjëse me qëllim të integritetit në sistemin e përpunimit të të dhënave para-mbërritjes (SEED). 31. Të intensifikohen përpjekjet dhe të gjinden instrumentet e përshtatshme me qëllim të informimit të palëve të interesit për mundësinë e deklarimit para-mbërritjes
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK, dhe agjencitë e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht Kryesisht PJESËRISHT Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESËM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet.

7.2 PAGESAT ELEKTRONIKE

Teksti i marrëveshjes	Çdo Anëtar, për aq sa është praktike, do të miratojë ose mbajë procedura që lejojnë mundësinë e pagesës elektronike për detyrimet, taksat, tarifat dhe ngarkesat e mbledhura nga doganat gjatë importimit dhe eksportimit.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Dogana e Kosovës tashmë përdor sistemin elektronik të pagesave. Është i zbatueshëm për të gjitha pagesat që kryhen për eksport dhe import. Në anën tjetër, edhe AUVK bën të mundur që të gjitha pagesat për kontrolle zyrtare bëhen online në sistemin elektronik të AUVK. Sistemi është funksional 24/7 (shih https://auv.rks-gov.net/sq/Account/Login?ReturnUrl=%2F) Lexuesit e kartelave (POS) – debi dhe kredi – mungojnë në të dyja institucionet. Mungesa e lexuesve të kartelave arsyetohet me faktin që pagesat mund të realizohen përmes e-banking. Në MINT të gjitha procedurat dhe kriteret për dhënien e lejeve dhe licencave për eksport dhe import janë të specifikuara bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore. Mirëpo, MINT ende nuk ka sistem për pagesat elektronike. Në avancim i madh kohëve të fundit është bërë me aprovimin e Ligjit për Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit Nr. 04/L-094 i cili ka bërë dokumentacionin elektronik ligjërish të barabartë me dokumentacionin në formë letre, me qëllim që të lehtësojë shërbimet elektronike duke përfshirë, por pa u kufizuar në, blerjet dhe shitjet e konsumatorëve përmes internetit (e-Commerce), bankat elektronike dhe shërbimet financiare (e-Pagesa), ofrimi i shërbimeve nga qeveria (e-Qeverisja) dhe blerjet elektronike nga ndërmarrjet (e-Prokurimi), dhe zbatohet aty ku përdoren nënshkrimet elektronike. Pagesat për shërbimet e AKPPM-së mund të kryhen vetëm në formë elektronike (ose transfer bankar), nga palët brenda dhe jashtë vendit. Të dhënat për mënyrën e pagesave janë prezente në faqen e internetit të Agjencisë. Në platformën elektronike BARNATARI (https://barnatari.rks-gov.net/Home/Login.aspx?ReturnUrl=/Home/default.aspx) mund të shkarkohet fletëpagesa, mirëpo për momentin nuk mund të realizohet pagesa drejtpërdrejtë nga platforma. AKPPM është në koordinim me BQK-në dhe Thesarin për krijimin e mundësive teknike për realizimin e pagesës përmes platformës në fjalë.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Mungesa e ndërveprueshmërisë në mes të sistemeve si dhe krijimi i një sistemi që mundëson verifikimin e pagesave në kohë reale.
Veprimet/burimet e nevojshme &	32. Ndërlidhja e sistemeve në mes të institucioneve përgjegjëse për realizimin e komunikimeve në kohë reale për verifikimin e pagesave.

shpenzimet (numëroni veprimet)	
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK, institucionet e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht Kryesisht PJESËRISHT Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I LARTË I mesëm I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet.

7.3 NDARJA E LIRIMIT NGA PËRCAKTIMI FINAL DHE PAGESA E DETYRIMEVE DOGANORE, TAKSAVE, TARIFAVE DHE NGARKESAVE

Teksti i marrëveshjes	3.1 Çdo Anëtar do të miratojë ose do të mbajë procedura që e lejojnë lirimin e mallrave përpara përcaktimit përfundimtar të detyrimeve doganore, taksave, tarifave dhe ngarkesave, nëse një përcaktim i tillë nuk bëhet para, si të mbërrijnë, ose sa më shpejt që të jetë e mundur pas mbërritjes, dhe nën kushtin që të gjitha kërkesat e tjera ligjore të jenë përmbushur. 3.2 Si kusht për këtë lirim, një Anëtar mund të kërkojë: (a) pagesën e detyrimeve doganore, taksave, tarifave dhe ngarkesave të përcaktuara përpara ose pas mbërritjes së mallrave dhe një garanci për çdo shumë të pacaktuar ende në formën e një garancie, një depozite ose një instrumenti tjetër të përshtatshëm të parashikuar në ligjet e tij dhe rregulloret; ose (b) një garanci në formën e një sigurimi, një depozite ose një instrumenti tjetër të përshtatshëm të parashikuar në ligjet dhe rregulloret e tij. 3.3 Një garanci e tillë nuk duhet të jetë më e madhe se shuma që kërkon Anëtari për të siguruar pagesën e detyrimeve doganore, taksave, tarifave dhe ngarkesave që duhet të paguhet përfundimisht për mallrat e mbuluara nga garancia. 3.4 Në rastet kur është zbuluar një kundërvajtje që kërkon vendosjen e gjobave monetare, mund të kërkohet një garanci për dënimet dhe gjobat që mund të shqiptohen. 3.5 Nga garancia e përcaktuar në paragrafët 3.2 dhe 3.4 do të hiqet dorë në momentin kur nuk kërkohet më. 3.6 Asgjë në këto dispozita nuk do të cenojë të drejtën e një Anëtari për të ekzaminuar, ndaluar, sekuestruar, konfiskuar ose trajtuar mallrat në çfarëdo mënyre që nuk është në kundërshtim me të drejtat dhe detyrimet që i burojnë nga OBT-ja së Anëtarit.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore:
	Procedura e liritimit është në fuqi dhe është ndërtuar bazuar në parimet e OBD-së.
	B: Procedurat
	Dogana e aplikon procedurën e liritimit bazuar në dy hapa: hapi i parë, dorëzimi i deklaratave me informacionet bazë (deklarata fillestare përmes së cilës lirohen mallrat mbështetur në garanci), dhe hapi i dytë, dorëzimi i deklaratës së plotë (deklarata përmbledhëse).
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit

	Sistemi elektronik për përpunimin e deklaratave doganore (ASYCUDA World) mundëson aplikimin e procedurave ligjore të parapara me KDA dhe akte tjera nën-ligjore. Përmes ASYCUDA-s bëhet përpunimi i automatizuar i deklaratave të importit, eksportit, dhe transitit dhe i njëjti bën të mundur procedurën e lirimit në dy hapa.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Nuk raportohet
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	Nuk raportohet
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht ☒ Kryesisht Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I mesëm ☒ I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

7.4 MENAXHIMI I BAZUAR NË RISK

Teksti i marrëveshjes	4.1 Çdo Anëtar, për aq sa është e mundur, do të miratojë ose mbajë një sistem të kontrollit doganor të bazuar në risk. 4.2 Çdo Anëtar do të hartojë dhe zbatojë menaxhimin e rrezikut në një mënyrë që të shmangë diskriminimin arbitrar dhe të pajustifikueshëm, ose ndonjë pengesë të fshehtë në tregtinë ndërkombëtare. 4.3 Çdo Anëtar do të fokusojë kontrollet doganore dhe, për aq sa është e mundur, kontrollet e tjera përkatëse kufitare, në ngarkesat me rrezik të lartë dhe do të përshpejtojë lirin e ngarkesave me rrezik të ulët. Anëtari gjithashtu mund të zgjedhë, në mënyrë të rastësishme, dërgesa për kontrolle të tilla si pjesë e sistemit të menaxhimit të rrezikut. 4.4 Çdo Anëtar do të bazojë menaxhimin e rrezikut në një vlerësim të rrezikut nëpërmjet kriterëve të përcaktuara të përzgjedhjes. Kriteret e tilla të përzgjedhjes mund të përfshijnë, ndër të tjera, kodin e Sistemit të Harmonizuar, natyrën dhe përshkrimin e mallrave, vendin e origjinës, vendin nga i cili janë dërguar mallrat, vlerën e mallrave, të dhënat e pajtueshmërisë së tregtarëve dhe llojin e mjetit të transportit.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore:
	Kontrollet doganore janë të bazuara në parimet e menaxhimit të rrezikut, dhe në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet ndërkombëtare si: Konventa e Reviduar e Kyotos, rekomandimet e Organizatës Botërore të Doganave dhe udhëzimet e Bashkësisë Evropiane (Customs Blueprint). Përkufizimet mbi riskun janë përshkruar në Kodin Doganor dhe të Akcizave Nr. 03/L-109 dhe aktet tjera nënligjore përcjellëse si UA 2011/9.
	B: Procedurat
	Ekzistojnë politika dhe procedura për kryerjen e kontrolleve të bazuara në rrezik. Është miratuar udhëzuesi i brendshëm për të përcaktuar rregullat për zbatimin e kontrolleve selektive në operacionet doganore duke i përdorur teknikat e menaxhimit të riskut.
	C. Korniza institucionale
	Sektori për Risk dhe Monitorim (SRM) është struktura kryesore në administratën doganore e ngarkuar për menaxhimin e riskut në nivel qendror. Zyrat doganore kanë krijuar njësi të caktuar, me zyrtarë të cilët kanë qasje në të gjitha informacionet përkatëse, sipas kërkesës.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Dogana e Kosovës ka staf me aftësi të nevojshme për zbatimin e kontrolleve të bazuara në rrezik.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit

	Informacioni lidhur me rrezikun shpërndahet përmes sistemit të automatizuar ASYCUDA World në të gjitha zyrat doganore përkatëse. Oficerët doganor, në funksion të detyrës që kryejnë, kanë përgjegjësi: të ndjekin procedurat e parashikuara për kanalin e caktuar, të respektojnë kërkesat e përshkruara në kriterin e përzgjedhjes, të përmbushin masat e përcaktuara në mesazhin e kriterit të riskut por pa u limituar vetëm në masat e mesazhit dhe në përfundim të kontrollit të plotësojnë me korrektësi në mënyrë elektronike “Aktin e Kontrollit” me informacionet e detajuara për llojin e kontrollit dhe rezultatet.
Pengesat (ofroni arsytet për mospërputhje)	▪ Nevoja për koordinim për profilizimin të riskut së bashku me agjencitë tjera ligj-zbatuese, veçanërisht me AUVK. ▪ Nevoja për fuqizim të mëtejshme të sistemit të kontrolleve të bazuara në risk, veçanërisht në AUVK, me qëllim të përafrimit të implementimit të këtij mekanizmi në harmoni me standardet dhe normat e BE-së.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	33. Fuqizimi i sistemit të analizës së riskut dhe realizimit të kontrolleve bazuar në risk, veçanërisht në AUVK, do të përfshijë: ▪ Analizën e gjendjes ekzistuese të sistemeve të kontrollit të bazuara në menaxhimin e riskut në agjencitë përgjegjëse dhe dhënies së rekomandimeve bazuar në praktikën më të mirë të BE-së, duke përfshirë: ▪ Analizën e indikatorëve për identifikimin e riskut ▪ Kategorizimin e riskut ▪ Revidimin e profileve të riskut dhe prioritizimin e tyre ▪ Sigurimin e kushteve teknike (p.sh., të TIK-së) me qëllim të ndërveprueshmërisë së sistemeve të TIK-së dhe shkëmbimit të informatave në mes të agjencive ligj-zbatuese (Dogana e Kosovës, MINT, AUVK, AKPPM, MPBZHR etj.) ▪ Identifikimi i nevojave dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore me qëllim të implementimit të sistemit të kontrolleve të bazuara në risk bazuar në praktikën më të mirë të BE-së.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK, dhe agjencitë e tjera relevante
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESËM

	I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	GIZ, BE

7.5 AUDITIMI PAS ZHDOGANIMIT

Teksti i marrëveshjes	5.1 Me qëllim të përshpejtim të lëshimit të mallrave, çdo Anëtar do të miratojë ose mbajë auditim pas-zhdoganimit për të siguruar pajtueshmërinë me doganat dhe ligjet dhe rregulloret e tjera përkatëse. 5.2 Çdo Anëtar, bazuar në sistemin e menaxhimit të riskut do të zgjedhë një person ose një ngarkesë për auditim pas-zhdoganimit e cila mund të përfshijë kriteret e duhura të përzgjedhjes. Çdo Anëtar do të kryejë auditime pas-zhdoganimit në mënyrë transparente. Kur personi është i përfshirë në procesin e auditimit dhe janë arritur rezultate përfundimtare, Anëtari duhet, pa vonesë, të njoftojë personin, të dhënat e të cilit auditohen, për të drejtat dhe detyrimet e personit dhe arsyet e rezultateve. 5.3 Informacioni i marrë në auditimin pas zhdoganimit mund të përdoret në procedura të mëtejshme administrative ose gjyqësore. 5.4 Anëtarët, kudo që është e mundur, do të përdorin rezultatin e auditimit pas zhdoganimit në zbatimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Korniza Ligjore është në përputhje. Dogana ka autoritet në bazë të ligjit për të kryer kontrole pas zhdoganimit. Kriteri i përzgjedhjes së subjektit apo mallrave të caktuara për kontroll pas zhdoganimit është i bazuar në vlerësim dhe analizë të riskut. Kontrolli pas zhdoganimit kryhet në mënyrë transparente. Në mekanizmin e kontrollit pas zhdoganimit, është e mundur të bëhet ndarja e rezultateve nga auditimi. Po ashtu, ky mekanizëm i përfshin të drejtat dhe detyrimet e subjektit apo ngarkesës që auditohet. Provat nga kontrolli pas zhdoganimit përdoren edhe në proceset gjyqësore. Rezultatet nga auditimi përfshihen në menaxhim të riskut më tutje. B: Procedurat Të gjitha procedurat janë në përputhje me përcaktimet e masës 7.5 të MTL-së. C. Korniza institucionale Njesia e Auditimit të Jashtëm është e konsoliduar dhe operon në kuadër të Doganës së Kosovës. D. Burimet njerëzore/trajnimi Stafi aktual i auditimit ka aftësitë e duhura dhe trajnohet në vazhdimësi. Kohëve të fundit është rritur numri i inspektorëve doganor në sektorin e procedurave pas zhdoganimit në rreth 20 zyrtarë.

	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Zyra doganore është e pajisur me mjete adekuate analitike.
Pengesat (ofroni arsytet për mospërputhje)	Mungesa e Softuerit në lidhje me identifikimin e subjekteve në procedurë të zhdoganimit, për të identifikuar ndonjë parregullsi që është shfaqur në procedurë.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	34. Avancimi i Softuerit në lidhje me identifikimin e subjekteve në procedurë të zhdoganimit, për të identifikuar ndonjë parregullsi që është shfaqur në procedurë.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I mesëm I ULËT Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

7.6 VENDOSJA DHE PUBLIKIMI I KOHËS MESATARE TË LËSHIMIT DHE ZHDOGANIMIT

Teksti i marrëveshjes	6.1 Anëtarët inkurajohen të matin dhe publikojnë periodikisht dhe në mënyrë të qëndrueshme kohën mesatare të lëshimit të mallrave, duke përdorur mjete të tilla si, ndër të tjera, Studimi i Lirimit Kohor të Organizatës Botërore të Doganave (i referuar në këtë Marrëveshje si "ODB") . 6.2 Anëtarët inkurajohen të ndajnë me Komisionin përvojat e tyre në matjen e kohës mesatare të lëshimit, duke i përfshirë metodologjitë e përdorura, pengesat e identifikuar dhe çdo efekt që rezulton në rritje të efikasitetit.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Është krijuar një politikë formale për të matur kohën mesatare të zhdoganimit për çdo transaksion. Rezultatet shpërndahen me institucionet përgjegjëse, dhe publikohen në faqen e internetit. Agjencitë kufitare, përkatësisht Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, AKPPM dhe të tjera, aktualisht nuk janë pjesë e një platforme matëse që e vlerëson kohën e lëshimit nga hyrja deri te lëshimi. Sistemi elektronik ASYCUDA World lejon një sistem matjeje të përbashkët. B: Procedurat Dogana e Kosovës e mat kohën e lirimit për hyrjen e tyre në kohën totale të lëshimit. C. Korniza institucionale Administrata doganore kohë pas kohe e matë kohën mesatare të zhdoganimit, por nuk e ka të deleguar tek ndonjë njësi e veçantë brenda Doganës së Kosovës, edhe pse në edicionet e kaluara të raportit është marrë Njësia e Operimit të të Hyrave. Megjithatë, sistemi ASYCUDA World bën të mundur matjen e kohës të zhdoganimit në mënyrë automatike. D. Burimet njerëzore/trajnimi Personat përgjegjës për realizimin e raportit në Doganën e Kosovës janë të përgatitur dhe mirë të trajnuar për realizimin e analizës. E. Komunikimi/teknologjia e informacionit Sistemi ASYCUDA World mbështet matjen e kohës mesatare të zhdoganimit.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Agjencitë e tjera kufitare nuk kanë ndërtuar procedura specifike për të realizuar matjen periodike të kohës që iu nevojitet këtyre institucioneve për të lëshuar mallrat apo ngarkesat.

Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	35. Të zhvillohen procedura standarde në agjencitë përgjegjëse kufitare me qëllim të matjes së kohës mesatare të zhdoganimit në periudha të rregullta kohore (së paku çdo tri vjet). 36. Të identifikohen dhe plotësohen nevojat teknike si dhe ato njerëzore për realizimin e studimit të matjes së kohës mesatare të zhdoganimit.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESËM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	IFC

7.7 MASAT PËR LEHTËSIMIN E TREGTISË PËR OPERATORËT E AUTORIZUAR

Teksti i marrëveshjes

7.1 Secili Anëtar siguron masa shtesë për lehtësimin e tregtisë në lidhje me formalitetet dhe procedurat e importit, eksportit ose tranzitit sipas paragrafit 7.3, për operatorët që i plotësojnë kriteret e cekura, në tekstin e mëtejme: operatorët e autorizuar. Përndryshe, Anëtari mund t'i ofrojë këto masa për lehtësimin e tregtisë përmes procedurave doganore që kryesisht janë në dispozicion të të gjithë operatorëve dhe nuk kërkohet krijimi i ndonjë skeme të ndarë.

7.2 Kriteret e cekura për t'u kualifikuar si operator i autorizuar ndërlidhen me pajtueshmërinë ose rrezikun e mos pajtueshmërisë me kërkesat e cekura në ligje, rregullore ose procedura të ndonjë Anëtari.

(a) Këto kriteret që duhet publikuar, mund të përfshijnë:

- (i) informatat e caktuara për pajtueshmëri me dispozitat doganore si dhe ligje dhe rregullore tjera përkatëse;
- (ii) sistemin për menaxhimin e të dhënave që mundësojnë kontrolle të domosdoshme të brendshme;
- (iii) aftësinë e pagimit, sipas nevojës, përfshirë edhe marrjen e sigurimit ose garancisë së mjaftueshme; dhe
- (iv) sigurinë e zinxhirit të furnizimit.

(b) Këto kriteret nuk duhet:

- (i) dizajnuar ose zbatuar që të sigurojnë ose krijojnë diskriminim të paarsyeshëm mes operatorëve ku mbizotërojnë kushte të njëjta; dhe
- (ii) sipas mundësisë, ta kufizojë pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

7.3 Masat për lehtësimin tregtar të parashikuara me paragrafin 7.1, i përfshijnë së paku tre nga këto masa:

- (a) kërkesa të vogla për dokumente dhe të dhëna sipas nevojës;
- (b) shkallë e vogël e inspektimeve dhe kontrollimeve fizike sipas nevojës;
- (c) kohë e shkurtë e lëshimit sipas nevojës;
- (d) shtyrje e pagesës së detyrimeve, taksave, tarifave dhe ngarkesave;
- (e) përdorimi i garancive përbërëse ose garancive të reduktuara;
- (f) deklaratë unike doganore për të gjitha importet ose eksportet për periudhë të caktuar; dhe
- (g) zhdoganimi i mallrave në objektet e operatorit të autorizuar ose në ndonjë vend tjetër të autorizuar nga dogana.

7.4 Anëtarët inkurajohen të hartojnë skema të operatorëve të autorizuar në bazë të standardeve ndërkombëtare, aty ku ekzistojnë standardet, përveç rasteve kur këto standarde do të ishin mjet i papërshtatshëm ose joefektiv për përmbushjen e objektivave të ndjekura legjitime.

	7.5 Për t'i avancuar masat për lehtësimin e tregtisë që u ofrohen operatorëve, Anëtarët u ofrojnë Anëtarëve të tjerë mundësinë për të negociuar për njohje reciproke të skemave të operatorëve të autorizuar. 7.6 Anëtarët shkëmbejnë informata përkatëse brenda Komitetit për skemat e operatorëve të autorizuar që i kanë në fuqi.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore:
	Dogana e Kosovës viteve të fundit është e fokusuar në fushën e lehtësimit të tregtisë, veçanërisht sa u përket operatorëve të autorizuar ekonomik. Dy vitet e fundit i kanë marrë autorizimet 11 subjekte ekonomike, ndërsa në proces gjatë këtij vitij janë tri subjekte aplikuese. Dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë fushë janë të parapara në Kodin Doganor dhe të Akcizave, Ligji 03/L-109, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-099, si dhe me nenin 10.A të Udhëzimit Administrativ 38/2017 për dhënien e autorizimit për fitimin e statusit të operatorit të autorizuar ekonomik. Për ndihmë subjekteve është përgatitur edhe një formular i vetëvlerësimit. Kjo bazë ligjore është harmonizuar me atë të BE-së dhe është pjesë e kornizës gjithëpërfshirëse në lehtësirat tregtare. Për ndihmë subjekteve është përgatitur formulari i aplikimit dhe forma e vetëvlerësimit të cilat janë të përshtatura me procedurat e OBD-së. Dispozitat ligjore dhe formularët për aplikim janë të publikuar në faqen zyrtare të Doganës së Kosovës. Operatorët e autorizuar ekonomik, funksionojnë në formën e paraparë me dispozitat ligjore në fuqi dhe i gëzojnë të gjitha privilegjet e parapara sipas legjislacionit. Kriteret janë të paanshme dhe zbatohen në kuadër të masave për lehtësimin e tregtisë duke e përfshirë zhdoganimin e mallrave në objektet e operatorit të autorizuar ekonomik.
	B: Procedurat
	Kodi Doganor dhe i Akcizave dhe plotësim-ndryshimet e tij, si dhe Udhëzimi Administrativ 38/2017 për dhënien e autorizimit për fitimin e statusit të operatorit të autorizuar ekonomik i mbulojnë të gjitha procedurat për të mundësuar përzgjedhjen dhe monitorimin e operatorëve të autorizuar si dhe çështjet e tjera të apostrofuara në artikullin 7.7 të MLT-së.
	C. Korniza institucionale
	Komisioni i ngritur për vlerësimin e aplikacioneve për operatorë të autorizuar ekonomik ka në përbërje përfaqësues të sektorëve të ndryshëm relevant nga fusha e procedurave, auditimit, riskut, TI-së, etj. I njëjti komision është i autorizuar të bëjë monitorimin e subjekteve të autorizuar për OEA.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Të plota, si në numër ashtu edhe në nivelin e shkathtësive.

	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Teknologjia në zbatim adreson në plotësi kërkesat sipas MLT të OBT-së.
Pengesat (ofroni arsytet për mospërputhje)	Shumica e vendeve të rajonit dhe më gjerë nuk i pranojnë AEO-të e autorizuara nga Kosova. Njohja e ndërsjellë e AEO-ve është në procedurë dhe po mbështetet nga GIZ
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	37. Validimi i programit të AEO-ve në rrafshin ndërkombëtar me qëllim të pranimit të AEO-ve të aprovuara nga autoritetet në Kosovë nga ana e vendeve të tjera.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESËM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	EU, GIZ

7.8 DËRGESAT E SHPEJTA

Teksti i marrëveshjes

8.1 Çdo Anëtar miraton ose zhvillon procedura që e lejojnë lirimin e shpejtë të paktën të atyre mallrave që hyjnë përmes transportit ajror të personave që aplikojnë për masa të tilla, duke e bërë të mundur edhe kontrollin doganor. Nëse Anëtari përdor kritere që kufizojnë se kush mund të aplikojë, Anëtari, në kriteret e publikuara mund të kërkojë që parashtruesi, si kusht për kualifikim për të aplikuar për trajtimin e përshkruar në paragrafin 8.2, për dërgesat e tija të shpejta:

- (a) ta sigurojë infrastrukturën e duhur dhe pagesën e shpenzimeve doganore për procesimin e dërgesave të shpejta kur parashtruesi i plotëson kërkesat e Anëtarit që ky procesim të bëhet në objektin e dedikuar për këtë punë;
- (b) t'i paraqesë informatat e nevojshme për lëshim para se të arrijë dërgesa e shpejtë;
- (c) t'i vlerësojë tarifat e kufizuara në shumën e shpenzimeve të përafërta me shërbimet e kryera për ofrimin e trajtimit të përshkruar në paragrafin 8.2;
- (d) ta mbajë në shkallë të lartë kontrollin mbi dërgesat e shpejta përmes përdorimit të teknologjisë për siguri të brendshme, logjistikë dhe gjurmim nga pranimi e deri tek dorëzimi;
- (e) ta sigurojë dërgesën e shpejtë nga pranimi deri tek dorëzimi;
- (f) ta marrë përsipër përgjegjësinë për pagesën e të gjitha detyrimeve doganore, taksave, tarifave dhe ngarkesave ndaj autoritetit doganor për mallra;
- (g) të ketë të dhëna që dëshmojnë përputhshmërinë me doganën si dhe ligjet dhe rregulloret e tjera përkatëse;
- (h) të jetë në përputhje me kushtet e tjera që ndërlidhen drejtpërdrejtë me zbatimin efikas të ligjeve, rregulloreve dhe kërkesave procedurale të Anëtarit, që ndërlidhen në mënyrë specifike me ofrimin e trajtimit të përshkruar në paragrafin 8.2.

8.2 Varësisht paragrafëve 8.1 dhe 8.3, Anëtarët:

- (a) e zvogëlojnë numrin e dokumenteve të kërkuara për lirimin e dërgesave të shpejta sipas paragrafit 1 të nenit 10 dhe, sipas mundësisë, e sigurojnë lirimin në bazë të vetëm një paraqitjeje të informatave për dërgesat e caktuara;
- (b) mundohen që në rrethana normale dërgesat e shpejta të lirohen sa më shpejt që është e mundur pas mbërritjes, me kusht që të dorëzohen informatat e kërkuara për lirim;
- (c) mundohen ta zbatojnë trajtimin në nën-paragrafët (a) dhe (b) për dërgesat me çdo peshë ose vlerë duke pranuar se Anëtarit i lejohet të kërkojë procedura shtesë për hyrje, përfshirë deklaratat dhe dokumentet mbështetëse si dhe pagesën e detyrimeve dhe të taksave, dhe ta kufizojnë këtë trajtim në bazë të llojit të mallit, me kusht që

	trajtimi të mos kufizohet vetëm në mallra me vlerë të vogël siç janë dokumentet; dhe (d) sigurojnë, sipas mundësisë, një vlerë minimale të dërgesës ose shumë të detyrueshme për të cilën nuk do të mblidhen detyrimet doganore dhe taksat, përveç për mallra të caktuara të përshkruara. Taksat vendore, si tatimi mbi vlerën e shtuar dhe akciza, që aplikohen për importet në përputhje me nenin III të GATT 1994 nuk i nënshtrohen kësaj dispozite. 8.3 Asgjë në paragrafët 8.1 dhe 8.2 nuk ndikon në të drejtën e Anëtarit për ta kontrolluar, ndaluar, marrë, konfiskuar ose refuzuar hyrjen e mallrave, ose për të kryer kontrole pas zhdoganimit, përfshirë përdorimin e sistemeve për menaxhimin e rrezikut. Tutje, asgjë në paragrafët 8.1 dhe 8.2 nuk e pengon Anëtarin që të kërkojë, si kusht për lirim, paraqitjen e informatave shtesë dhe përmbushjen e kërkesave për licencim jo-automatik.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore:
	Korniza specifike ligjore përmes së cilës janë të rregulluara dërgesat e shpejta është Urdhëresa për Zbatimin e Procedurës për Dërgesa Ekspres Nr. 01/769/2022, e korrikut 2021.
	B: Procedurat
	Aplikimi, formularët, forma e vlerësimit dhe procesi i vendimmarrjes, janë të formalizuara me legjislacion specifik (Urdhëresa për Zbatimin e Procedurës për Dërgesa Ekspres Nr. 01/769/2022) dhe janë në zbatim nga Dogana e Kosovës.
	C. Korniza institucionale
	Korniza institucionale ekziston si dhe Sektori për Procedura dhe Autorizime merret me dhënien e autorizimeve
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Burimet njerëzore janë të trajnuara për të trajtuar çështjet që lidhen me dërgesat e shpejta, si dhe stafi që punon në procesin e zhdoganimit të mallrave janë të pajisur me udhëzime të mjaftueshme për operim.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Në kuadër të sistemit elektronik ASYCUDA World është zhvilluar moduli i veçantë për futjen e shënimeve komerciale në para-arritje, këto shënime e lehtësojnë shumë procesin e zhdoganimit të dërgesave të shpejta.
	F. Pajisjet & infrastruktura
	▪ Infrastruktura është e siguar nga vet operatorët e dërgesave të shpejta.

Pengesat (ofroni arsytet për mospërputhje)	Mungesa e një qendre të vetme tranzitore postare për zhdoganim të dërgesave të shpejta.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	38. Inkurajimi i operatorëve postarë – privat dhe publik – me qëllim të shfrytëzimit të infrastrukturës ligjore për zhdoganimin e dërgesave të shpejta.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës
Niveli i zbatueshmërisë	PLOTËSISHT Kryesisht Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	GIZ

7.9 MALLRAT QË PRISHEN

Teksti i marrëveshjes	9.1 Me qëllim të parandalimit të humbjes ose dëmtimit të shmangshëm të mallrave që prishen dhe me kusht që të gjitha kërkesat rregullatore të përmbushen, secili Anëtar parashikon lirimin e mallrave që prishen: (a) në rrethana normale për kohë sa më të shkurtër të mundshme; dhe (b) në rrethana të jashtëzakonshme, kur do të ishte e përshtatshme, jashtë orarit të punës së doganës dhe organeve tjera përkatëse. 9.2 Secili Anëtar u jep përparësi të duhur mallrave që prishen kur e përgatisin orarin e kontroleve që mund të kërkohen. 9.3 Secili Anëtar e organizon ose i lejon importuesit që ta organizojë ruajtjen e duhur të mallrave që prishen deri sa presin për lirim. Anëtari mund të kërkojë që çdo depo e importuesit të jetë e miratuar ose caktuar nga organet përkatëse. Lëvizja e mallrave në depo, përfshirë autorizimet për operatorin që i lëviz mallrat, mund t'i nënshtrohen miratimit, nëse kërkohet nga autoritetet përkatëse. Anëtari, sipas mundësisë dhe bazuar në legjislacionin vendor, me kërkesë të importuesit, e siguron procedurën e nevojshme për lirim në ato depo. 9.4 Nëse ka vonesa të mëdha në lirimin e mallrave që prishen, pas kërkesës me shkrim, Anëtari importues, sipas mundësisë jep njoftim për arsyet e vonesës.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Kodi Doganor dhe i Akcizës përcakton obligimin që për mallrat që mund të prishen të aplikohen lehtësira dhe procedura të thjeshtëzuara të deklarimit. Korniza ligjore mungon. Mirëpo, ekzistojnë procedurat e thjeshta për zhdoganim nga ana e AUVK për kategori të caktuara të mallrave (mështjerrat bartëse dhe qumështi i pasterizuar i transportuar me cisterna). B: Procedurat AUVK bazohet në planin ditor ku prioritet iu jepet mallrave që prishen dhe vendoset të zhdoganohen me prioritet për të evituar pritjet. Autoritetet kompetente i lejojnë importuesit t'i mbajnë mallrat që prishen në objekte të tjera deri sa presin vendimin përfundimtar. D. Burimet njerëzore/trajnimi Stafi është kryesisht i mjaftueshëm por trajnimet janë të domosdoshme në vazhdimësi. E. Komunikimi/teknologjia e informacionit

	ASYCUDA World brenda Doganës së Kosovës dhe sistemi elektronik i AUVK, të dyja i integrojnë sistemet e përpunimit me prioritet të mallrave që prishen.
	F. Pajisjet & infrastruktura
	Në kuadër të terminaleve doganore, të cilat kryesisht janë të administruara nga kompani private, ekzistojnë hapësira të veçanta në varësi të llojit të mallrave që mundësojnë ruajtjen e tyre në kushte optimale (p.sh.. frigorifer, etj).
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	- Mangësi të caktuara në sistemin e kontrollit të mallrave që prishen dhe zhdoganimin e tyre me prioritet nga institucionet përkatëse. - Kufizimet e stafit që do të kryenin kontrolle edhe më të shpejta të mallrave në përgjithësi, e në veçanti të mallrave që prishen.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	39. Të bëhet një analizë e detajuar e faktorëve që ndikojnë në procesimin e shpejtë të mallrave që prishen dhe të ofrohen rekomandime mbi ndryshimet eventuale të procedurave që do të mundësonin trajtimin me prioritet të kësaj kategorie mallrash, pastaj të rritjes së koordinimit institucional, ngritjes së kapaciteteve teknike dhe infrastrukturore, e të ngjashme. 40. Rritja e personelit dhe ngritja e kapaciteteve ekzistuese në AUVK dhe Doganën e Kosovës, veçanërisht të inspektorëve kufitar që do t'i mbulonin mallrat që prishen. 41. Rritja e kapaciteteve infrastrukturore për trajtimin e mallrave që prishen në терминалет doganore.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESËM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	IFC, TAIEEX, USAID, GIZ

8. BASHKËPUNIMI I AGJENCIVE KUFITARE

Teksti i marrëveshjes

1. Secili Anëtar siguron që autoritetet dhe agjencitë e tij përgjegjëse për kontroll kufitar dhe procedurat që ndërlidhen me import, eksport dhe tranzit të mallrave të bashkëpunojnë me njëra tjetrën dhe t'i koordinojnë aktivitetet e tyre në lehtësimin e tregtisë.
2. Secili Anëtar, sipas mundësisë, bashkëpunon sipas kushteve të marrëveshjes reciproke me Anëtarët e tjerë me të cilët e ndan kufirin e përbashkët, me qëllim të koordinimit të procedurave në vendkalimet kufitare për ta lehtësuar tregtinë ndërkufitare. Ky bashkëpunim dhe koordinim mund të përfshijë:
 - 3 Për nevojat e kësaj dispozite, mallrat që prishen janë mallra që prishen shpejt për shkak të vetive të tyre natyrore, veçanërisht në mungesë të kushteve të përshtatshme për ruajtje.
 - (a) harmonizimin e ditëve dhe orarit të punës;
 - (b) harmonizimin e procedurave dhe formaliteteve;
 - (c) përgatitjen dhe përdorimin e përbashkët të objekteve;
 - (d) kontrollet e përbashkëta;
 - (e) vendosjen e pikës së vetme të kontaktit për kontrolle kufitare

Gjendja ekzistuese

A. Politika/korniza ligjore:

Në rrafshin e bashkëpunimit ndërinstytucional, korniza politiko-ligjore përcaktohet përmes:

1. Ligji për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror 04/L-072, neni 47- Bashkëpunimi i organeve shtetërore në fushën e menaxhimit të kufirit. Qëllimi i këtij ligji është ta sigurojë qarkullimin e shpejtë të njerëzve, mallrave dhe mjeteve transportuese në pikat ndërkufitare. Neni 48 “Bashkëpunimi mes organeve shtetërore realizohet përmes Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit. Ligji 04/L-216 për Bashkëpunimin ndërmjet Agjencive të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit”, Neni 1.2 “Autoritetet publike të përfshira në MIK, Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe AUVK.” Neni 6 “përfshin autoritetet tjera publike.”
2. Memorandume Mirëkuptimi ndërmjet agjencive kufitare vendore
Memorandum Bashkëpunimi në mes të agjencive kufitare (Dogana e Kosovës, AUVK, AKPPM), ku përmes këtij memorandumit parashihet shkëmbimi i të dhënave në nivel nacional, varësisht prej nevojave, edhe në atë rajonal me qëllim të lehtësimit të procedurave gjatë zhdoganimit të mallrave.
3. Bashkëpunimi me agjencitë kufitare të vendeve të tjera
Dogana e Kosovës dhe AUVK kanë marrëveshje bilaterale me shtete të ndryshme. Në bazë të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare 2011/04-L-

	052, Ministria e Punëve të Jashtme duhet tu japë leje ministrive të tjera për t'i negociuar marrëveshjet ndërkombëtare (Zyra e Inspektoratit).
	B: Procedurat
	Janë të miratuara PSO për operacione të përbashkëta të kontrollit në kufi
	C. Korniza institucionale
	Është krijuar Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar (QKMK). Funksion në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme që nga janari i vitit 2013.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Numri i stafit pjesërisht i mjaftueshëm, mirëpo mirë i trajnuar.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Ligji 04/L-216 për Bashkëpunimin Ndërmjet Autoriteteve të përfshira në MIK i rregullon në mënyrë specifike procedurat dhe mekanizmat për shkëmbimin e informatave, shfrytëzim të përbashkët të mjeteve dhe pajisjeve. Ekziston interface (ndërfaqe) e më shumë se 16 bazave nacionale të cilat integrohen në QKMK përmes platformës Qlickview dhe sistemeve CMS dhe BI.
	F. Pajisjet & infrastruktura
	EXBS ka dhuruar pajisje dhe programe elektronike për aktivitete të përbashkëta të kontrolleve kufitare.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Hapësira për fuqizim të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional ende është e konsiderueshme, me qëllim të lehtësimit të mëtejme të lëvizjes së njerëzve dhe mallrave.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	42. Të bëhet një analizë mbi efektivitetin e bashkëpunimit ndërinstitucional të organeve kufitare, dhe të ofrohen rekomandime mbi fushat ku ka nevojë, të identifikohen fushat e reja të bashkëpunimit ndërinstitucional, të përcaktohen prioritetet e bashkëpunimit dhe të qartësohen modalitetet e bashkëpunimit.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK, dhe agjencitë e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I LARTË I mesëm

	I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	EXBS, ICITAP dhe Zyra Përfaqësuese e BE-së në Kosovë

9. LËVIZJA E MALLRAVE NËN KONTROLL DOGANOR TË DESTINUARA PËR IMPORT

Teksti i marrëveshjes	Secili Anëtar, sipas mundësisë, dhe me kusht që të plotësohen të gjitha kërkesat rregullatore, lejon që mallrat e destinuar për import të lëvizin brenda territorit të vet nën kontroll doganor nga zyra doganore e hyrjes në zyrën tjetër doganore në territorin e vet ku mallrat do të lëshohen ose zhdoganohen.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore:
	Procedurat për aplikim për tranzit janë të njëjta si për tranzitin vendor ashtu edhe për atë ndërkombëtar. Në këtë mënyrë, të gjitha informatat dokumentohen dhe publikohen. Kodi Doganor dhe i Akcizës e adreson çështjen e transitit por jo me dispozita të veçanta. Me kodin ri i cili është në procedurë të miratimit është adresuar kjo kërkesë/çështje.
	B: Procedurat
	Procedurat janë të harmonizuara dhe të ndërlidhura me agjencitë e tjera ligj-zbatuese. Janë miratuar procedura specifike (UA 11/2009) që mundësojnë implementimin e transitit të brendshëm.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Oficerët doganor janë të trajnuar për zbatimin e kësaj procedure.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	ASYCUDA World mundëson “tranzitin e brendshëm”.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Shih II.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	43. Shih II.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë

	I MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

10.1 FORMALITETET DHE KËRKESAT PËR DOKUMENTACION

Teksti i marrëveshjes	I.1 Me qëllim të zvogëlimit të shpeshtësisë dhe kompleksitetit të formaliteteve në importit, eksport dhe tranzit si dhe për t'i zvogëluar dhe thjeshtuar kërkesat për dokumente në import, eksport dhe tranzit si dhe duke i marrë parasysh objektivat legjitime të politikave dhe faktorët tjerë, siç janë ndryshimi i rrethanave, informatat e reja përkatëse, praktikat afariste, teknikat dhe teknologjia në dispozicion, praktikat më të mira ndërkombëtare dhe kontributet nga palët e interesuara, secili Anëtar do t'i rishqyrtojë këto formalitete dhe kërkesa për dokumente dhe sipas rezultateve të rishqyrtimit, siguron sipas nevojës që këto formalitete dhe kërkesat për dokumente të jenë: (a) miratuar dhe/ose zbatuar me qëllim të lirimit dhe zhdoganimit të shpejtë të mallrave, sidomos të mallrave që prishen; (b) miratuar dhe/ose zbatuar në atë mënyrë që synon ta shkurtojë kohën dhe të zvogëlohen shpenzimet e pajtueshmërisë për tregtarë dhe operatorë; (c) përzgjedhë masën sa më të vogël kufizuese tregtare kur dy ose më shumë masa alternative janë në dispozicion për përmbushjen e objektivit ose të objektivave të politikave në fjalë; dhe (d) jo të mirëmbajtura, përfshirë ndonjë pjesë të tyre, nëse nuk kërkohen më. I.2 Komiteti përgatit procedura për ndarjen e informatave përkatëse dhe praktikave më të mira nga Anëtarët, sipas nevojës.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Organet kompetente kufitare herë pas here e rishikojnë dokumentacionin dhe procedurat për eksport, import dhe tranzitin e mallrave, me qëllim të lehtësimit të tregtisë dhe realizimit të shpejtë të zhdoganimit të mallrave. Në raste të caktuara të njëjtat edhe konsultohen me sektorin privat, por jo në mënyrë sistematike dhe të strukturuar. Formalitetet, procedurat dhe dokumentacioni për eksport, import, dhe transit që kërkohet nga AUVK për çështje të kontrolleve fito-sanitare rishikohet vazhdimisht që të shihet nëse dokumentacioni i kërkuar është në pajtim me standardet dhe praktikat e BE-së. Në të ardhmen e afërt planifikohet një analizë e detajuar mbi pajtueshmërinë e formaliteteve dhe të dokumentacionit të kërkuar për eksport, import dhe tranzit të mallrave në përputhje me AP5 të CEFTA-s. B: Procedurat Formalitetet dhe kërkesat për dokumentacion në eksporte, importe, dhe transit burojnë nga KDA 03/L-109, i plotësuar me Ligjin 04/L-099, i cili është pjesërisht i harmonizuar me Kodin Evropian, si dhe UA 11/2009 për Dispozitat Zbatuese të Kodit.

	Në rastin e formaliteteve dhe kërkesave për dokumentacion në eksport, transit, dhe import, AUVK bazohet kryesisht në Ligjin e Ushqimit dhe Rregulloret që burojnë nga ky ligj. Rishikimi i dokumentacionit dhe i procedurave në import dhe eksport bëhet si rezultat i reformave të përgjithshme qeveritare për reduktimin e barrës administrative.
	C. Korniza institucionale
	Departamenti Ligjor brenda Doganës së Kosovës (Sektori për Këshilla dhe Procedura) bën rishikimin e herëpashershëm të procedurave dhe dokumentacionit për eksport, import, dhe tranzit. Ndërsa në rastin e AUVK ky rishikim bëhet nga Ministria e Bujqësisë si formuluese e politikave të cilat implementohen nga AUVK. Në kuadër të Doganës së Kosovës, Sektori për Analizën e Riskut, në baza të rregullta (muajore) analizon kohën e zhdoganimit me qëllim të lehtësimit të procedurave doganore. Për më tepër, në kuadër të Doganës së Kosovës, është themeluar edhe Komiteti i Riskut i cili në baza ad hoc i shqyrton përqindjet e kontrollit sipas kanaleve të analizës së riskut (i gjelbër, kuq, kaltër, i verdhë).
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Sektori i Analizës së Riskut (SAR) në Doganën e Kosovës ka kuadro të përgatitura për kryerjen e analizave për vlerësimin e ndikimit të formaliteteve dhe dokumentacionit të kërkuar. SAR ka personel të përgatitur mirë për analiza dhe të trajnuar për të aplikuar metoda të sofistikuar të analizave të riskut.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	SAR e përdor programin COGNOS, ASYCUDA World, dhe SEED për qëllime të vlerësimit të riskut, si dhe të ndikimit të formaliteteve dhe dokumentacionit të kërkuar.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Mungesë e analizave në baza të rregullta për të parë ndikimin e formaliteteve dhe të dokumentacionit të kërkuar në agjencitë përgjegjëse, veçanërisht në AUVK dhe agjencitë e tjera kufitare.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	44. Të bëhet analizë vjetore e detajuar mbi formalitetet dhe dokumentacionin e kërkuar për eksportin, importin dhe e tranzitin e mallrave në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. 45. Dogana e Kosovës, së bashku me organet e tjera kompetente, në baza vjetore të matin kohën e lëshimit të mallrave në qarkullim të lirë në eksporte dhe importe me qëllim të eliminimit të fyteve të ngushta (pengesave) në qarkullimin e mallrave që janë të lidhura me kërkesat për dokumente.

	46. Nën ombrellën e KNLT-së, Dogana e Kosovës së bashku me AUVK si dhe me sektorin privat. të përgatisin programin për implementimin e masave për thjeshtëzimin e procedurave ne eksport, import, dhe tranzit.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK, institucionet e tjera kufitare, dhe sektori privat
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht Kryesisht PJESËRISHT Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I LARTË I mesëm I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	IFC, USAID

10.2 PRANUESHMËRIA E KOPJEVE

Teksti i marrëveshjes	2.1 Secili Anëtar, kur është e përshtatshme, përpiqet t'i pranojë kopjet në letër ose ato elektronike të dokumenteve mbështetëse që nevojiten për formalitete të importit, eksportit ose tranzitit. 2.2 Kur një agjenci qeveritare e ndonjë Anëtari e mban originalin e ndonjë dokumenti, çdo agjenci tjetër e atij Anëtari e pranon kopjen në letër ose atë elektronike, kur është e aplikueshme, nga agjencia që e mban originalin në vend të dokumentit origjinal. 2.3 Anëtari nuk e kërkon originalin ose kopjen e deklaratave të eksportit që dorëzohen tek autoritetet doganore të Anëtarit eksportues si kërkesë për import.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Çështja e pranimi të dokumentacionit për eksport, import, dhe transit është shqyrtuar në Programin për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027. Dogana e Kosovës nuk pranon kopje të certifikatës së origjinës (EUR I), ndërsa për dokumente të tjera (faturën e ngarkesës, faturën, listën e paketimit), nuk ka rregull të caktuar për pranimin e tyre. Zyra e Inspektoratit në kuadër të AUVK, prodhuesi duhet ta mbajë një dokument teknik origjinal ndërsa distributorët duhet ta kenë një kopje të dokumenteve teknike. AUVK ua kërkon gjithmonë një dokument origjinal (certifikatën veterinare dhe fito-sanitare) dhe ia lëshon një certifikatë prodhuesit. Dogana e Kosovës dhe AUVK nuk e kërkojnë deklaratën e eksportit si kusht për importimin e mallrave.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Mungesa e ndërlidhjes së sistemeve elektronike të agjencive përgjegjëse kufitare me sistemet e vendeve eksportuese me qëllim të verifikimit të validitetit të kopjeve të dokumentacionit.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	47. Të hulumtohen mënyrat e ndërlidhjes apo komunikimit në mes të sistemeve elektronike të agjencive përgjegjëse kufitare në Kosovë me sistemet e vendeve eksportuese me qëllim verifikimin e validitetit të kopjeve të dokumentacionit.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK, dhe agjencitë e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht Kryesisht PJESËRISHT Aspak Nuk aplikohet

Niveli i prioritetit	I LARTË I mesëm I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

10.3 PËRDORIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE

Teksti i marrëveshjes	3.1 Anëtarët inkurajohen t'i përdorin standardet përkatëse ndërkombëtare ose një pjesë të tyre si bazë për formalitete dhe procedura të tyre të importit, eksportit ose tranzitit, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje. 3.2 Anëtarët inkurajohen të marrin pjesë, në kuadër të kufizimeve të burimeve të tyre, në përgatitjen dhe rishqyrtimin periodik të standardeve përkatëse ndërkombëtare nga organizatat përkatëse ndërkombëtare. 3.3 Komiteti, sipas nevojës, i përgatit procedurat për ndarjen e informatave përkatëse dhe praktikave më të mira për zbatimin e standardeve ndërkombëtare nga Anëtarët. Komiteti mund t'i ftojë edhe organizatat përkatëse ndërkombëtare për të diskutuar në lidhje me punën e tyre në standardet ndërkombëtare. Sipas nevojës, Komiteti mund të identifikojë standarde specifike që kanë vlerë të veçantë për Anëtarë.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Dogana e Kosovës është Anëtare e OBD-së dhe Kodi Doganor dhe i Akcizës bazohet në Kodin Doganor të BE-së dhe është në përputhje të plotë me rregullat e miratuara nga OBD për procedurat doganore dhe sistemin e harmonizuar për përshkrim dhe kodim të mallrave. Aktualisht, projekt kodi i ri doganor është në procedurë përfundimtare të miratimit. Miratimi i tij do të harmonizojë edhe më tutje procedurat për eksport, import, dhe tranzit me standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Nga 108 standarde sipas Konventës së Rishikuar të Kyotos të OBD-së, Republika e Kosovës nuk i ka të harmonizuara apo nuk i ka të inkorporuara në legjislacion vendor vetëm dhjetë standarde. Ndërsa nga 13 standarde tranzicionale, Kosova nuk i ka të harmonizuara, apo të inkorporuara në legjislacion vendor vetëm dy standarde tranzicionale. B: Procedurat Legjislacioni doganor dhe udhëzimet përcjellëse mbi procedurat dhe formalitetet e importit, eksportit, dhe të tranzitit janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Edhe Kodi i ri Doganor dhe i Akcizës është harmonizuar me Rregulloren e BE-së nr. 952/2013 për Kodin Doganor të BE-së. C. Korniza institucionale Departamentet ligjore të autoriteteve kompetente sigurohen që të zbatohen të gjitha standardet e reja ndërkombëtare. D. Burimet njerëzore/trajnimi Stafi i agjencive përgjegjëse ndjek trajnime të vazhdueshme mbi aplikimin e standardeve ndërkombëtare.

Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Moszbatimi i dhjetë standardeve sipas Konventës të Kyotos të OBD-së, dhe mos-harmonizimi i 13 standardeve të tjera sipas së njëjtës Konvente.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	48. Angazhimi për zbatimin e standardeve të cilat nuk janë zbatuar apo nuk janë harmonizuar ende nga Dogana e Kosovës.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK, dhe agjencitë e tjera përgjegjëse
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I LARTË I mesëm I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

10.4 DRITARJA E VETME

Teksti i marrëveshjes	4.1 Anëtarët përpiqen të krijojnë ose mbajnë një dritare të vetme, që u mundëson tregtarëve që t'i paraqesin kërkesat për dokumente dhe/ose të dhënat për import, eksport ose tranzit të mallrave nëpërmjet një pike të vetme hyrëse tek autoritetet ose agjencitë pjesëmarrëse. Pas shqyrtimit të dokumenteve dhe/ose të dhënave nga autoritetet ose agjencitë pjesëmarrëse, rezultatet do t'u komunikohen parashtruesve me kohë përmes dritares së vetme. 4.2 Nëse kërkesat për dokumente dhe/ose të dhëna veçse janë marrë nga dritarja e vetme, kërkesat e njëjta për dokumente dhe/ose të dhëna nuk kërkojnë më nga autoritetet ose agjencitë pjesëmarrëse, përveç në rrethana urgjente dhe përjashtime tjera të kufizuara, të bëra publike. 4.3 Anëtarët e njoftojnë Komitetin mbi detajet e funksionimit të dritares së vetme. 4.4 Anëtarët sipas mundësisë, e përdorin teknologjinë informative për ta mbështetur dritaren e vetme.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore Qeveria e Kosovës planifikon të zbatojë një Dritare të Vetme Kombëtare për të lehtësuar tregtinë ndërkombëtare dhe stimuluar rritjen ekonomike. Me mbështetje të IFC-së, Qeveria e Kosovës ka zhvilluar studimin e fizibilitetit për Dritaren e Vetme Kombëtare për Kosovën (DVK). Informatat në vijim janë të bazuara në këtë dokument. Me vendim të Ministrit të MFPT-së është themeluar Grupi Punues për zhvillimin e Dritares së Vetme me nr. 33/2022. i datës 20.05.2022. Legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë nuk prezanton ndonjë pengesë për zbatimin e konceptit të dritares së vetme. Baza ligjore e cila e mbështet DVK-në është: • Ligji nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike • Ligji nr. 08/L-022 për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike • Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe • Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Mirëpo, themelimi dhe funksionalizimi i plotë i DVK-së kërkon ligj të veçantë, i cili përcakton mandatin, operatorin – përcaktimi i autoritetit dhe përgjegjësitë të operatorit – institucionet pjesëmarrëse, strukturën qeverisëse, e kështu me radhë. B: Procedurat Legjislacioni bazë për themelimin dhe funksionalizimin e DVK-së duhet të parasheh akte nënligjore të cilat do të bëjnë të mundur përdorimin e mesazheve dhe nëshkrimeve elektronike kur transaksionet e importit dhe eksportit të kryhen përmes DVK-së. Aktet nënligjore të ndërlidhura me

	legjislacionin në fuqi (shih më lartë) duhet rishikuar me qëllim të autorizimit të institucioneve përgjegjëse të kërkojnë formularë elektronikë në vend të proceseve në letër apo manuale.
	C. Korniza institucionale
	Dogana e Kosovës do të luaj rol in udhëheqës si gjatë implementimit ashtu edhe gjatë operimit të DVK-së. Për më tepër, edhe ASHI do të ketë rol të rëndësishëm në implementimin e DVK. Kjo e fundit duhet të oftojë zgjidhje teknike në fushat në vijim: • Të rikonfiguroj portalin e-Kosova që të shërbejë si portë hyrëse për në portalin e DVK-së. • Ofrimin e serverit të nevojshëm dhe infrastrukturës së rrjetit përmes së cilit do të bëhet hostingu i sistemit të DVK-së dhe do të krijohet qasja në të.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Duhet shtuar numrin të personelit si dhe ngritjes së shkathtësive të stafit i cili do të mbulojë funksionimin e plotë të DVK-së.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Studimi i fizibilitetit e specifikon infrastrukturën teknike të kërkuar për implementimin e DVK-së.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	▪ Legjislacioni jo i plotë për implementimin e DVK-së ▪ Kapacitete jo të plota teknike dhe njerëzore për funksionimin e plotë të DVK-së ▪ Kufizime buxhetore për implementimin e DVK-së
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	49. Analiza e plotë e kornizës ligjore për implementimin e DVK-së dhe zbatimi i ndryshimeve ligjore që do të bëjnë të mundur jetësimin e dritares së vetme. Draftimi i ligjit të veçantë për DVK. 50. Ndërtimi i mekanizmave koordinues për implementimin dhe menaxhimin e dritares së vetme në mes të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e DVK-së. 51. Analiza e sistemeve të TI-së dhe infrastrukturës tjetër me qëllim të zbatimit të DVK-së. Për më tepër, ku është e nevojshme, zhvillimi i sistemeve shtesë me qëllim të shkëmbimit më të madh dhe më të sigurt të të dhënave. 52. Rritja e kapacitetet profesionale të stafit me qëllim të zhvillimit dhe implementimit të dritares së vetme. 53. Sigurimi i mjeteve financiare për implementimin e DVK-së.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), ZKM, AUVK, ASHI, MINT dhe agjencitë e tjera përgjegjëse

Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht Kryesisht Pjesërisht ASPAK Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I LARTË I mesëm I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

10.5 INSPEKTIMI PARA-ARRITJES

Teksti i marrëveshjes	5.1 Anëtarët nuk do të kërkojnë inspektim para dërgimit të dërgesës sa i përket klasifikimit tarifor dhe vlerësimit doganor. 5.2 Pa i paragjykuar të drejtat e Anëtarëve për përdorimin e llojeve të tjera të inspektimit para dërgimit e që nuk mbulohen nga paragrafi 5.1, Anëtarët inkurajohen të mos paraqesin ose të aplikojnë për kërkesa shtesë në lidhje me përdorimin e tyre.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore:
	Legjislacioni doganor bën të mundur paraqitjen dhe përpunimin e deklaratës doganore para arritjes së mallrave në kufi (KDA 099) dhe UA 02/2022 për plotësim ndryshimin e UA 11/2009. UA 18/2005 u mundëson operatorëve ti njoftojnë autoritetet për arritjen e ngarkesës së importit para arritjes së dërgesës. Ky mekanizëm nuk implementohet në rastin e eksportit.
	C. Korniza institucionale
	Në masë të konsiderueshme, Dogana e Kosovës është e organizuar në formën e tillë që e bën të mundur klasifikimin dhe vlerësimin doganor. Në kuadër të Doganës së Kosovës është e themeluar njësi për kontrollin pas zhdoganimit të mallit (Njësia për Kontrollin pas Zhdoganimit). Analiza e riskut është e integruar në ASYCUDA World, dhe zbatohet në deklaratimet e dërgesave para arritjes. Bartës i analizës së riskut në Doganën e Kosovës është Sektori për Analizën e Riskut.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Kapacitetet njerëzore janë të afta dhe të trajnuara për aplikimin e klasifikimit tarifor si dhe aplikimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin doganor.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	▪ Mungesa e ndërlidhjes së sistemit elektronik të AUVK-it me sistemet e tjera përfshirë këtu TRACES-NT. ▪ Mungesa e qasjes në sistemin SEED+ e cila do të mundësonte integrimin e certifikatave veterinarë dhe fito-sanitare, si dhe dokumentin <i>Common Health Entry Document</i>.
Veprimet/burimet e nevojshme &	54. Dogana e KS dhe AUVK, në bashkëpunim me sektorin privat, do të koordinojnë zhvillimin dhe implementimin e instrumenteve përkatëse për thjeshtëzim të procedurave (siç është deklarimi i dërgesave para-

shpenzimet (numëroni veprimet)	arritjes) me qëllim të inkurajimit të shfrytëzimit të këtyre procedurave nga ana e palëve të interesit (veçanërisht të sektorit privat).
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), AUVK, ATK
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I LARTË I mesëm I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	GIZ

10.6. PËRDORIMI I AGJENTËVE DOGANOR

Teksti i marrëveshjes	6.1 Pa i paragjykuar çështjet e rëndësishme të politikave të disa Anëtarëve që aktualisht kanë rol të veçantë për agjentët doganor që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, Anëtarët nuk e fusin përdorimin e detyrueshëm të agjentëve doganor. 6.2 Secili Anëtar e njofton Komitetin dhe i publikon masat e veta mbi përdorimin e agjentëve doganor. Çdo modifikim pasues njoftohet dhe publikohet menjëherë. 6.3 Sa i përket licencimit të agjentëve doganor, Anëtarët zbatojnë rregulla transparente dhe objektive.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Kodi doganor dhe i akcizave, neni 10 dhe 11, parasheh dispozita për përfaqësim të subjekteve ekonomike. Me aktet nënligjore të nxjerra me qëllim të zbatimit të këtyre dispozitave janë specifikuar kushtet e përfaqësimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së agjencive doganore. Angazhimi i agjentëve doganor në procedurë të deklarimit të mallrave në parim nuk është i detyrueshëm sipas Kodit Doganor. Me UA nr.62/2019 është rregulluar procedura e regjistrimit të operatorëve ekonomik dhe përfaqësuesve në procedurën doganore.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Edhe pse duket që bashkëpunimi në mes të Doganës së Kosovës dhe sektorit privat, veçanërisht përfaqësuesve të agjentëve doganor, është i kënaqshëm, hapësirat për avancim të këtij bashkëpunimi janë të konsiderueshme.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	55. Forcimi i shkëmbimit të informacioneve në mes të institucioneve përgjegjëse kufitare dhe agjentëve doganor (veçanërisht Shoqatës së Shpedicionit të Brendshëm dhe Ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, si përfaqësuese e tyre) mbi ndryshimet në legjislacionin dhe procedurat për realizimin e eksportit, importit, dhe tranzitit. 56. Mbështetja institucionale (veçanërisht, nga Dogana e Kosovës) për ngritjen e kapaciteteve njerëzore brenda profesionit të agjentëve doganor. 57. Avancimi i legjislacionit dhe rregullativës përcjellëse me qëllim të licencimit të agjentëve doganor.
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht Kryesisht PJESËRISHT Aspak

	Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

10.7 PROCEDURAT E PËRBASHKËTA KUFITARE DHE KËRKESAT UNIFORME PËR DOKUMENTE

Teksti i marrëveshjes	7.1 Secili Anëtar, bazuar në paragrafin 7.2, zbaton procedura të përbashkëta doganore dhe kërkesa të njëjta për dokumente në lidhje me lirimimin dhe zhdoganimin e mallrave në tërë territorin e vet. 7.2 Asgjë në këtë dispozitë nuk e pengon asnjërin Anëtar që: (a) t'i bëjë ndryshe procedurat dhe kërkesat për dokumente bazuar në natyrën dhe llojin e mallrave ose mjeteve të tyre të transportit; (b) t'i bëjë ndryshe procedurat dhe kërkesat për dokumente për mallrat bazuar në menaxhim të rrezikut; (c) t'i bëjë ndryshe procedurat dhe kërkesat për dokumente për ta siguruar përjashtimin e plotë ose të pjesshëm nga detyrimet ose taksat e importit; (d) ta zbatojë arkivimin ose përpunimin elektronik; ose (e) t'i bëjë ndryshe procedurat dhe kërkesat për dokumente ashtu që të jetë në përputhje me Marrëveshjen për zbatimin e masave sanitare dhe fito-sanitare.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Sipas Kodit Doganor dhe Udhëzimit Administrativ nr. 11/2009, të gjitha procedurat janë unike për të gjitha njësitë hyrëse dhe dalëse. Projekt Kodi Doganor që është në procedurë të miratimit do të bëjë unifikimin e procedurave edhe më tutje për t'i përafëruar me legjislacionin dhe standardet e BE-së. Procedurat publikohen në faqen e internetit dhe gjenden në dispozicion për të gjitha palët e interesuara. Dogana e Kosovës ka zhvilluar UA të brendshme që sigurojnë që të gjitha procedurat të zbatohen barabartë në të gjitha pikat kufitare. Zbatimi i këtyre procedurave mbikëqyret nga organi qendror administrativ. Neni 66 i Kodit Doganor dhe neni 123 i UA 11/2009, Nenet 64, 66, 72 dhe nenet tjera përkatëse të Kodit Doganor përcaktojnë formën, përmbajtjen dhe skemën e dokumenteve të kërkuara si dhe listën e shtojcave (1 - 42) të UA 11/2009. B: Procedurat Ekzistojnë doracakë, udhëzime ose urdhëresa ekzistuese që janë publikuar në faqen e internetit të Doganës së Kosovës, si dhe janë shpërndarë si kopje fizike në shtatë drejtori rajonale të doganave. Krahas takimeve javore mes drejtorëve rajonal dhe kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm, ekziston edhe një njësi auditimi që e bën vlerësimin periodik të aktiviteteve. Të gjitha ankesat mund t'i drejtohen Sektorit për Shqyrtimin e Vendimeve.

	Ekzistojnë politika shtesë që i shpjegojnë hollësisht të gjitha procedurat doganore dhe shpërndahen në të gjitha zyrat e zhdoganimit.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Ka trajnime sistematike sipas planit vjetor të trajnimeve, mirëpo vlerësimi i stafit për çështjet në fjalë nuk është i rregullt. Nuk aplikohen rregulla për testim në baza periodike për oficerët doganor, por aplikohen trajnime intensive lidhur me zbatimin e rregullave të reja që zbatohen.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Shih 10.1
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	Shih 10.1
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht ☒ KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë ☒ I MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

10.8 MALLRAT E REFUZUARA

Teksti i marrëveshjes	8.1 Kur mallrat e paraqitura për import refuzohen nga autoriteti kompetent i ndonjërit Anëtar për shkak të mos përmbushjes së rregullave të përcaktuara sanitare ose fito-sanitare ose të rregulloreve teknike, Anëtari, varësisht prej ligjeve dhe rregulloreve të veta e lejon importuesin që t'i ridërgojë ose kthejë mallrat e refuzuara tek shteti/vendi/eksportuesi ose personi tjetër i caktuar nga eksportuesi. 8.2 Kur jepet opsioni sipas paragrafit 8.1 dhe importuesi nuk e shfrytëzon atë brenda periudhës së arsyeshme kohore, organi kompetent mund ta ndërmarrë ndonjë mënyrë tjetër veprimi për t'u marrë me ato mallra që nuk janë në përputhje.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: AUVK aplikon masën e refuzimit të mallit bazuar në Ligjin për Ushqim. Në pikën 8.1 të Ligjit për Ushqim specifikohet qartë se importuesi për shkak të mospërputhshmërisë ka të drejtë të kthejë mallrat në vendin e origjinës apo të ridërgojë mallin në ndonjë vend tjetër. B: Procedurat Të gjitha procedurat janë të përcaktuara dhe janë në dispozicion në internet. Procedurat e ri-eksportit janë funksionale në kuadër të autoritetit kompetent (AUVK, në këtë rast). Importuesi mund të kthejë në vendin e origjinës ose të dërgojë në ndonjë vend tjetër, varësisht nga kontrata mes importuesit dhe eksportuesit, duke pasur parasysh gjithmonë rrezikun të cilin e paraqet ngarkesa gjatë lëvizjes së mallrave të refuzuara. Për mallrat e ndaluara (apo të refuzuara) nga importi, procedura e mbikëqyrjes doganore është funksionale deri në momentin e daljes së ngarkesës nga territori i Republikës Kosovës.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Nuk raportohet
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	Nuk raportohet
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës, AUVK
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht

	Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

10.9 PRANIMI/IMPORTI I PËRKOHSHËM I MALLRAVE/ PROCESIMI I BRENDSHËM DHE I JASHTËM

Teksti i marrëveshjes

9.1 Secili Anëtar lejon, sipas ligjeve dhe rregulloreve të veta, mallrat të vijnë në territorin e vet doganor, të liruar me kusht, tërësisht ose pjesërisht, nga pagesa e detyrimeve dhe taksave të importit, nëse këto mallra sillen në territorin e vet doganor për ndonjë qëllim të caktuar dhe destinohen për ri-eksport brenda periudhës së caktuar dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim përveç amortizimit normal dhe humbjes për shkak të përdorimit të tyre.

9.2 Përpunimi i brendshëm dhe i jashtëm

(a) Secili Anëtar lejon sipas ligjeve dhe rregulloreve të veta, përpunimin e brendshëm dhe të jashtëm të mallrave. Mallrave që u lejohet përpunimi i jashtëm mund të ri-importohen duke u përjashtuar plotësisht ose të pjesërisht nga detyrimet dhe taksat e importit sipas ligjeve dhe rregulloreve të Anëtarit.

(b) Për nevojat e këtij neni, shprehja "përpunim i brendshëm" nënkupton procedurën doganore sipas së cilës në territorin doganor të ndonjë Anëtarit, mallrat e caktuara të liruar me kusht, tërësisht ose pjesërisht nga pagesa e detyrimeve dhe taksave të importit, ose për ato që kanë të drejtën e tërheqjes së mjeteve të paguara doganore, mund të sillen për faktin se destinohen për prodhim, përpunim ose riparim dhe eksportohen më vonë.

(c) Për qëllimet e këtij neni, shprehja "përpunim i jashtëm" nënkupton procedurën doganore sipas së cilës mallrat që gjenden në qarkullim të lirë në territorin doganor të ndonjë Anëtarit mund të eksportohen përkohësisht për prodhim, përpunim ose riparim jashtë vendit dhe më pas të ri-importohen.

Gjendja ekzistuese

A. Politika/korniza ligjore:

Dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës lejojnë që mallrat e importit përmes procedurës së Depos Doganore dhe Depos Publike të hyjnë në territorin e saj me taksa të pezulluara në rastin e importit. Sipas kësaj procedure, mallrat e importuara pastaj mund të eksportohen në vendet e tjera pa i paguar tatimet, apo edhe mund të lirohen në qarkullim të lirë në tregun vendor, natyrisht pasi të kryhen obligimet tatimore me të cilat ngarkohen importet. Momentalisht, nga Dogana janë të autorizuar më shumë se 300 subjekte të cilat përfitojnë nga këto procedura.

Për kompanitë prodhuese, sipas ligjit në fuqi, parashihen edhe procedurat me ndikim ekonomik si Procedurat për Përpunim të Brendshëm dhe atë të Jashtëm.

Tek Përpunimi i Brendshëm lejohet importi i lëndës së parë apo i gjysmë-produkteve pa ngarkesa tarifore, të cilët përpunohen, pastaj eksportohen jashtë vendit pa pagesë të këtyre ngarkesave.

	Njëjtë veprohet edhe tek Përpunimi i Jashtëm për mallrat të cilat eksportohen për t'u kryer operacione të caktuara të përpunimit. Me rastin e ri-importit taksat paguhën vetëm për vlerën e shtuar të mallit në përpunim.
	B: Procedurat
	Të gjitha procedurat mbi masat me ndikim ekonomik janë të finalizuara, dhe janë në dispozicion në internet.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
	Burimet njerëzore që merren me implementimin e masave me ndikim ekonomik janë mjaftueshme dhe mirë të trajnuara.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Përshtatja e softuerit dhe shtesat e softuerit janë bërë për ta rregulluar pranimin e përkohshëm të mallrave.
Pengesat (ofroni arsytet për mospërputhje)	Mungesa e legjislacionit i cili do t'u mundësonte subjekteve që kërkojnë autorizim për procedura me ndikim ekonomik të kenë një garanci të reduktuar.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	58. Krijimi i mekanizmave ligjor e procedural shtesë për uljen e garancive bankare për procedura me ndikim ekonomik
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), ATK
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	BE TAIEK

11.1-3 TAKSAT, RREGULLORET DHE FORMALITETET E TRANZITIT

Teksti i marrëveshjes	1. Çdo rregullore ose formalitet në lidhje me qarkullimin tranzit që vendoset nga Anëtarë nuk: (a) vazhdohet nëse rrethanat ose objektivat për të cilat është miratuar nuk ekzistojnë më, ose nëse rrethanat ose objektivat e ndryshuara mund të adresohen arsyeshëm me masa më pak kufizuese tregtare që janë në dispozicion; (b) zbatohet ashtu që përbën kufizim të maskuar në qarkullimin tranzit. 2. Qarkullimi tranzit nuk kushtëzohet nga mbledhja e ndonjë tarife ose tarifave të vendosura për tranzit, përveç tarifave për transportin, ose atyre që vendosen në përpjesëtim me shpenzimet administrative të bëra nga tranziti ose me koston e shërbimeve të kryera. 3. Anëtarët nuk do të kërkojnë, ndërmarrin ose mbajnë në fuqi kufizime vullnetare ose masa tjera të ngjashme në qarkullimin tranzit. Kjo është pa paragjykim të rregulloreve kombëtare ekzistuese dhe të atyre që mund të aplikohen në të ardhmen, marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe për rregullimin e transportit sipas rregullave të OBT-së.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore:
	Nuk ka tarifa tranziti apo kufizime të tjera.
	B: Procedurat
	Nuk ka kufizime apo tarifa për tranzit, rrjedhimisht nuk ka as procedura për aplikimin e tyre.
	C. Korniza institucionale
	Nuk ka kufizime apo tarifa për tranzit, rrjedhimisht edhe nuk janë krijuar mekanizma institucional për të analizuar ndikimin e tyre.
	D. Burimet njerëzore/trajnimi
Nuk ka kufizime apo tarifa për tranzit, rrjedhimisht nuk ka staf të dedikuar për të analizuar ndikimin e tyre.	
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Në përgjithësi, në lidhje me tranzitin, çështja kryesore problematike është anëtarësimi në konventat e ndryshme ndërkombëtare të tranzitit të cilat do të mundësonin lëvizjen pa ngarkesa tarifore dhe ngarkesa të tjera të mallrave në tranzit.
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	59. Të bëhen përgatitjet e nevojshme për aplikim në sistemet bashkëkohore të tranzitit: ▪ Qasja në programin e konfirmimit të tranzitit ndërkombëtar, sistemin NCTS (New Computerized Transit System)

	▪ Konventa TIR (The Customs Convention on the International Transport of Goods) ▪ Konventa ATA (Customs Convention for the Temporary Admission of Goods) ▪ Konventa CTC (Common Transit Convention), 60. Plotësim/ndryshimet e nevojshme për zbatimin e sistemeve të tranzitit i përfshijnë: ▪ Ndryshimet ligjore të nevojshme për aplikimin dhe implementimin e sistemeve të tranzitit ndërkombëtar ▪ Përgatitja e PSO-ve së bashku me udhëzimet shtesë për implementimin e sistemeve të tranzitit ▪ Analiza e nevojave për ridizajnim të sistemeve elektronike në Doganën e Kosovës për implementimin e sistemeve të tranzitit ▪ Krijimi apo fuqizimi i një mekanizmi specifik institucional brenda Doganës e Kosovës e cila do të mbështesë funksionimin e sistemeve të tranzitit ▪ Përgatitja e planit të trajnimit të personelit që do të implementojë sistemet e tranzitit
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), MMPHI, si dhe agjencitë e tjera kufitare
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESËM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

11.4 FORCIMI I MOS-DISKRIMINIMIT (Paragrafi 4)

Teksti i marrëveshjes	4. Secili Anëtar i trajton produktet që kalojnë tranzit përmes territorit të çdo Anëtari tjetër jo më keq se produktet që transportohen nga vendi i tyre i origjinës në destinimin e tyre pa kaluar territorin e këtij Anëtari tjetër.
Gjendja ekzistuese	D. Burimet njerëzore/trajnimi Institucionet përgjegjëse posedojnë staf me shkathtësi të mjaftueshme që janë në gjendje të përcaktojnë nëse ndonjë masë e aplikuar në tranzit ka elemente diskriminuese.
Pengesat (ofroni arsytet për mospërputhje)	Nuk raportohen (shih edhe 11.1-3)
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	Nuk raportohen (shih edhe 11.1-3)
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), MMPHI, MINT, dhe agjencitë e tjera kufitare
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht ☒ KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë ☒ I MESËM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

11.5-10 PROCEDURAT DHE KONTROLLET E TRANZITIT (Paragrafët 5-10)

Teksti i marrëveshjes	5. Anëtarët inkurajohen të vënë në dispozicion, sipas mundësisë, infrastrukturë të ndarë fizikisht (siç janë korsitë, vendqëndrimet, e të ngjashme) për qarkullim tranzit. 6. Formalitetet, kërkesat për dokumente dhe kontrollet doganore për qarkullim tranzit nuk duhet të jenë më ngarkuese se sa që është e nevojshme për: (a) identifikimin e mallrave; dhe (b) sigurimin se i përmbushin kërkesat për tranzit. 7. Në momentin që mallrat i nënshtrohen regjimit tranzit dhe autorizohen të nisen nga pika e origjinës në territorin e Anëtarit, më nuk i nënshtrohen asnjë tarife doganore ose kufizimi, ose vonesave të panevojshme derisa të përfundojnë tranziti i tyre në pikën e destinacionit brenda territorit të Anëtarit. 8. Anëtarët nuk i zbatojnë rregulloret dhe procedurat teknike për vlerësimin e konformitetit të mallrave tranzit sipas kërkesave të Marrëveshjes për Pengesat Teknike në Tregti. 9. Anëtarët lejojnë dhe sigurojnë paraqitjen dhe përpunimin paraprak të dokumenteve dhe të dhënave për tranzit para mbërritjes së mallrave. 10. Pasi qarkullimi tranzit ka ardhur në zyrën doganore prej nga del nga territori i Anëtarit, ajo zyrë e përfundon menjëherë operacionin e tranzitit nëse janë plotësuar kërkesat për tranzit.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore:
	Legjislacioni i Kosovës i lejon procedurat e tranzitit dhe siguron që dy pikat e vetme të kontaktit për mallrat tranzit janë pika hyrëse dhe pika e destinimit. Ligji e ndalon kontrollin e mallrave në tranzit në pika të tjera përveç pikës së hyrjes dhe destinimit. Legjislacioni e lejon edhe deklarimin e deklaratave të tranzitit para mbërritjes së mallrave.
	B: Procedurat
	Procedurat dhe kërkesat për dokumentacion janë të kufizuara vetëm në ato të cilat bëjnë të mundur identifikimin e mallrave. Mallrat tranzit nuk kontrollohen për pajtueshmëri teknike. Procedurat sigurojnë shkarkim të menjëhershëm sapo mallrat të arrijnë në pikën e destinimit.
	E. Komunikimi/teknologjia e informacionit
	Sistemi ASYCUDA World bën të mundur kontrollin specifik të mallrave në tranzit dhe garancitë e lidhura me tranzitin.
	F. Pajisjet & infrastruktura

	Infrastruktura nuk është e ndarë në linja të veçanta vetëm për tranzitin.
Pengesat (ofroni arsytet për mospërputhje)	Nuk raportohen (shih edhe II.1-3)
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	Nuk raportohen (shih edhe II.1-3)
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës (udhëheqëse), MMPHI, MINT, dhe agjencitë e tjera kufitare
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht Kryesisht PJESËRISHT Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESËM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

11.11-15 GARANCITË (PARAGRAFËT 11.11-11.15)

Teksti i marrëveshjes	11. Kur Anëtari kërkon garanci në formë të garantit, depozitës ose ndonjë instrumenti tjetër të përshtatshëm monetar ose jo monetar për qarkullimin tranzit, kjo garanci kufizohet që të sigurojë që kërkesat që burojnë nga ky qarkullim tranzit janë përmbushur. 12. Pasi që Anëtari cekë se kërkesat e tij për tranzit janë përmbushur, garancia tërhiqet pa vonesë. 13. Secili Anëtar, sipas ligjeve dhe rregulloreve të veta, lejon garanci të plotë për transaksione të shumëfishta për operatorë të njëjtë ose i ripërtërin garancitë pa u tërhequr dërgesat pasuese. 14. Secili Anëtar i bën publike informatat përkatëse që i përdorë për ta vendosur garancinë, për vetëm një transaksion, dhe sipas nevojës, garanci për transaksione të shumëfishta. 15. Secili Anëtar mund ta kërkojë përdorimin e konvojeve (autokolonave) doganore ose përcjelljes doganore për qarkullim tranzit vetëm kur paraqiten rreziqe të mëdha ose kur përputhshmëria me ligjet dhe rregulloret doganore nuk mund të sigurohet me garanci. Rregullat e përgjithshme që zbatohen për konvojet doganore ose ato të përcjelljes doganore publikohen në përputhje me nenin I.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Dogana e Kosovës përdor sistemin e TI-së për menaxhimin e garancive për mallrat nën procedurën e tranzitit dhe për mallrat që janë nën procedurat doganore me regjime pezulluese. Në Republikën e Kosovës, importi i mallrave me taksa të pezulluar si dhe tranziti mbulohet me garancinë bankare. Me rastin e përmbylljes së procedurave të caktuara të cilat ndërlidhen me pezullimin e taksave apo me tranzit, në afat optimal garancia bankare u kthehet palëve. B: Procedurat UA 11/2009 i mbulon garancitë në tranzit. E. Komunikimi/teknologjia e informacionit Menaxhimi i automatizuar i garancive për tranzit nëpërmjet sistemit të menaxhimit financiar është i integruar në ASYCUDA World.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Nuk raportohen (shih edhe 11.1-3)
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	Nuk raportohen (shih edhe 11.1-3)

Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

11.16-17 BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI MBI TRANZITIN (PARAGRAFI 16-17)

Teksti i marrëveshjes	16. Anëtarët bëjnë përpjekje që të bashkëpunojnë dhe të koordinohen me njëri tjetrin për të përmirësuar lirinë e tranzitit. Ky bashkëpunim dhe koordinim mund të përfshijë, por jo të kufizohet në, çështjet si: (a) tarifet; (b) formalitetet dhe kërkesat ligjore; dhe (c) funksionimin praktik të regjimeve për tranzit. 17. Secili Anëtar përpiqet ta caktojë koordinatorin kombëtar për tranzit të cilit mund t'i adresohen të gjitha kërkesat dhe propozimet nga Anëtarët e tjerë për funksionim të mirë të operacioneve tranzitore.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Dogana ka kompetencë për të lidhur marrëveshje për lehtësimin e tranzitit. Si pjesë e bisedimeve për menaxhimin e integruar të kufirit, dogana diskuton çështje që kanë të bëjnë me lehtësimin e tranzitit. Megjithatë, për shkak të specifikave politike të Kosovës, doganat janë të kufizuara në zhvillimin e lehtësimit të mëtejshëm të tranzitit si në planin bilateral ashtu edhe në atë rajonal si pasojë e mungesës së anëtarësimit në konventat ndërkombëtare të tranzitit. C. Korniza institucionale Dogana ka njësinë për bashkëpunim ndërkombëtar e cila i koordinon përpjekjet për fillimin e procedurave për anëtarësim në konventat ndërkombëtare të tranzitit. D. Burimet njerëzore/trajnimi Personeli është i gatshëm për të marrë pjesë aktive në organizatat që i mbulojnë çështjet e tranzitit.
Pengesat (ofroni arsytet për mospërputhje)	Shih 11.1-3
Veprimet/burimet e nevojshme & shpenzimet (numëroni veprimet)	Shih 11.1-3
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës, MMPHI, dhe agjencitë e tjera kufitare
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht Kryesisht PJESËRISHT

	Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESEM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

12. BASHKËPUNIMI DOGANOR

Teksti i marrëveshjes

1 Masat për pajtueshmëri dhe bashkëpunim

1.1 Anëtarët pajtohen për rëndësinë e të siguruarit që tregtarët të jenë të vetëdijshëm mbi detyrimet që i kanë rreth pajtueshmërisë, duke e inkurajuar pajtueshmërinë vullnetare, që i mundëson importuesit ta korrigjojë veten pa u ndëshkuar kur rrethanat janë në favor, dhe duke zbatuar masa më të rrepta për tregtarët që nuk janë në pajtueshmëri.

1.2 Anëtarët inkurajohen që t'i ndajnë informatat për praktikat më të mira në menaxhimin e pajtueshmërisë doganore duke përfshirë përmes Komitetit. Anëtarët inkurajohen të bashkëpunojnë në ofrimin e udhëzimeve ose të ndihmës teknike dhe të mbështesin ngritjen e kapaciteteve, me qëllim të administrimit të masave të pajtueshmërisë dhe përmirësimit të efikasitetit të tyre.

2 Shkëmbimi i informatave

2.1 Pas kërkesës dhe varësisht dispozitave të këtij neni, Anëtarët i shkëmbejnë informatat e cekura në nën-paragrafët 6.1(b) dhe/ose (c) për verifikimin e deklaratës për import ose eksport, kur në disa raste ka arsye për të dyshuar në vërtetësinë ose saktësinë e deklaratës.

2.2 Secili Anëtar e njofton Komitetin për të dhënat e pikës së vet të kontaktit për shkëmbimin e këtyre informatave.

3 Verifikimi

Anëtari e bën kërkesën për informata vetëm pasi t'i ketë kryer procedurat e nevojshme për verifikimin e deklaratës së importit ose eksportit dhe pas kontrollimit të dokumentacionit përkatës që e ka në dispozicion.

4 Kërkesa

4.1 Anëtari kërkues ia paraqet kërkesën me shkrim Anëtarit të kërkuar si kërkesë në letër ose elektronike, në njërën nga gjuhët zyrtare të OBT-së, për të cilën palët janë pajtuar bashkërisht, e që përfshin:

- (a) çështjen në fjalë, përfshirë sipas nevojës dhe nëse është në dispozicion, numrin identifikues të deklaratës së eksportit e që i korrespondon deklaratës së importit në fjalë;
- (b) qëllimin për të cilin Anëtari kërkues po i kërkon informatat ose dokumentet, së bashku me emrat dhe të dhënat e kontaktit të personave të ndërlidhur me kërkesën, nëse dihen;
- (c) nëse kërkohet nga Anëtari i kërkuar, konfirmimin e verifikimit sipas nevojës;
- (d) informatat ose dokumentet e kërkuara specifike;
- (e) identitetin e zyrës së origjinës që e bën kërkesën;
- (f) referencën në dispozitat e ligjit dhe sistemit ligjor kombëtar të Anëtarit kërkues, që e rregullojnë grumbullimin, mbrojtjen,

përdorimin, zbulimin, ruajtjen dhe asgjësimin e informatave konfidenciale dhe të dhënave personale.

4.2 Nëse Anëtari kërkues nuk pajtohet me ndonjërin nga nën-paragrafët e paragrafit 4.1, këtë duhet ta theksojë në kërkesë.

5 Mbrojtja dhe konfidencialiteti

5.1 Anëtari kërkues, varësisht paragrafit 5.2 duhet të:

- (a) mbajë plotësisht në mënyrë konfidenciale të gjitha informatat ose dokumentet që jepen nga Anëtari që i bëhet kërkesa dhe ofron së paku në nivel të njëjtë mbrojtjeje dhe konfidencialiteti sikurse parashikohet me ligj dhe sistemin ligjor kombëtar të këtij Anëtari siç përshkruhet në nën-paragrafët 6.1 (b) ose (c);
- (b) japë informata ose dokumente vetëm autoriteteve doganore që merren me çështjen në fjalë dhe i përdorin këto informata ose dokumente vetëm për qëllimin e cekur në kërkesë, përveç nëse Anëtarit që i bëhet kërkesa pajtohet ndryshe me shkrim;
- (c) mos i zbulojë informatat ose dokumentet pa lejen specifike me shkrim të Anëtarit të cilit i bëhet kërkesa;
- (d) mos ta përdorë asnjë informatë ose dokument të pa-verifikuar nga Anëtari që i bëhet kërkesa, si faktor vendimtar për ta zvogëluar dyshimin në çfarëdo rrethane të caktuar;
- (e) respektojë çdo kusht specifik për rastin e cekur nga Anëtari që i bëhet kërkesa, për ruajtjen dhe asgjësimin e informatave ose dokumenteve konfidenciale dhe të dhënave personale; dhe
- (f) pas kërkesës, ta informojë Anëtarin që i bëhet kërkesa për çdo vendim dhe veprim të ndërmarrë për çështje si rezultat i informatave ose dokumenteve të dhëna.

5.2 Ligji dhe sistemi ligjor i Anëtarit kërkues mund të mos jetë në pajtim me ndonjërin nga nën-paragrafët e paragrafit 5.1. Nëse është kështu, Anëtari kërkues e cekë këtë në kërkesë.

5.3 Anëtarit që i bëhet kërkesa e shqyrton çdo kërkesë dhe informatë verifikimi të pranuar sipas paragrafit 4, të paktën me të njëjtin nivel mbrojtjeje dhe konfidencialiteti të rënë dakord nga Anëtari kërkues për informata të ngjashme të tij.

6 Sigurimi i informatave

6.1 Në përputhje me dispozitat e këtij neni, Anëtarit që i bëhet kërkesa menjëherë:

- (a) përgjigjet me shkrim, në letër ose mjete elektronike;
- (b) jep informata specifike siç ceket në deklaratën e importit ose eksportit ose deklaratën për sa është në dispozicion, së bashku me përshkrimin e nivelit të mbrojtjes dhe të konfidencialitetit që kërkohet nga Anëtari që i bëhet kërkesa;
- (c) nëse kërkohet, jep informata specifike siç ceket në dokumentet në vazhdim ose dokumentet e paraqitura që e mbështesin deklaratën e

importit ose eksportit, aq sa janë në dispozicion: fatura tregtare, lista e paketimit, certifikata e origjinës dhe fatura e ngarkesës në formën në të cilën janë depozituar në letër apo formë elektronike, së bashku me përshkrim të nivelit të mbrojtjes dhe konfidencialitetit që kërkohet nga Anëtari kërkues;

(d) vërteton se dokumentet e paraqitura janë kopje të vërteta;

(e) jep informata ose përndryshe i përgjigjet kërkesës, sipas mundësisë, brenda 90 ditëve nga data e kërkesës.

6.2 Anëtarit që i bëhet kërkesa mund të kërkojë, sipas ligjit të tij vendor dhe sistemit ligjor, garanci para dhënies së informatave specifike, se nuk do të përdoren si provë në hetime penale, procedura gjyqësore ose në procedura jo-doganore pa lejen me shkrim të këtij të fundit. Nëse Anëtari kërkues nuk mund të përmbushë këtë kërkesë, duhet t'ia cekë këtë Anëtarit të cilit i bëhet kërkesa.

7 Shtyrja ose Refuzimi i Kërkesës

7.1 Anëtarit të cilit i bëhet kërkesa, mund ta shtyjë ose refuzojë njërën pjesë ose tërë kërkesën për dhënien e informatave dhe e informon Anëtarin kërkues për arsyet për këtë vendim, atëherë kur:

(a) është në kundërshtim me interesin publik siç ceket në ligjin vendor dhe sistemin ligjor të Anëtarit që i bëhet kërkesa;

(b) ligji dhe sistemi ligjor i tij vendor e pengon lëshimin e informatave. Në këtë rast, ai i siguron Anëtarit kërkues një kopje të referencës përkatëse specifike;

(c) dhënia e informatave do ta pengonte zbatimin e ligjit ose do të ndërhynte në ndonjë mënyrë tjetër në hetim, ndjekje penale ose procedim administrativ ose gjyqësor që është duke u zhvilluar;

(d) pëlqimi i importuesit ose eksportuesit kërkohet me ligjin dhe sistemin ligjor vendor që e rregullon grumbullimin, mbrojtjen, përdorimin, zbulimin, ruajtjen dhe asgjësimin e informatave konfidenciale ose të të dhënave personale dhe ky pëlqim nuk jepet; ose

(e) kërkesa për informata pranohet pas skadimit të kërkesës ligjore të Anëtarit të cilit i bëhet kërkesa për ruajtjen e dokumenteve.

7.2 Në rrethanat e paragrafëve 4.2, 5.2 ose 6.2, ekzekutimi i kësaj kërkesë mbetet në diskrecion të Anëtarit të cilit i bëhet kërkesa.

8 Reciprociteti

Nëse Anëtari kërkues mendon se nuk mund ta përmbushë kërkesën e njëjtë nëse është bërë nga Anëtari të cilit i bëhet kërkesa, ose nëse ende nuk e ka zbatuar këtë nen, duhet ta cekë këtë në kërkesën e vet. Ekzekutimi i kësaj kërkesë mbetet në diskrecion të Anëtarit të cilit i bëhet kërkesa.

9 Barra administrative

9.1 Anëtari kërkues i merr parasysh burimet përcjellëse dhe kostot për Anëtarin që i bëhet kërkesa në përgjigjen e kërkesës për informata. Anëtari kërkues e merr në konsideratë proporcionalitetin në mes të interesit të tij fiskal në ndjekjen e kërkesës së tij dhe përpjekjeve që bëhen nga Anëtari që i bëhet kërkesa në dhënien e informatave.

9.2 Nëse njëri Anëtar që i bëhet kërkesa pranon numër të madh kërkesash për informata që nuk mund t'i menaxhojë, ose ndonjë kërkesë për informata nga fusha që nuk mund ta menaxhojë nga njëri ose më shumë Anëtarë kërkues dhe është e pamundur ta përmbushë këtë kërkesë brenda kohës së arsyeshme, mund të kërkojë nga ai ose ata Anëtarë kërkues që ta bëjnë prioritizimin bazuar në kufizimet e burimeve që i ka në dispozicion. Nëse nuk pajtohen për një qasje të dakorduar bashkërisht, ekzekutimi i këtyre kërkesave bëhet sipas gjykimit të Anëtarit që i bëhet kërkesa bazuar në prioritetet e tij.

10 Kufizimet

Anëtarit që i bëhet kërkesa nuk i kërkohet të:

- (a) modifikojë formatin e deklaratave ose procedurave të importit ose eksportit;
- (b) kërkojë dokumente të tjera përveç atyre që paraqiten me deklaratën e importit ose eksportit siç ceket në nën-paragrafin 6.1(c);
- (c) fillojë hetime për t'i marrë informatat;
- (d) modifikojë periudhën për ruajtjen e këtyre informatave;
- (e) prezantojë dokumentacionin në letër nëse tanimë është marrë në format elektronik;
- (f) përkthejë informatat;
- (g) vërtetojë saktësinë e informatave; ose
- (h) sigurojë informatat që do të mund t'i paragjykonin interesat legjitime tregtare të ndërmarrjeve të caktuara, publike ose private.

11 Përdorimi ose zbulimi i paautorizuar

11.1 Nëse ka ndonjë shkelje të kushteve të përdorimit ose zbulimit të informatave që shkëmbehen sipas këtij neni, Anëtari kërkues që i ka pranuar informatat duhet ti komunikojë hollësitë e këtij përdorimi ose zbulimi të paautorizuar tek Anëtari që i bëhet kërkesa, që i ka dhënë informatat dhe:

- (a) i ndërmerr masat e duhura për të kompensuar shkeljen;
- (b) i ndërmerr masat e duhura për të parandaluar çdo shkelje në të ardhmen; dhe
- (c) njofton mbi masat e ndërmarra sipas nën-paragrafëve (a) dhe (b).

11.2 Anëtari që i bëhet kërkesa mund t'i pezullojë detyrimet e tij ndaj Anëtarit kërkues sipas këtij neni derisa të ndërmerren masat e cekura në paragrafin 11.1.

12 Marrëveshjet dypalëshe dhe rajonale

	12.1 Asgjë në këtë nen nuk e pengon Anëtarin ta lidhë ose ta ketë ndonjë marrëveshje dypalëshe, shumëpalëshe ose rajonale për ndarjen ose shkëmbimin e informatave dhe të dhënave doganore, përfshirë në baza të sigurta dhe të shpejta si p.sh. në baza automatike ose para se të mbërrijë ngarkesa. 12.2 Asgjë në këtë nen nuk do të interpretohet se ndryshon ose ndikon në të drejtat ose detyrimet e një anëtar sipas marrëveshjeve të tilla dypalëshe, shumëpalëshe ose rajonale, ose si e rregullon shkëmbimin e informatave dhe të dhënave doganore sipas këtyre marrëveshjeve të tjera.
Gjendja ekzistuese	A. Politika/korniza ligjore: Legjislacioni i Kosovës e mundëson dhënien e informatave sipas përshkrimit në nenin 12 për agjencitë e huaja doganore. Informatat komerciale konfidenciale mbrohen me ligj. Sipas marrëveshjeve dypalëshe që e mbizotërojnë legjislacionin vendor, Dogana e Kosovës ka kompetencë t'i refuzojnë kërkesat për qasje në informatat e marra nga agjencitë e huaja doganore apo edhe nga institucionet e tjera vendore. Sidoqoftë, në rastet për procedim penal ose gjyqësor, dogana është e detyruar që t'i dorëzojë të gjitha informatat që i ka në dispozicion tek organet kompetente. B: Procedurat Procedurat për parashtrimin e kërkesave tek agjencitë e tjera doganore janë të standardizuara dhe këto procedura ekzistojnë për të siguruar që informatat e marra përdoren vetëm për qëllime të parashtruara në kërkesë. Konfidencialiteti sigurohet me procedura specifike. Të gjitha kriteret për shkëmbimin e informatave janë të paracaktuara dhe pasohen me procese që bazohen në marrëveshje dypalëshe. C. Korniza institucionale Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha kërkesave lidhur me shkëmbimin e informatave. D. Burimet njerëzore/trajnimi Personeli përgjegjës për dhënien e informatave është i mjaftueshëm dhe mirë i përgatitur për ti dhënë informatat në kohë. E. Komunikimi/teknologjia e informacionit Të gjitha deklaratat e mallrave arkivohen në formë elektronike, kështu që janë të gatshme në dispozicion me kërkesë të ndonjë organi tjetër.
Pengesat (ofroni arsyet për mospërputhje)	Nuk raportohet
Veprimet/burimet e nevojshme &	Nuk raportohet

shpenzimet (numëroni veprimet)	
Institucionet përgjegjëse	Dogana e Kosovës
Niveli i zbatueshmërisë	Plotësisht KRYESISHT Pjesërisht Aspak Nuk aplikohet
Niveli i prioritetit	I lartë I MESËM I ulët Nuk është prioritet Tjetër _____
Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të kësaj mase	Nuk raportohet

SHTOJCA I: KONTRIBUESIT

Dogana e Kosovës: Ibrahim Xhaka, Sali Hoda, Bujar Pefçeli, Drenushë Rizvanolli, Vjollca Dragidella, Blerim Nela, Albert Gashi

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës: Flamur Kadriu, Eroll Shehu, Islam Mulaj, Ismet Fejzullahu, Enver Demëbogaj

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë: Igballe Rexha-Jashari, Anita Sutaj, Merita Fetahu, Buline Gashi, Selvije Çeku

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural: Shqipe Dema

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale: Lutfi Mulaku

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës: Elmaze Pireva

Shoqata e Shpeditërëve Vendor dhe Ndërkombëtar të Kosovës: Jeton Vokshi

USAID/Programi për Qeverisje Ekonomike në Kosovë: Petrit Gashi

